



Financuar nga
Bashkimi Evropian



FARM *to* FORK
ACADEMY

Sistemet ushqimore dhe komunitetet rurale të qëndrueshme, rasti i qumështit dhe nënprodukteve të tij në Shqipëri



Dokument Kombëtar Politikash

SISTEMET USHQIMORE DHE KOMUNITETET RURALE TË QËNDRUESHME, RASTI I QUMËSHTIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TIJ NË SHQIPËRI

DOKUMENT KOMBËTAR POLITIKASH

PUBLIKUAR/BOTUAR NGA:

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

AUTORE:

Anila Boshnjaku, Prof. Asoc. - Universiteti Bujqësor i Tiranës

METODOLOGJIA:

Prof. Dr. Sc. **Bojan Stipešević**, Fakulteti i Shkencave Agrobioteknike të Osijekës, Kroaci

RISHIKUAR NGA:

Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

REDAKTIMI GJUHËSOR:

Sonila Çeliku

ILUSTRUAR NGA:

Eduart Cani

Tiranë, 2025



**Financuar nga
Bashkimi Evropian**

Ky dokument politikash është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti politikash është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1. HYRJE	7
2. METODOLOGJIA	8
2.1 KUADRI ANALITIK	8
2.2 MBLEDHJA E TË DHËNAVE	8
2.3 ANALIZA E TË DHËNAVE	9
3. ANALIZA E ZINXHIRIT TË VLERËS SË QUMËSHTIT NË SHQIPËRI	11
3.1. RËNDËSIA EKONOMIKE DHE ECURIA	11
3.2.ORGANIZIMI I ZINXHIRIT TË VLERËS SË QUMËSHTIT	11
3.3. QEVERISJA, MARRËDHËNIET KONTRAKTUALE DHE DINAMIKA FERMER-PËRPUNUES	12
3.4.MASAT MBËSHTETËSE DHE INVESTIMET PUBLIKE	12
4. POLITIKAT KOMBËTARE DHE KUADRI STRATEGJIK PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	14
4.1. VIZIONI STRATEGJIK DHE OBJEKTIVAT KRYESORE	14
4.2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	14
4.3. HARMONIZIMI ME POLITIKËN E PËRBASHKËT BUJQËSORE TË BE-SË	15
4.4 KOHERENCA STRATEGJIKE ME OBJEKTIVAT E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE	16
4.5. TEMATIKAT NÐRSEKTORIALE DHE DREJTIMET PËR TË ARDHMEN	16
5. PERFORMANCA E SISTEMEVE USHQIMORE - RASTI I QUMËSHTIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TIJ	17
5.1. PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË QËNDRUESHMËRISË	17
5.2 VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË	18
6. NÐRHYRJET POLITIKE PËR ZINXHIRIN E VLERËS SË QUMËSHTIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TIJ NË SHQIPËRI, POLITIKA KOMBËTARE	34
6.1. QENDRA TË KONSOLIDUARA TË GRUMBULLIMIT TË QUMËSHTIT	34
6.2. PROGRAMI I MBËSHTETJES SË KOOPERATIVAVE	34
6.3. TESTIMI I CILËSISË SË QUMËSHTIT DHE SISTEMI I NXITJES SË PAGESAVE	35
6.4. INICIATIVA PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË PLEHUT	35
6.5. GRANTE PËR FUQIZIMIN E GRAVE DHE TË RINJVE	36
6.6. PROGRAMET E QASJES FINANCIARE PËR INVESTIME NË PRODUKTET E QUMËSHTIT	36
6.7. FONDI I RIINVESTIMIT NË PRODUKTET E QUMËSHTIT, INVESTIMI NË PËRGJEGJËSINË SOCIALE TË KORPORATAVE	37
6.8 SHËRBIME PËRMIRËSUARA TË KËSHILLIMIT DHE QASJA NË INFORMACION	38
6.9. LIDHJA E KONTRATAVE MIDIS FERMERËVE DHE PËRPUNUESVE VENDAS	38
6.10. STANDARDET DHE ZBATIMI I PËRFORCUAR I TYRE PËR PRODUKTET QUMËSHTIT	39
6.11. PROMOVIMI I NËNPRODUKTEVE TË QUMËSHTIT ME VLERË TË SHTUAR DHE DIVERSIFIKIMI	40
7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	42
8. REFERENCAT	46
9. ANEKSE	48

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Përmbledhje e vlerësimit të qëndrueshmërisë sipas dimensioneve	17
Tabela 2: Marzhi neto mesatar mujor për një të punësuar me kohë të plotë në sektorin e bujqësisë dhe niveli i pagës mesatare në nivel kombëtar	19
Tabela 3. Treguesit e integruar të qëndrueshmërisë ekonomike	49
Tabela 4. Treguesit e integruar të qëndrueshmërisë sociale (shkallë Liker 1-5)	50
Tabela 5. Treguesit e integruar të qëndrueshmërisë mjedisore (shkallë Liker 1-5)	51

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Konsumi i qumështit për frymë: Shqipëria krahasuar me BE dhe botën	52
Figura 2: Performanca e tregtisë së qumështit: Importi, eksporti dhe bilanci tregtar (000 ton)	52

PËRMbledhje Ekzekutive

Sektori i qumështit është një nga sektorët që jep kontributin më të madh në ekonominë bujqësore në Shqipëri dhe sigurimin e burimeve të jetesës së banorëve të komuniteteve rurale. Ky sektor përbën afërsisht 40% të totalit të prodhimit bujqësor dhe shërben si një burim shumë i rëndësishëm për ushqyerjen dhe sigurimin e të ardhurave për një pjesë të madhe të familjeve në zonat rurale. Megjithatë, aktualisht sektori gjendet në udhëkryq. Problemet strukturore duke filluar nga prodhimi i copëzuar, tregu informal, e deri te produktiviteti i ulët dhe presioni mbi ndikimet mjedisore kërcënojnë qëndrueshmërinë e këtij sektori. Në të njëjtën kohë, procesi i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian paraqitet si një mundësi dhe një moment shumë i rëndësishëm në përafrimin e sistemeve agroushqimore me standardet e BE për sigurinë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin rural. Analiza bazohet në një metodologji vlerësimi të strukturuar dhe shumëdimensionale të hartuar nga Organizata Botërore e Ushqimit (FAO): Kuadri i Zhvillimit të Zinxhirëve të Qëndrueshëm Ushqimor dhe strategjia "Nga Ferma në Tryezë" e BE. Të dhënat për hartimin e dokumentit të politikave u siguruan nga burime të shumta, duke përfshirë statistikën zyrtare, dokumentet e politikave, studimet teknike dhe të dhëna parësore të mbledhura përgjatë procesit të konsultimit me pjesëmarrje për forcimin e pozicionit të fermerëve në zinxhirët e vlerës, që përfshiu 5 diskutime në grupe të fokusuara dhe intervista me palët e interesuara. Për të vlerësuar nivelin e qëndrueshmërisë u analizuan 16 tregues, sipas tri shtyllave kryesore. Gjetjet tregojnë një nivel të moderuar të qëndrueshmërisë së dimensionit ekonomik (3 pikë), por nivel të ulët të qëndrueshmërisë së dimensionit social (2 pikë) dhe mjedisor (2 pikë), duke treguar për sfida të mëdha që kërkojnë ndërhyrje në politikat zhvillimore.

Ndonëse sektori i qumështit mbetet një kontribues i rëndësishëm në furnizimin me ushqim dhe punësim, përfitimi është në përgjithësi i ulët dhe karakterizohet nga pabarazi në shpërndarjen e fitimit, sidomos në rastin e fermerëve të vegjël. Pavarësisht modernizimit të proceseve të punëve në një pjesë të fermave dhe fabrikave të përpunimit, shumica e fermave mbeten të vogla (96% me më pak se pesë lopë), të nënfinancuara dhe të shkëputura nga zinxhirët formalë të vlerës. Qasja në financë është e kufizuar nga normat e larta të interesit dhe mungesa e kolateralit, ndërsa skemat kombëtare të mbështetjes shpesh i përjashtojnë fermerët më të dobët për shkak të kompleksitetit të procedurave administrative dhe kriterit të bashkëfinancimit të granteve.

Përsa i përket dimensionit social, zinxhiri i vlerës së qumështit karakterizohet nga pabarazi, informalitet dhe mbështetje e kufizuar institucionale. Fermerët e vegjël shpesh janë çmim-pranues, pa kontrata formale dhe me fuqi shumë të ulët negociuese mbi çmimet. Kushtet e punës zakonisht janë të pafavorshme, duke u mbështetur shumë në punën e papaguar familjare, veçanërisht tek gratë dhe tek të moshuarit, karakterizohen nga orë të gjata pune dhe mungesë mbrojtjeje sociale. Nga ana tjetër, angazhimi i të rinjve dhe grave në proceset e vendimarrjes në fermë dhe role drejtuese mbetet shumë i kufizuar. Po ashtu, siguria ushqimore mbetet një çështje kritike: pothuajse gjysma e sasisë së qumështit të shitur në Shqipëri nuk i nënshtrohet kontrolleve zyrtare të cilësisë, duke shkaktuar shqetësime serioze për shëndetin publik. Ndërsa përpunuesit e mëdhenj i përmbushin standardet e sigurisë, tregjet informale dhe të parregulluara dominojnë sektorin e qumështit. Një tjetër element i rëndësishëm si pasuritë kulturore të lidhura me zinxhirin e vlerës së qumështit (djathërat tradicionalë, praktikat baritore etc.) vazhdojnë të ekzistojnë në zona të ndryshme të Shqipërisë. Megjithatë, këto tradita sa vijnë dhe zbehen për shkak të largimit të popullsisë nga zonat rurale dhe mungesës së njohjes dhe promovimit formal të këtyre traditave.

Aktivitetet blegtorale shoqërohen me ndikime të shumta mjedisore, të cilat në shumicën e rasteve nuk menaxhohen ashtu siç duhet. Emetimet e gazrave serrë janë të larta për shkak të mbarështimit të bagëtive me rendiment të ulët dhe praktikave joefektive të ushqyerjes. Plehu i bagëtive shpesh keqmenaxhohet, duke çuar në ndotjen e ujit dhe të tokës, ndërsa degradimi i kullotave dhe humbja e biodiversitetit po përshpejtohen për shkak të neglizhencës dhe braktisjes së sistemeve tradicionale blegtorale. Gjithashtu, ruajtja e racave vendase dhe agrobiodiversitetit mbetet në nivele minimale. Sektorit po ashtu i mungojnë investimet në energjinë e rinovueshme, madje edhe në rastin e operatorëve të mëdhenj.

Këto gjetje tregojnë për një zinxhir vlere qumështi të copëzuar dhe gjithnjë e më të polarizuar. Ndërsa një numër i vogël fermash dhe përpunuesish më të mëdhenj dhe të modernizuar po arrijnë përfitime të larta me kosto të ulët, shumica dërrmuese e prodhuesve mbeten të përjashtuar nga këto përfitime. Kjo përballje kërcënon qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit dhe objektivat e politikave kombëtare për një zhvillim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Për t'iu përgjigjur sfidave sistematike të përshkruara në analizën e mësipërme, ky dokument politikash ofron një sërë rekomandimesh koherente dhe të zbatueshme. Këto rekomandime janë plotësisht në përputhje me prioritetet strategjike të Strategjisë së Shqipërisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027 dhe parimet e Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) të Bashkimit Evropian.

Në qendër të ndërhyrjeve të propozuara është angazhimi për një modernizim gjithëpërfshirës. Kjo përkthehet në investim në infrastrukturë, pajisje dhe përmirësim të rracave të mbarështuara nga fermat e vogla dhe të mesme që aktualisht janë të privuara nga proceset teknologjike. Duke e bërë mbështetjen financiare të synuar të disponueshme për këta prodhues, qëllimi është të rritet produktiviteti, cilësia dhe qëndrueshmëria në të gjithë sektorin, jo vetëm për një pakicë prodhuesish të mëdhenj.

Po aq e rëndësishme është nevoja për të forcuar fuqinë negociuese të fermerëve përgjatë zinxhirit të vlerës së qumështit. Kjo përfshin nxitjen e krijimit të kooperativave dhe grupeve të prodhuesve që mund të rrisin fuqinë negociuese të fermerëve dhe të ulin kostot e transaksioneve. Mekanizma më të fuqishëm si zbatimi i kontratave formale janë gjithashtu të nevojshëm për ta zhvendosur sektorin nga transaksionet informale, afatshkurtra, drejt marrëdhënieve afatgjata, të bazuara në besim, të cilat nxisin cilësinë dhe investimet. Mbështetja për formalizimin duhet të shkojë krah për krah me reformat ligjore dhe fiskale që sigurojnë rregulla të barabarta loje midis operatorëve informalë dhe bizneseve që zbatojnë rregullat tatimore.

Siguria ushqimore dhe shëndeti i kafshëve mbeten fusha që kanë nevojë të menjëhershme për përmirësim, veçanërisht për shkak të numrit të madh të prodhuesve informalë në shkallë të vogël dhe që aktualisht janë jashtë mbikëqyrjes së institucioneve përgjegjëse. Prandaj, dokumenti i politikave bën thirrje për shërbime të përmirësuara veterinare dhe të sigurisë ushqimore, duke përfshirë trajnimin, përmirësimin e infrastrukturës dhe inspektimet sistematike, për të mbrojtur shëndetin publik dhe për të ndërtuar besimin e konsumatorit, si për konsumatorët vendas dhe ata të huaj.

Duke njohur kufizimet financiare me të cilat përballen shumica e fermerëve, veçanërisht ata të cilët nuk zotërojnë kolateral ose tituj zyrtar të tokës, dokumenti thekson rritjen e aksesit të fermerëve në burime financiare. Kjo përfshin prezantimin e instrumenteve për ndarjen e riskut, promovimin e mekanizmave që favorizojnë grupet e fermerëve dhe avancimin e reformave në regjistrimin e tokës në emër të fermerëve.

Qëndrueshmëria mjedisore është një tjetër shtyllë shumë e rëndësishme e analizuar. Dokumenti i politikave rekomandon promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të plehut organik, rritjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme si biogazi dhe sistemet diellore, si dhe ndërmarrjen e hapave konkretë për të mbrojtur biodiversitetin, duke përfshirë ruajtjen e racave vendase të bagëtive dhe peizazheve tradicionale të kullotave.

Për të mbështetur këto transformime, dokumenti i politikave thekson rëndësinë e rritjes së kapaciteteve institucionale, veçanërisht brenda shërbimeve të ekstensionit bujqësor, shërbimeve të këshillimit dhe përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional. Në mungesë të institucioneve funksionale, edhe politika të hartuara më së miri nuk do të arrijnë të sjellin ndryshime në realitet.

Së fundmi, dokumenti i politikave e vendos përfshirjen sociale në qendër të vizionit të tij, duke rekomanduar politika që fuqizojnë gratë përmes aksesit në asete, role drejtuese dhe trajnim, inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve në sipërmarrjet moderne në zinxhirin e vlerës së qumështit dhe sigurojnë kushte më të mira pune dhe mbrojtje për banorët e komuniteteve rurale.

Së bashku, të gjitha këto rekomandime ofrojnë një plan veprimi për krijimin e një sektori qumështi ekonomikisht konkurrues, gjithëpërfshirës dhe miqësor me mjedisin, që përmbush nevojat e zhvillimit të Shqipërisë, duke përmbushur njëkohësisht aspiratat e saj për integrimin në Bashkimin Evropian.

1. HYRJE

Në të gjithë botën, sistemet ushqimore janë nën presion për të ofruar ushqim të shëndetshëm, jetesë të denjë dhe një planet të jetueshëm në të njëjtën kohë. Për Shqipërinë kjo sfidë është shumë aktuale: bujqësia ende punëson një pjesë të madhe të fuqisë punëtore, megjithatë sektori duhet të përputhet me parimet e Marrëveshjes së Gjelbër të BE dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SGD), duke u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike dhe paqëndrueshmërisë së tregjeve. Brenda sektorit të bujqësisë në Shqipëri, industria e qumështit është një bosht strategjik. Qumështi dhe djathi janë produkte shumë të rëndësishme për konsumin vendas dhe të ardhurat e komuniteteve rurale. Megjithatë, ky aktivitet dominohet nga mijëra ferma të vogla me produktivitet të ulët, tregje informale dhe fabrika përpunimi që ndryshojnë shumë në teknologji dhe kontroll të cilësisë nga njëra tek tjetra. Zinxhirët e copëzuar të furnizimit, shërbimet e dobëta të ekstensionit dhe kostot në rritje të inputeve kufizojnë konkurrueshmërinë, ndërsa menaxhimi i plehut organik, mbetjet e përpunimit dhe intensiteti i lartë i metanit enterik shkaktojnë shqetësime të shumta mjedisore. Në këtë rast, modernizimi i sektorit të qumështit ofron një rast prove shumë të dukshme për ta çuar të gjithë sistemin ushqimor drejt qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Dokumenti i politikave përfaqëson një kontribut të qëndrueshëm nga sektori i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të fuqizuar fermerët në zinxhirin e vlerës së qumështit. Dokumenti ofron të dhëna dhe kontribute që ndihmojnë në procesin e hartimit të politikave që adresojnë në mënyrë efektive sfidat që pengojnë krijimin e sistemeve të qëndrueshme ushqimore. Ky dokument synon të ofrojë udhëzimet, parimet dhe drejtimit strategjike të nevojshme për të avancuar drejt tranzicionit të gjelbër e të duhur të sektorit të qumështit në Shqipëri. Qëllimi i tij kryesor është të tregojë se si sektori i qumështit mund të sjellë më shumë të ardhura pa shteruar burimet natyrore dhe pa përjashtuar grupet e cënueshme të shoqërisë.

Fokusimi në sektorin e qumështit justifikohet nga fakti se ky sektor luan një rol shumë të rëndësishëm për ekonominë e zonave rurale të Shqipërisë, duke kontribuar ndjeshëm në të ardhurat e fermave dhe punësim. Përtej rëndësisë së tij së tij ekonomike, produktet e qumështit si qumështi, kosi dhe djathi janë produkte bazë, duke e bërë cilësinë, çmimin dhe sigurinë e tyre shumë të rëndësishme për shëndetin publik. Ndërsa Shqipëria përparon drejt integritetit në BE, përafrimi me standardet e sigurisë ushqimore, mjedisore dhe klimatike të BE po bëhet jo vetëm një kërkesë rregullatore, por një portë hyrëse në tregjet e eksportit dhe aksesin në mbështetjen Politikës së Përbashkët Bujqësore. Në këtë kontekst, përmirësimi i situatës së fermerëve në sektorin e qumështit është një përparësi dhe një investim strategjik afatgjatë për të ardhmen evropiane të vendit.

Për ta përkthyer këtë ambicie në hapa konkretë, dokumenti i politikave përshkruan tre objektiva kryesore. Së pari, ai ofron një analizë gjithëpërfshirëse të zinxhirit aktual të vlerës së qumështit, duke analizuar prodhimin, aktorët kryesorë dhe zbatimin e qasjes “Nga ferma në tryezë”. Së dyti, dokumenti vlerëson performancën e qëndrueshmërisë së sektorit: ekonomike, sociale dhe mjedisore përmes një shkalle transparente Likert nga 1 deri në 5 bazuar në parimet e FAO. Së treti, dokumenti identifikon boshllëqet kryesore në zbatimin e politikave dhe ofron zgjidhje konkrete të politikave për të ndërtuar një sistem ushqimor më të qëndrueshëm, në përputhje me agjendën e gjerë të reformës bujqësore dhe zhvillimit rural të Shqipërisë.

2. METODOLOGJIA

Ky dokument politikash zbaton një metodologji të strukturuar dhe të bazuar në evidenca për të vlerësuar performancën e qëndrueshmërisë së zinxhirit të vlerës së qumështit në Shqipëri dhe për të propozuar ndërhyrje për përmirësimin e politikave zhvillimore. Qasja bazohet në dy Korniza të njohura ndërkombëtarisht: parimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Zinxhirit të Vlerave Ushqimore (SFVCD) të FAO dhe në Strategjinë e BE "Nga ferma në tryezë". Këto Korniza ofrojnë një bazë konceptuale dhe operacionale për lidhjen e matjes së qëndrueshmërisë me kuptimin në nivel sistemi dhe reformat praktike.

2.1 KUADRI ANALITIK

Kuadri i vlerësimit mbështetet në parimet e qasjes së FAO mbi SFVCD, të cilat janë grupuar në tre grupe kryesore:

- ➔ Matja e performancës - vlerëson rezultatet aktuale në dimensionet ekonomike, sociale dhe mjedisore të qëndrueshmërisë. Kjo korrespondon me Parimet 1-3 të qasjes SFVCD. Një grup prej 16 treguesish të rendit të parë u përzgjedhën për të përfaqësuar fushat kryesore të rezultateve, siç janë përfitueshmëria, siguria ushqimore, barazia gjinore dhe risku mjedisor.
- ➔ Kuptimi i performancës së sistemit - analizon faktorët kryesorë që shpjegojnë performancën e vëzhguar, bazuar në *Parimet 4-6* të qasjes SFVCD. Këto përfshijnë strukturën dhe lidhjet e zinxhirit të vlerës, qeverisja rregullatore (p.sh., kontratat, pushteti jo i ekuilibruar, strukturat e stimujve) dhe dinamikat e tregjeve përfundimtarë (p.sh., preferencat e konsumatorëve, prirjet e çmimeve, flukset tregtare).
- ➔ Hartimi i ndërhyrjeve në politika - formulon një sërë ndërhyrjesh të zbatueshme, të bazuara në evidenca, që synojnë të japin rezultate që i përfshijnë të treja dimensionet qëndrueshmëri ekonomike, sociale dhe mjedisore. Kjo fazë është në përputhje me Parimet 7-10 të qasjes SFVCD, duke u përqendruar në përmirësimin strategjik, përhapjen, veprimin shumëaktorial dhe përcaktimin e vizionit. Të gjitha ndërhyrjet e propozuara shqyrtohen kundrejt objektivave të lidhur me strategjinë "Nga ferma në tryezë", duke përfshirë zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, ruajtjen e biodiversitetit, sigurinë ushqimore dhe çmimet e drejta.

Për hartimin e dokumentit të politikave kemi marrë në konsideratë vetëm grupin e parë dhe të tretë, ndërkohë që kuptimi i performancës së sistemit nuk është objekt i analizës së zhvilluar.

2.2 MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Për hartimin e dokumentit të politikave është zbatuar një qasje e që kombinon disa metoda. Burimi kryesor i të dhënave është Raporti Kombëtar "Konsultimi dhe Dialogu Pjesëmarrës për të Forcuar Pozicionin e Fermerëve në Zinxhirin e Vlerës" i publikuar nga ANRD (2025), i cili mbështetet në gjashtë burimetë ndryshme:

- ➔ Statistikat zyrtare nga INSTAT, FAOSTAT dhe EUROSTAT u përdorën për të përcaktuar madhësinë e sektorit, produktivitetin, punësimin dhe performancën në tregje.
- ➔ Dokumentet strategjikë dhe politikat kombëtare, të tilla si Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Rural dhe udhëzimet e Planit Strategjik të PPB, ofruan kontekstin institucional dhe rregullator.
- ➔ Studimet akademike dhe teknike, duke përfshirë raportet nga FAO, AASF, ANRD dhe MARD, ofruan njohuri shtesë mbi strukturën e sektorit të qumështit, treguesit e qëndrueshmërisë dhe vlerësimet e performancës në vitet e mëparshme.

- Të dhënat parësore u mbledhën përmes diskutimeve në 5 grupe të fokusuar dhe intervistave gjysmë të strukturuar të kryera në vitet 2023-2024. Në takime u përfshinë fermerë të qumështit, përpunues, kooperativa, shërbimet e ekstensionit dhe përfaqësues të qeverisjes vendore. Puna në terren u krye në bashkëpunim me ANRD për të siguruar mbledhjen e të dhënave nga të gjitha zonat e Shqipërisë.
- Të dhënat në lidhje me industrinë e përpunimit u nxorën nga faqet e internetit të përpunuesve, certifikimet e cilësisë ISO dhe raportimet e sektorit privat (p.sh., Lufra, Erzeni), për të kuptuar pozicionimin në treg, nivelet e investimeve dhe miratimin e standardeve.
- Vlerësimet e projekteve të zhvillimit, përfshirë ato nga GIZ dhe Bashkëpunimi Italian për Zhvillim, ofruan shembuj praktikë të ndërhyrjeve të udhëhequra nga donatorët dhe mësimet e nxjerra, veçanërisht në aktivitetet pilot siç janë markat e cilësisë dhe lidhjet agro-turistike.

2.3 ANALIZA E TË DHËNAVE

Procesi i analizës së të dhënave u strukturua në tri faza për t'u përputhur me kuadrin metodologjik:

(i) Vlerësimi i Qëndrueshmërisë (referojuni seksionit 9.3. Tabelave të vlerësimit të qëndrueshmërisë për metodën e vlerësimit): Secili prej treguesve u vlerësua kundrejt një shkalle Likert 1-5, bazuar në kriteret e paracaktuara të nxjerra nga udhëzimet metodologjike të FAO dhe të përshtatura në kontekstin shqiptar. Vlerësimi mbuloi katër tregues ekonomikë (p.sh., fitimin, vendet e punës, kontributin tatimor, furnizimin me ushqim), shtatë tregues socialë (p.sh., kushtet e punës, ushqyerjen, përfshirjen gjinore/të rinjve, mirëqenien e kafshëve) dhe pesë tregues mjedisorë (p.sh., emetimet e gazrave serrë, biodiversitetin, mbetjet, toksicitetin).

Rezultatet e nivelit të treguesve u grumbulluan në një rezultat të vetëm të përbërë për çdo shtyllë qëndrueshmërie:

- Ekonomik: Rezultati 3 (i mesëm)
- Social: Rezultati 2 (i ulët)
- Mjedisor: Rezultati 2 (i ulët)

Këto vlerësime u konfirmuan më tej përmes analizës së ekspertëve dhe u përdorën si pika kyçe për analizën në nivel sistemi.

(ii) Analiza e Shkaqeve dhe Sistemeve: Për të kuptuar pse rezultatet e performancës ishin në ato nivele aktuale, ne përdorëm:

- Hartëzimin e zinxhirit të vlerës: gjurmimi i flukseve të qumështit dhe produkteve të qumështit nga ferma te konsumatori.
- Analiza e qeverisjes: analizimi i koordinimit vertikal, llojeve të kontratave, dinamikat e fuqisë negociuese dhe zbatimit.
- Analiza e tregut dhe konsumatorit: shqyrtimi i transmetimit të çmimeve, preferencave të konsumatorëve dhe segmentimit midis tregjeve formale dhe informale.

Kjo analizë identifikoi kufizimet kryesore sistemike: fragmentimi i zinxhirëve të furnizimit, informaliteti, mungesa e besimit dhe fuqisë negociuese dhe zbatimi i dobët i rregullave të sigurisë ushqimore dhe mjedisore.

(iii) Triangulimi¹ dhe konfirmimi: Për të siguruar qëndrueshmërinë dhe koherencën e gjetjeve:

- Të gjitha rezultatet iu nënshtruan rishikimit nga kolegët dhe praktikues të jashtëm.
- Kontrollat e konsistencës narrative u përdorën për të verifikuar nëse vlerësimi përputhej me tërësinë e gjetjeve.
- Gjetjet u analizuan në një matricë sinteze (shih Shtojcën) duke lidhur të dhënat e treguesve me rezultatet e vëzhguara, shpjegimet dhe ndërhyrjet e propozuara.

1 Triangulimi i referohet përdorimit të metodave ose burimeve të shumta të të dhënave në kërkimin cilësor për të zhvilluar një kuptim gjithëpërfshirës të fenomenit që studihet.

3. ANALIZA E ZINXHIRIT TË VLERËS SË QUMËSHTIT NË SHQIPËRI

Blegtoria, veçanërisht prodhimi i produkteve të qumështit, mbetet një aktivitet shumë i rëndësishëm për sektorin e bujqësisë në Shqipëri, duke kontribuar afërsisht në rreth 40% të vlerës totale të prodhimit bujqësor. Produktet e qumështit, sidomos qumështi, jo vetëm që luajnë një rol të rëndësishëm në sigurinë ushqimore kombëtare, por përfaqësojnë një nga sektorët me potencial më të lartë për eksportet agroushqimore. Pavarësisht peshës së tij ekonomike, sektori po kalon një periudhë tranzicioni të shoqëruar me ndryshime strukturore, rënie e numrit të bagëtive të mbarështuara dhe modernizim jo i barabartë në të gjithë zinxhirin e vlerës.

3.1. RËNDËSIA EKONOMIKE DHE ECURIA

Sektori i qumështit në Shqipëri ka përjetuar një transformim të rëndësishëm gjatë tri dekadave të fundit. Ndërsa përmirësimet në produktivitet, veçanërisht rendimenti i kafshëve, kanë qenë të dukshme, numri i përgjithshëm i bagëtive ka pësuar një rënie të vazhdueshme. Midis viteve 2000 dhe 2023, numri i krerëve të lopëve ra me 48%, delet me 31% dhe dhitë me 36%. Gjatë pesë viteve të fundit, rënia ka qenë e ndjeshme, me numrin e lopëve që ka rënë me 27%. Megjithatë, për shkak të përmirësimeve në ushqyerjen e kafshëve, mbarështimin dhe teknologjinë, rendimenti i qumështit për kafshë është përmirësuar me mbi 125% që nga viti 1990, duke zbutur një pjesë të ndikimit nga rënia e popullatës së kafshëve (ANRD, 2024).

Prodhimi i qumështit, i cili arriti kulmin në vitin 2017, ka pësuar rënie të ndjeshme. Nga viti 2017 deri në vitin 2023, prodhimi i qumështit të lopës ra me 22%, qumështi i deles me 26% dhe qumështi i dhisë me gati 20%. Këto prire pasqyrojnë jo vetëm sfidat demografike, siç janë plakja e popullsisë rurale dhe migrimi i të rinjve, por edhe problematika sistematike si qasja e kufizuar në investime për fermerët e vegjël dhe lidhjet e pazhvilluara të tregut (ANRD, 2024).

Struktura e sektorit të qumështit është kryesisht e copëzuar, ku përafërsisht 96% e fermave mbarështojnë më pak se pesë lopë, me shumicën e këtyre fermerëve të vegjël që banojnë në rajone malore ose kodrinore. Fermat e mesme dhe të mëdha, megjithëse shumë më të pakta në numër, kanë tendencë të arrijnë produktivitet më të lartë për shkak të aksesit më të mirë në mekanizim, kujdes veterinar dhe kapital investimi. Fieri dhe Tirana mbeten ndër rajonet më të rëndësishme për prodhimin e qumështit, megjithëse të dhënat e fundit tregojnë një rënie të vazhdueshme të numrit të krerëve edhe në këto zona me traditë të gjatë në mbarështimin e blegtorisë.

3.2. ORGANIZIMI I ZINXHIRIT TË VLERËS SË QUMËSHTIT

Zinxhiri i vlerës së qumështit në Shqipëri përfshin aktorë të ndryshëm të ndërlidhur me njëri-tjetrin: fermerë (të vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj), grumbullues të qumështit, përpunues, grupe fermerësh dhe shitës me pakicë. Çdo nivel kontribuon në mënyrë të veçantë në shpërndarjen e qumështit dhe produkteve të qumështit, megjithatë koordinimi mbetet i dobët, veçanërisht midis fermerëve të vegjël dhe aktorëve të nivelit të dytë.

Në nivelin parësor, fermerëve të vegjël shpesh u mungon infrastruktura bazë, siç janë sistemet higjienike të mjeljes ose mjetet e ftohjes, si dhe mungesë të njohjes së standardeve të sigurisë ushqimore. Si rezultat, qumështi i tyre është shpesh me cilësi më të ulët dhe shitet me një çmim më të ulët në treg (55-64 lekë/litër). Këta fermerë shpesh mbështeten në kanale informale të marketingut ose shitje direkte te konsumatori, ku marzhet e çmimeve janë më të larta, por përputhshmëria me cilësinë dhe sigurinë është e ulët.

Fermat e mesme janë disi më të pajisura me mjete prodhuese dhe përpunuese, shpesh duke përdorur makineri mjeljeje dhe frigoriferë, duke i mundësuar atyre të shesin direkt te përpunuesit. Fermat e mëdha, me tufa që tejkalojnë 100 lopë, dominojnë në cilësi dhe sasi prodhimi. Këto ndërmarrje prodhojnë mbi 7,000 litra/lopë në vit, ndjekin protokolle rigorozë higjienike dhe mbajnë marrëdhënie të qëndrueshme kontraktuale me kompanitë kryesore të përpunimit.

Kompanitë e përpunimit në Shqipëri variojnë nga subjekte të vogla artizanale deri te fabrika të mëdha industriale. Njësitë e vogla të përpunimit, zakonisht të vendosura në zona rurale dhe malore, prodhojnë djathëra dhe kos në mënyrë tradicionale nga qumështi i deles dhe i dhisë, shpesh pa paketim ose markë formale. Përpunuesit e mesëm janë zakonisht biznese familjare që operojnë në zona periurbane, duke ofruar një larmi më të gjerë produktesh dhe herë pas here duke drejtuar pikat e tyre të shitjes me pakicë.

Fabrikat e mëdha të përpunimit kanë investuar në teknologjinë më të fundit, sistemet e pasterizimit dhe linjat e qumështit UHT. Ato mbajnë kontrata formale me fermerët, veçanërisht ata të mëdhenj, duke përcaktuar parametra cilësie siç janë ngarkesa mikrobike, numërimi i qelizave somatike dhe mbetjet e antibiotikëve. Këto kompani gjithashtu ofrojnë mbështetje dhe trajnim veterinar për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm me qumësht të papërpunuar me cilësi të lartë. Disa prej tyre, si Erzeni dhe AGS, shërbejnë si modele duke investuar në qendra grumbullimi, testime laboratorike dhe infrastrukturë logjistike.

Përsa i përket shpërndarjes, produktet e qumështit arrijnë te konsumatorët përmes zinxhirëve të supermarketeve, dyqaneve të specializuara të qumështit, furrave të bukës dhe dyqaneve të lagjes. Ndërsa përpunuesit e mëdhenj dominojnë segmentin e supermarketeve me mallra të standardizuara dhe të paketuara, prodhuesit e vegjël dhe të mesëm kanë tendencë të furnizojnë tregje informale ose pika lokale të shitjes. Në zonat rurale, zinxhirët e shkurtër të vlerës, siç janë shitjet nga ferma tek konsumatori, mbeten të zakonshme, megjithëse shpesh të parregulluara.

3.3. QEVERISJA, MARRËDHËNIET KONTRAKTUALE DHE DINAMIKA FERMER-PËRPUNUES

Koordinimi i dobët dhe nivelet e ulëta të besimit janë sfida të vazhdueshme në zinxhirin e vlerës së qumështit në Shqipëri. Vetëm rreth 44% e fermerëve të vegjël raportojnë se kanë marrëdhënie afatgjata me përpunuesit. Në vend të kësaj, shumë preferojnë transaksione të tregut në vend (spot), duke i shitur blerësit që ofron çmimin më të lartë në momentin e dorëzimit. Ky orientim afatshkurtër kufizon investimet kolektive në përmirësimin e cilësisë dhe logistikës (ANRD, 20240).

Në të kundërt, fermat dhe përpunuesit më të mëdhenj përfitojnë nga marrëdhënie më të qëndrueshme dhe kontraktuale që mundësojnë planifikim më të mirë dhe investime të qëndrueshme. Këto kontrata shpesh përfshijnë mbështetje për shërbimet veterinarë, përmirësime të infrastrukturës (siç janë mjetet e ftohjes) dhe trajnime. Megjithatë, edhe në këto marrëdhënie më formale, fermerët e vegjël mbeten "çmimpranues", duke mos pasur fuqinë negociuese të nevojshme për të negociuar kushtet e favorshme.

Bashkëpunimi përmes kooperativës është një zgjidhje efektive për të rritur fuqinë negociuese të fermerëve në zinxhirët e vlerës. Përmes bashkëpunimit, kooperativat mund të ulin kostot e transaksioneve, të standardizojnë cilësinë e qumështit dhe të rrisin fuqinë negociuese të fermerëve individualë. Një shembull që dëshmon për efektivitetin e bashkëpunimit është grupi i fermerëve "Myzeqeja Farm", i cili bashkëpunon me Kompaninë Erzeni për të ofruar qumësht që përmbush standardet e sigurisë dhe higjienës. Duke funksionuar si një entitet i unifikuar, ky grup fermerësh siguron sasi dhe cilësi të lartë, ndërsa përpunuesi përfiton nga kostot e reduktuara të mbledhjes dhe kontrollit të cilësisë.

3.4. MASAT MBËSHTETËSE DHE INVESTIMET PUBLIKE

Duke njohur rëndësinë strategjike të sektorit të qumështit, qeveria shqiptare ka zbatuar skema të ndryshme mbështetëse. Midis viteve 2019 dhe 2024, mbështetja buxhetore kombëtare u përqendrua

kryesisht në subvencionimin e krerëve të bagëtive të regjistruara. Fermerët me të paktën 10 lopë ose 100 gjedhë mbështeteshin përkatësisht deri në 10,000 lekë/kokë dhe 1,200 lekë/kokë, me mbështetje të kufizuar për çdo njësi. Ndërkohë që mbështetja për litër qumështi të prodhuar u ndërpre në vitin 2020 (ANRD, 2024).

Në vitin 2024, u prezantua një qasje më e orientuar drejt investimeve. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural prezantoi një skemë ku bashkëfinancohej ndërtimi i stallave për bagëtinë dhe blerja e pajisjeve moderne. Këto programe mbulojnë deri në 50% të kostove të investimit, me një tavan mbështetje prej 15 milionë lekësh për objektet dhe 5 milionë lekësh për pajisjet. Qëllimi i kësaj skeme është rritja e produktivitetit dhe qëndrueshmërisë së fermave përmes modernizimit, veçanërisht në fermat e mesme dhe të mëdha.

Pavarësisht këtyre hapave pozitivë, fermerët e vegjël vazhdojnë të përballen me pengesa në aksesin në skemat kombëtare për shkak të procedurave administrative, mungesës së kapacitetit të bashkëfinancimit dhe asistencës teknike të kufizuar.

4. POLITIKAT KOMBËTARE DHE KUADRI STRATEGJIK PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Sektori bujqësor i Shqipërisë luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit dhe mirëqenien e komuniteteve. Duke njohur këtë rëndësi strategjike, Qeveria e Shqipërisë ka miratuar Strategjinë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027, e cila ofron kuadrin gjithëpërfshirës të politikave dhe investimeve për modernizimin e sektorit, promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm rural dhe harmonizimin me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE. Ky kapitull përmbledh kontekstin ligjor dhe strategjik kombëtar si bazë për analizën e politikave të paraqitura në këtë dokument, duke u përqendruar në sfidat e sektorit, prioritetet e zhvillimit dhe rolin në rritje të institucioneve dhe instrumenteve mbështetës.

4.1. VIZIONI STRATEGJIK DHE OBJEKTIVAT KRYESORE

Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027 udhëhiqet nga një vizion që projekton një sektor bujqësor konkurrues dhe të qëndrueshëm që nxit diversifikimin ekonomik, ul varfërinë në zonat rurale dhe kontribuon në integrimin në BE.

Qëllimet kryesore të strategjisë përfshijnë:

1. Rritjen e konkurrueshmërisë dhe modernizimin e bujqësisë dhe agropërpunimit, përmes infrastrukturës së përmirësuar, adoptimit të teknologjisë, qasjes në tregje dhe organizimit më të mirë të prodhuesve.
2. Promovimin e zhvillimit rural dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale, duke përfshirë mbështetjen për shërbimet bazë, sipërmarrjen rurale dhe agroturizmin.
3. Përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht në lidhje me tokën, ujin dhe biodiversitetin.
4. Përmirësimin e qeverisjes së sektorit dhe kapacitetit institucional, duke u përqendruar në ofrimin e shërbimeve, mjetet dixhitale, sistemet e monitorimit dhe kapacitetin e zbatimit të politikave.

Strategjia përshkruan gjashtë prioritetet strategjike dhe njëzet masa përkatëse politike që mbulojnë të gjithë sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, nga mbështetja e prodhimit dhe investimet në ferma deri të shërbimet publike dhe përfshirja social-ekonomike.

4.2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Zhvillimi i sektorit të qumështit në Shqipëri formësohet nga një kuadër ligjor i konsoliduar dhe strategjik që mbështet modernizimin e sektorit të bujqësisë, zhvillimin rural dhe integrimin në BE. Dokumenti kryesor i referencës është Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027 (e miratuar me VKM nr. 460, datë 29.06.2022), e cila ofron vizionin politik për rritjen e konkurrueshmërisë, përmirësimin e sigurisë ushqimore dhe rritjen e të ardhurave në zonat rurale - objektiva shumë të rëndësishme për sektorin e qumështit.

Strategjia identifikon prodhimin dhe përpunimin e qumështit si nënsektor prioritarë për mbështetje për shkak të kontributeve të tyre në punësim, siguri ushqimore dhe jetesën rurale. Ajo thekson nevojën për të investuar në infrastrukturën e fermave, sistemin e grumbullimit dhe kontrollit të cilësisë së qumështit, standardet veterinarë dhe të sigurisë ushqimore, si dhe krijimin dhe mbështetjen e grupeve

të prodhuesve. Këto prioritete janë në përputhje me shtyllat e PPB të BE 2023-2027 dhe Axhendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në nxitjen e prodhimit të qëndrueshëm bujqësor, uljen e emetimeve dhe përmirësimin e mirëqenies së kafshëve.

Korniza ligjore përfshin një sërë ligjesh dhe rregulloresh që rregullojnë prodhimin e qumështit, përdorimin e inputeve, shërbimet veterinarë, sigurinë ushqimore, certifikimin organik dhe menaxhimin e tokës. Ligji nr. 9817/2007 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural është baza e skemave të mbështetjes, ndërsa ligji nr. 9863/2008 "Për ushqimin" dhe ligji nr. 10465/2011 "Për shërbimet veterinarë" janë shumë të rëndësishëm për sigurinë e produkteve të qumështit dhe rregulloret e shëndetit të kafshëve. Legjislacioni plotësues mbi përdorimin e tokës, prodhimin organik dhe kooperativat bujqësorë ndikon gjithashtu në strukturën dhe kapacitetin e sektorit të qumështit për integrimin në treg.

Përsa i përket kuadrit insitucional, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) udhëheq hartimin e politikave, ndërsa AZHBR zbaton skema mbështetëse, duke përfshirë grantet e bashkëfinancuara përmes IPARD III. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe shërbimet veterinarë rajonale sigurojnë përputhshmërinë me standardet e higjienës dhe shëndetit, të cilat janë thelbësore për përmirësimin e zinxhirit të vlerës së qumështit në Shqipëri.

Ky kuadër insitucional dhe ligjor krijon mjedisin e nevojshëm për ndërmarrjen e veprimeve që synojnë modernizimin e sektorit të qumështit dhe përafrimin me standardet e BE për cilësi, qëndrueshmëri dhe konkurrueshmëri. Referencat përkatëse ligjore dhe strategjike janë renditur në Shtojcën 9.1. Korniza Ligjore Bazë për Sektorin e Qumështit dhe 2.2. 9.2. Dokumentet Strategjike që Lidhen me Sektorin e Qumështit.

4.3. HARMONIZIMI ME POLITIKËN E PËRBASHKËT BUJQËSORE TË BE-SË

Një shtyllë kryesore e Strategjisë është përafrimi i Shqipërisë me Politikën e Përbashkët Bujqësore 2023-2027, në pritje të anëtarësimit në BE. Strategjia mbështetet në strukturën, parimet dhe instrumentet e politikave të PPB, duke synuar të ndërtojë bazat për integrimin e plotë në sistemin e qeverisjes bujqësore të BE.

Karakteristikat kryesore të harmonizimit përfshijnë:

- ➔ Shtylla I - Mbështetje Direkte: Ndërsa Shqipëria ende nuk operon pagesa direkte në shkallë të plotë sipas praktikave të PPB-së, Strategjia prezanton instrumente dhe subvencione të mbështetjes direkte që pasqyrojnë objektivat e stabilizimit të mbështetjes së PPB-së. Harmonizimi në të ardhmen parashikon përfshirjen e aspektit mjedisor dhe social, harmonizim të kombinuar dhe forcim të mekanizmave të targetimit.
- ➔ Shtylla II - Zhvillimi Rural: Kuadri bazë i Strategjisë pasqyron programimin e zhvillimit rural të BE, duke u përqendruar në investimet në asete fizike, qëndrueshmërinë mjedisore, diversifikimin e fermave dhe zhvillimin vendor të udhëhequr nga komuniteti.
- ➔ Arkitektura e Gjellbër: Strategjia përfshin kritere që përcaktojnë si të detyrueshme aspektet klimatike dhe mjedisore për të përfituar nga masat e skemave kombëtare të mbështetjes. Kjo përfshin skemat agromjedisore, menaxhimin e qëndrueshëm të ujit dhe tokës, në përputhje me Marrëveshjen e Gjellbër të BE dhe strategjinë "Nga ferma në tryezë".

Instrumenti për asistencë para aderimit për zhvillim rural (IPARD III) është mjeti kryesor i Shqipërisë për zbatimin e masave të harmonizuara me BE. Strategjia angazhohet për përmirësimin e përthithjes së fondeve IPARD, forcimin e sistemeve të monitorimit dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale të nevojshme për menaxhimin efektiv të fondeve të BE.

4.4 KOHERENCA STRATEGJIKE ME OBJEKTIVAT E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE

Dokumenti i politikave synon të mbështesë një politikëbërje më efektive duke identifikuar sfidat, duke i dhënë përparësi ndërhyrjeve me ndikim të lartë dhe duke forcuar lidhjen midis strategjisë dhe ndërhyrjeve konkrete. Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027 ofron një pikënisje strategjike për këtë proces. Dokumenti i politikave ndërtohet mbi kornizën e Strategjisë për të:

- Prioritizuar investimet dhe reformat që përshpejtojnë rritjen e konkurrueshmërisë dhe qasjen në tregje, duke përfshirë mbështetjen për zinxhirët e vlerave të zgjedhura, infrastrukturën dhe organizimin e fermerëve;
- Propozuar masa që rrisin gjithëpërfshirjen dhe qëndrueshmërinë e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, në përputhje me qëllimet e Strategjisë për uljen e varfërisë në zonat rurale, nxitjen e sipërmarrjes dhe përmirësimin e shërbimeve publike;
- Mbështetur inovacionin institucional, me rekomandime për përmirësimin e qeverisjes, përdorim më të mirë të të dhënave dhe evidencave, si dhe mekanizmat e planifikimi me pjesëmarrje.

Qasja e integruar dhe shumësektoriale e Strategjisë pasqyrohet në metodologjinë e vlerësimit të këtij dokumenti politikash, i cili shqyrton se si objektivat ekonomikë, mjedisorë dhe socialë mund të arrihen njëkohësisht përmes ndërhyrjeve të synuara.

4.5. TEMATIKAT NDËRSEKTORIALE DHE DREJTIMET PËR TË ARDHMEN

Strategjia mbështetet nga disa tematika ndërsektoriale, të cilat trajtohen gjithashtu në këtë dokument politikash:

- Dixhitalizimi dhe inovacioni: Strategjia parashikon përmirësimin e sistemeve të të dhënave, prezantimin e teknologjive të bujqësisë precize dhe dixhitalizimin e shërbimeve të ekstensionit. Këto prioritete pasqyrohen në rekomandimet e dokumentit të politikave mbi zgjidhjet inteligjente dhe transformimin dixhital të shërbimeve rurale.
- Zbutja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbrojtja e mjedisit: Strategjia promovon përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, menaxhimin e integruar të ujërave dhe përdorimin e qëndrueshëm të tokës. Dokumenti i politikave përforcon këto objektiva përmes kriterëve që i japin prioritet ndërhyrjeve të kanë ndikim pozitiv në mjedis.
- Gjithëpërfshirja sociale dhe angazhimi i të rinjve: Strategjia synon në mënyrë të qartë gratë, të rinjtë dhe grupet e cënueshme të popullsisë në zonat rurale. Dokumenti i politikave vlerëson se si masat ekzistuese dhe të propozuara performojnë në aspektin e barazisë dhe fuqizimit të këtyre grupeve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë punësimit, migrimit dhe dinamikave demografike.

Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027 përfaqëson udhëzuesin për një sektor bujqësor modern, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në Shqipëri, të përafruar me politikat e BE. Kjo strategji përcakton objektiva, role institucionale dhe mjete të qarta zbatimi të politikave për të transformuar zonat rurale dhe për t'u përgatitur për anëtarësim në BE. Ky dokument politikash ndërtohet drejtpërdrejt mbi këtë bazë strategjike, duke ofruar njohuri të bazuara në evidenca dhe rekomandime praktike që mund të operacionalizojnë më tej objektivat kombëtare. Integrimi i ngushtë midis kësaj analize politikash dhe vizionit të Strategjisë siguron qëndrueshmëri, mbështet koherencën e politikave dhe kontribuon në një proces politikash më efikas dhe të përgjegjshëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri.

5. PERFORMANCA E SISTEMEVE USHQIMORE - RASTI I QUMËSHTIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TIJ

5.1. PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË QËNDRUESHMËRISË

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të vlerësimit të qëndrueshmërisë për zinxhirin e vlerës së qumështit në Shqipëri, duke mbuluar shtyllat e tij ekonomike, sociale dhe mjedisore. Duke përdorur shkallën Likert 1 deri në 5 të projektit (shumë e ulët = 1, shumë e lartë = 5), çdo dimension merr një pikëzim kryesor të mbështetur nga evidencat kryesore të nxjerra nga literatura dhe gjetjet e fundit në terren (MARD 2021; ANRD 2024; AASF 2018; Studimi i sektorit të qumështit, rishikimet e IPARD). Kjo tabelë vlerësimi është menduar si një panoramë bazë e shkurtër; një diskutim i detajuar i rezultateve dhe faktorëve nxitës për secilin dimension të qëndrueshmërisë do të pasojë në seksionet e ardhshme.

Tabela 1. Përmbledhje e vlerësimit të qëndrueshmërisë sipas dimensioneve

TREGUESI	REZULTATI I VLERËSIMIT	ARSYETIM / EVIDENCA
Dimensioni ekonomik i zinxhirit të vlerës së produkteve të qumështit në Shqipëri	3 - Moderuar	Në përgjithësi, bizneset dhe furnizimi me produkte të qumështit është i qëndrueshëm, por rentabiliteti, investimet dhe formalizimi janë të kufizuara - duke përputhur nivelin e vlerësimit "I moderuar".
Dimensioni social i zinxhirit të vlerës së produkteve të qumështit në Shqipëri	2 – I ulët	Shpërndarja e vlerës së shtuar dhe fuqia negociuese: Zinxhiri shumë i copëzuar i vlerës i lë fermerët e vegjël çmimpranues; pagesat e vonuara dhe marrëveshjet e pashkruara janë të zakonshme (ANRD, 2024). Të drejtat dhe siguria e punëtorëve: Një numër i konsiderueshëm i popullsisë në zonat rurale varen kryesisht nga puna informale familjare; orë të gjata pune, mungesë mbrojtjeje sociale, mungesë të fuqisë punëtore dhe punë e rëndë (AASF, 2018; ANRD, 2024). Ushqimi dhe shëndeti: ≈50% e qumështit anashkalon kontrollet e sigurisë, duke paraqitur rreziqe kontaminimi pavarësisht përmirësimeve të pjesshme në fabrikat formale (ANRD, 2024; AASF, 2018; MARD, 2021). Traditat kulturore: Trashëgimi i fortë (transhumanca, djathërat tradicionalë) ende e paprekur, por e kërcënuar nga shpopullimi i zonave rurale dhe mungesa e sigurisë ushqimore (AASF, 2018; MARD, 2021). Përfshirja e grave dhe të rinjve: Gratë janë të nënpërfaqësuar në pronësi/role drejtuese; angazhimi i të rinjve është i ulët, me shumë të rinj që po e braktisin bujqësinë (ANRD, 2024; Intervistë në terren, 2024).

TREGUESI	REZULTATI I VLERËSIMIT	ARSYETIM / EVIDENCA
		Mirëqenia e kafshëve: Standardet minimale zbatohen, por në mënyrë inkonsistente; stallat dhe kujdesi veterinar shpesh janë në gjendje shumë të keqe (AASF, 2018). Institucionet: Shërbime ekstensionit shumë të dobëta; zbatimi i kufizuar i rregullave të sigurisë ushqimore dhe punës, megjithëse ekziston kuadri i duhur ligjor dhe politik (ANRD, 2024). Këta faktorë tregojnë mungesë të barazisë dhe gjithëpërfshirjes sociale, në përputhje me një nivel të "ulët" qëndrueshmërie.
Dimensioni mjedisor i zinxhirit të vlerës së produkteve të qumështit në Shqipëri	2 – Ulët	Gjurmët e karbonit: Intensiteti i lartë i gazrave serrë për litër qumështi të prodhuar (lopë me rendiment të ulët), asnjë masë për zbutje e ndikimit të ndryshimeve klimatike ose përdorimit të energjisë së rinovueshme; ka njëfarë ndërgjegjësimi, por veprimet e ndërmarra janë minimale (MARD, 2021). Ruajtja e tokës: Mbi/nënkullotja dhe braktisja e tokës kërcënojnë qëndrueshmërinë e kullotave; monitorimi është i dobët (lidhja IPARD me rënien e nivelit të përdorimit të kullotave). Biodiversiteti: Racat vendase dhe bimët autoktone po shkojnë drejt zhdukjes; programet e ruajtjes dhe regjistrat e racave janë të pakta (ANRD, 2024). Humbja dhe mbetjet e ushqimit: Përdorimi i paketimeve si qeset plastike/Tetrapak po rriten, pa infrastrukturë riciklimi ose masa sektoriale (udhëzimet IPARD). Toksiciteti: Përdorimi i pesticideve është në nivel të ulët, por rreziku i mbetjeve të antibiotikëve është i lartë; testimi është i rrallë dhe shqetësimet për AMR janë kryesisht të padokumentuara (ANRD, 2024). Së bashku, këto çështje tregojnë avancim të kufizuar dhe zbatim të dobët, duke dëshmuar për një nivel të ulët të qëndrueshmërisë mjedisore.

Rezultatet bazohen në një shkallë Likert 1-5 nga qëndrueshmëria shumë e ulët (1) në shumë të lartë (5), sipas metodologjisë së përcaktuar. Ky vlerësim përqendrohet në rezultatet aktuale të performancës, pa analizuar shkaqet ose rekomandimet e politikave (që do të trajtohen veçmas në të kuptuarit e performancës së qëndrueshmërisë së sistemeve, i cili nuk është objekt i analizës sonë).

5.2 VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË

Në seksionin vijues, do të analizojmë performancën e sektorit të qumështit në tre dimensionet, ekonomike, sociale dhe mjedisore. Analiza fillon me aspektin ekonomik: duke analizuar produktivitetin, punësimin, të ardhurat etj. Pastaj shqyrtohet dimensionin social, njerëzit dhe kultura, duke përfshirë punën në ferma dhe fabrika, sigurinë ushqimore, traditat në zonat rurale dhe se si ndahen në mënyrë të drejtë përfitimet. Së fundmi, analizohet aspekti mjedisor, se si sektori ndikon në natyrë, duke përfshirë emetimet e gazrave

serrë, përdorimin e tokës, biodiversitetin dhe mbetjet. Së bashku, këto tri pikëpamje japin një pamje të qartë se ku ndodhet sektori i qumështit në Shqipëri aktualisht dhe në cilat aspekte mund të bëhen përmirësimet më të mëdha.

5.2.1. PERFORMANCA EKONOMIKE

a) Përftimii fermave

Në vitin 2022, sektori i qumështit në Shqipëri arriti një marzh bruto mesatar prej 37, 000 lekësh (≈370 euro) për punëtor me kohë të plotë, që u rrit në 74,843 lekë (≈624 euro) duke treguar për fitimin modest që gjeneron sektori (FAO, 2023). Në vitin 2022, hendeuku i fitimit midis madhësive të ndryshme të fermave ishte i konsiderueshëm: fermat e vogla kishin një marzh bruto mesatar fitimi prej rreth 300,000 lekësh (≈2,500 euro) për fermer, me një mesatare prej 270,000 lekësh (≈2,250 euro); fermat e mesme i dyfishuan këto shifra, duke shënuar një mesatare fitimi prej afërsisht 680,000 lekësh (≈5,700 euro) dhe një medianë³ prej 530,000 lekësh (≈4,400 euro); ndërsa fermat e mëdha i tejkaluan të gjitha të tjerat me një renditje madhësie, duke regjistruar një mesatare prej 2,510,000 lekësh (≈€20,900) dhe një medianë prej 1,940,000 lekësh (≈€16,200). Këto shifra, tregojnë qartë se ekonomitë e shkallës favorizojnë ndjeshëm fermat e mëdha, ndërsa fermerët e vegjël mbeten me marzhe shumë më të ulëta fitimi, pavarësisht kushteve të njëjta të tregut.

Sektori i qumështit në Shqipëri ka shënuar përmirësime të moderuara financiare, me marzhin mesatar bruto për punonjës me kohë të plotë që u rrit nga 60,719 lekë (≈506 euro) në vitin 2019 në 74,843 lekë (≈624 euro) në vitin 2022. Megjithatë, kjo rritje u ndikua kryesisht nga çmimet, pasi çmimi i qumështit u rrit me 33% (nga 40.2 ALL/L [≈0.35 euro] në 55.9 ALL/L [≈0.47 euro]), ndërkohë që kostot e prodhimit u rritën me 30%. Fermat e vogla dhe të mesme përfituan shumë pak, ndërsa fermat e mëdha përfituan në mënyrë jo të barabartë, marzhet bruto të fitimit u rritën nga 177,061 lekë (≈1,475 euro) në 250,800 lekë (≈2,090 euro), duke treguar për rritje të pabarazisë në këtë sektor. Pavarësisht të ardhurave nominale më të larta, fermerët e vegjël mbeten të pafavorizuar, duke u përballur me sfida në rritjen e numrit të bagëtive të mbarështuara (+0.83 lopë/fermë) dhe nivele të ulëta fitimi. Pa ndërhyrje në politikat mbështetëse, ky trend rrezikon të largojë nga tregu fermerët e vegjël, duke përqendruar fitimet tek një numër i kufizuar prodhuesish të mëdhenj (FAO, 2023).

Tabela 2: Marzhi neto mesatar mujor për një të punësuar me kohë të plotë në sektorin e bujqësisë dhe niveli i pagës mesatare në nivel kombëtar

	MESATARJA/ MUAJ	PAGA MESATARE MUJORE	PËRQINDJA NDAJ PAGËS MESATARE
	ALL		
Marzhi neto mesatar mujor në 2022	37,000	57,635	64%
Marzhi neto mesatar mujor në 2019	30,322	57,635	53%

Burimi: FAO (2023)

Në përgjithësi, këto rezultate tregojnë për përfitim të kufizuar të sektorit të bujqësisë në Shqipëri, veçanërisht në sistemet e bujqësisë ekstensive. Fermat më moderne mund të jenë pak më fitimprurëse

2 Afërsisht.
3 Mediana është numri që ndodhet në mes kur të gjitha vlerat janë rreshtuar nga më e vogla te më e madhja, duke mos marrë në konsideratë ndikimin e vlerave ekstreme.

për ekonomive të shkallës dhe efikasitetit të lartë, por ato mbeten të kufizuara nga tregu i vogël dhe çmimet tavan. Niveli i fitimit tek përpunuesit është relativisht më i lartë (shumë prej tyre kanë zgjeruar aktivitetin dhe kanë investuar), por edhe ata përballen me marzhe të ulëta fitimi, pjesërisht sepse duhet të paguajnë çmime të larta për të siguruar furnizimin nga fermat e mëdha dhe për të konkurruar me produktet e importit që prodhohen me një kosto të ulët (MARD, 2021).

Kjo diferencë në nivelin e fitimit i detyron fermerët e vegjël ose të ndalojnë aktivitetin, ose të rrudhin madhësinë e tij. Aktualisht, blegtorët po e zvogëlojnë numrin e krerëve të mbarështuara: për shembull, një fermer i mesëm në vitin 2022, përballë kostove më të larta të ushqimit dhe punës, uli tufën e tij nga 12 në 5 lopë për të minimizuar humbjet (intervistë në terren, 2022, nga autori).

Të ardhurat nga shitjet

Të ardhurat nga sektori i qumështit ndryshojnë shumë në varësi të madhësisë së fermës dhe aksesit në treg: Fermat e vogla (1-2 lopë) fitojnë të ardhura minimale në para të gatshme, pasi shumica e qumështit konsumohet vetë. Shitjet janë të kufizuara (disa litra/ditë) dhe përbëjnë vetëm të ardhura shtesë në buxhetin familjar (AASF, 2018). Këto familje shpesh varen nga burime të tjera si të korrat, remitancat ose puna jashtë fermës. Fermat e mesme (6-10 lopë) mund të gjenerojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave familjare, sidomos ato që furnizojnë tregjet urbane ose përpunuesit e mëdhenj. Këta prodhues kanë tendencë të shohin përfitime më të larta (AASF, 2018). Qumështi i deles/dhisë ka çmime më të larta për litër sesa qumështi i lopës, por të ardhurat totale janë të kufizuara nga vëllimet e ulëta të prodhimit (AASF, 2018). Për shumicën e fermerëve të vegjël, të ardhurat nga produktet e qumështit janë të paqëndrueshme. Fermerët janë çmimpranues, me çmimet e qumështit të papërpunuar që luhaten në mënyrë sezonale ose për shkak të tepricës së prodhimit. Konsultimet me fermerët (ANRD 2024) tregojnë se shumë prodhues të vegjël përballen me paqëndrueshmëri të të ardhurave dhe cenueshmëri për shkak të luhatjeve të çmimeve dhe mungesës së kontratave formale. Në periudhën e pranverës, çmimet shpesh bien, duke ulur nivelin e përfitimit. Fermerët me kontrata formale përfitojnë nivele të ardhurash më të qëndrueshme, me pagesa të rregullta mujore dhe ndonjëherë çmime më të larta të bazuara në cilësinë e produktit (ANRD, 2024). Fermat e mëdha tregtare përfitojnë nga ekonomitë e shkallës dhe mund të riinvestojnë fitimet, duke i siguruar fermerëve paga më të mira. Megjithatë për familjet tipike fermere me një ose dy lopë, produktet e qumështit shërbejnë si mundësi për të mbijetuar dhe jo si rruga e duhur për të dalë nga varfëria. Fragmentimi i sektorit përputhet ngushtë me modelet e varfërisë së komuniteteve rurale.

Aksesi në financë

Investimet përgjatë zinxhirit të vlerës së qumështit janë shpërndarë në mënyrë të pabarabartë, me shumica të mëdha për një pjesë të vogël të fermerëve dhe pagesa minimale për shumicën prej tyre. Historikisht, bankat tregtare kanë treguar pak interes për të dhënë kredi për sektorin e bujqësisë. Një studim i vitit 2018 nga AASF theksoi vështirësitë me të cilat përballen fermerët dhe grupet e fermerëve në sistemin e kredimarrjes. Për shembull, grupi i fermerëve të Myzeqesë ishte në gjendje të blinte një traktor vetëm duke i detyruar anëtarët individualë të merrnin kredi me një normë interesi prej 24%, pasi bankat nuk ishin të gatshme t'i jepnin kredi grupit si një entitet juridik (ANRD, 2024).

Dy sfida kryesore vazhdojnë të pengojnë investimet në fermë: normat e larta të interesit dhe mungesa e kolateralit, veçanërisht për shkak të titujve të paqartë ose të paregjistruar të tokës.

Sipas skemave kombëtare të mbështetjes, fermerët e qumështit që plotësonin kriteret bazë specifike - si zotërimi i të paktën dhjetë lopëve kualifikoheshin për subvencione për kokë ose 50% bashkëfinancim për investime në infrastrukturë dhe pajisje (ANRD, 2024). Përmes IPARD II (2014-2020), u siguruan fonde për 13 projekte të lidhur me prodhimin e qumështit dhe disa investime në përpunim (MARD, 2021). Veçanërisht, 40% e fermave përfituese morën 68% të financimit total IPARD, ku secila investoi rreth 0.5 milion euro në përmirësime në shkallë të gjerë (MARD, 2021). Këto investime lejuan ndërtimin e stallave moderne, instalimin e makinerive të mjeljes dhe rezervuarëve të ftohjes, si dhe përmirësimet e sistemeve të ushqyerjes së kafshëve. Si rezultat, disa ferma arritën standardet e BE në sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e kafshëve, duke u pozicionuar si furnizues të besueshëm për përpunuesit kryesorë (MARD, 2021).

Në vitin 2024, MBZHR prezantoi një skemë investimi që synon rritjen e produktivitetit dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm rural. Kjo skemë përfshin dy masa që ndikojnë drejtpërdrejt në sektorin e qumështit: ndërtimin e stallave për mbarështimin e lopëve, deleve dhe dhive, dhe blerjen e pajisjeve dhe makinerive për modernizimin e fermave. Çdo masë siguron mbulim 50% të faturës tatimore për investimet përkatëse.

Këto skema mbështetëse janë hartuar për të pajisur fermerët me burime financiare dhe teknologji moderne, duke rritur si cilësinë ashtu edhe sasinë e prodhimit, ndërsa njëkohësisht kontribuojnë në përmirësimin e jetesës së banorëve të zonave rurale dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Megjithatë, shumica e fermerëve të vegjël morën pak ose aspak mbështetje. Shumë u mbështetën në përmirësime të vogla të vetëfinancuara ose mbetën të pandryshuara. Kjo pabarazi ka rezultuar në një sektor të polarizuar: një grup i vogël fermash të financuara mirë po modernizohen me shpejtësi dhe po bëhen më konkurruese, ndërsa shumica e fermave të vogla nuk kanë mundësi për të investuar ose për t'u rritur për shkak të kapacitetit të kufizuar financiar.

b) Koordinimi dhe kontratat

Marrëdhëniet vertikale në zinxhir variojnë nga transaksionet informale të momentit deri te kontratat formale. Shumica e fermerëve të vegjël nuk kanë kontrata të shkruara, duke shitur qumësht çdo ditë tek grumbulluesit ose bulmetoret lokale bazuar në marrëveshje të pashkruara (ANRD, 2024). Ky rregullim informal i lë fermerët në pozita vulnerabël, pa garanci për çmimet apo shitjen e produkteve. Gjithashtu, kjo situatë shoqërohet me vonesa të pagesave nga grumbulluesit dhe përpunuesit.

Vetëm fermat e mëdha dhe disa grupe të organizuara kanë mundësinë të sigurojnë kontrata formale për shitjen e qumështit. Përpunuesit e mesëm dhe të mëdhenj shpesh nënshkruajnë kontrata me fermat që ofrojnë sasi të mëdha dhe cilësi të lartë të produkteve, duke specifikuar oraret e mbledhjes, standardet dhe kushtet e pagesës (ANRD, 2024). Për shembull, grupi i fermerëve të Myzeqesë ka një kontratë 15 vjeçare me kompaninë përpunuese Erzeni, duke përcaktuar pagesa tre herë në muaj për dërgesat e qumështit (ANRD, 2024). Këto kontrata rrisin parashikueshmërinë dhe pagesat në kohë të fermerëve.

Megjithatë, shembuj të tillë janë shumë të rrallë në Shqipëri. Në përgjithësi zinxhiri vlerës së qumështit mbetet i pastruktutuar dhe informal: ferma të vogla që shesin te qumështoret e vogla ose tregtarët informalë. Marrëdhëniet e bazuara në besim janë të zakonshme, por kur ndodhin ndërprerje (p.sh., një mbledhës ndalon blerjen ose ul çmimin), fermerët kanë mundësi të kufizuara reagimi.

Në diskutimet në grupe të fokusuara, fermerët shpesh përmendën mungesën e fuqisë blerëse, ku blerësit e mëdhenj mund të përcaktojnë kushtet për fermerët e vegjël që nuk kanë alternativa të tjera shitje (ANRD, 2024). Aty ku ekzistojnë, grupet e fermerëve kanë rritur fuqinë negociuese të fermerëve. Fermerët që janë pjesë e këtyre grupeve raportojnë çmime pak më të larta dhe më të qëndrueshme për shkak të negociatave me blerësit (ANRD, 2024).

Në përgjithësi, zinxhiri i vlerës është i ndarë në dy pjesë: një segment formal me kontrata dhe standarde më të rrepta (që përfshin ferma dhe përpunues më të mëdhenj) dhe një segment informal ku transaksionet janë të momentit dhe kryesisht të padokumentuara.

Përqendrimi i tregut

Përsa i përket përpunimit, industria është konsoliduar dhe modernizuar në mënyrë të pjesshëm. Disa kompani të mëdha (Erzeni, Lufra) dominojnë shitjet në tregun e qumështit dhe kanë investuar ndjeshëm në kapacitete dhe teknologji (MARD, 2021). Rezultatet nga zbatimi i programit IPARD treguan se fabrikat kryesore të qumështit operojnë vetëm me 50-60% të kapacitetit të tyre, duke e lënë të pashfrytëzuar kapacitetin e tyre të mbetur (MARD, 2021).

Ky nënshfrytëzim vjen për shkak të aksesit të kufizuar në qumësht me cilësi të lartë, pasi përpunuesit janë të kufizuar nga fragmentarizimi i fermave dhe konkurrenca e sektorit informal. Megjithatë, përpunuesit e mëdhenj operojnë në mënyrë efektive, afër standardeve të BE, në pritje të rritjes së kërkesës në të ardhmen (MARD, 2021).

Në të kundërt, shumë dyqane të vogla të qumështit ende u shërbejnë blerësve lokalë me produkte tradicionale qumështi. Ata konkurrojnë duke marrë qumështin nga të njëjtët fermerë të vegjël, shpesh duke pranuar qumësht që nuk respekton standardet bazë dhe me çmime pak më të ulëta. Bashkëjetesa e përpunuesve modernë dhe atyre artizanalë është karakteristikë e tregut të qumështit në Shqipëri.

Vlera e shtuar dhe riinvestimi

Në nivelin e përpunimit, disa firma të mëdha kanë qenë përfituese të mbështetjes nga IPARD, duke përbërë 75% të të gjitha projekteve të investimeve në përpunimin e qumështit në kuadër të IPARD II (MARD, 2021). Këto kompani zgjeruan linjat e përpunimit dhe/ose instaluan impiante për trajtimin e ujërave të ndotura (MARD, 2021). Megjithatë, në përgjithësi riinvestimi në zinxhirin e vlerës së qumështit mbetet i kufizuar për shkak të fitimeve modeste. Shumë fabrika të vogla qumështi operojnë në mënyrë gjysmë formale për të shmangur taksat, duke mbijetuar me marzhe të ulëta fitimi. Kompanitë formale raportojnë se niveli i TVSH nuk është favorizues. Këto kompani paguajnë TVSH për inputet dhe blerjet e qumështit, ndërsa konkurrentët informalë nuk e bëjnë këtë, duke krijuar shtrembërime të tregut (MARD, 2021).

Intensiteti i ulët i kapitalit të prodhimit si për lopët, ashtu edhe për gjedhët rezultoi në produktivitet të ulët, kosto relativisht të larta prodhimi dhe fitim të ulët, gjë që nga ana tjetër kufizon akumulimin e kapitalit për investime të reja, duke sjellë kështu nivele të ulëta prodhimi dhe produktiviteti për shumë ferma (MARD, 2021).

Moszbatimi i rregullave të qarta të tregut dëmton gjenerimin e fitimit në të gjithë sektorin. Si rezultat, kontributi i sektorit të qumështit në PBB dhe të ardhurat nga taksat është më i ulët nga sa duhet të ishte realisht, me një pjesë të konsiderueshme të zinxhirit të vlerës që nuk i nështrohet taksave ose nuk raporton për vlerën reale të shitur.

Struktura e fermave

Fermat e qumështit në Shqipëri karakterizohen nga një copëzim shumë i madh. Shumica dërrmuese e prodhuesve janë fermerë të vegjël që mbarështojnë një numër të kufizuar krerësh. Të dhënat tregojnë se mbi 50% e fermave të qumështit mbajnë vetëm 1-3 lopë (AASF, 2018). Sipas studimit të AASF të vitit 2018, afërsisht 60% e familjeve që mbajnë bagëti kanë vetëm një lopë, kryesisht për vetëkonsum (AASF, 2018). Vetëm 8% e fermave të bagëtive kanë 5 ose më shumë lopë (AASF, 2018), dhe subjektet e mëdha (p.sh. fermat komerciale me >100 lopë) janë shumë të pakta.

Konsultimet me fermerët e konfirmojnë këtë strukturë: rreth 96% e fermave kanë më pak se 5 lopë (ANRD, 2024), dhe shumë prej tyre janë prodhues informalë, që shesin qumësht të papërpunuar direkt tek konsumatorët. Një fragmentim i tillë kufizon furnizimin e përgjithshëm dhe e bën logjistikën e grumbullimit shumë sfiduese. Kjo gjithashtu do të thotë që krerët janë të shpërndara në shumë ferma të vogla, shpesh të cilave u mungon kapitali dhe njohuritë për të zgjeruar aktivitetin. Nga njëra anë, po zhvillohet një polarizim gradual, një numër i vogël fermash dhe grupe fermerësh më të mëdha po rrisin numrin e krerëve dhe po investojnë në stalla moderne; nga ana tjetër, shumë fermerë të vegjël po dalin nga tregu i qumështit. Për shembull, intervistat në vitin 2022 në një fshat që prodhonte pak produkte qumështi raportuan se numri i familjeve që mbanin lopë ra nga 350 në vetëm 70 gjatë viteve të fundit, pasi shumë fermerë të vegjël shitën kafshët e tyre për shkak të fitimeve të ulëta dhe mungesës së fuqisë punëtore (intervistë në terren nga autori, 2022).

Në të njëjtën kohë, disa investitorë kanë rritur kopetë - për shembull, një fermer mori përsipër lopët e fermerëve të tjerë dhe e rriti numrin e kopesë në 120 lopë, si dhe investoi në një fabrikë të vogël përpunimi (intervistë në terren nga autori, 2022). Këto dinamika tregojnë një ristrukturim të ngadaltë: ndërsa ferma mesatare mbetet shumë e vogël, pjesa e qumështit që vjen nga ferma më të mëdha dhe më profesionale po rritet.

Organizimi i zinxhirit të vlerës dhe struktura e tregut

Zinxhiri i vlerës së produkteve të qumështit në Shqipëri përfshin disa nivele, por dominohet nga shumë prodhues të vegjël që futen në një sektor përpunimi relativisht të përqendruar. Shumica e fermerëve

prodhojnë qumësht pjesërisht për konsum vetjak dhe shesin pjesën e mbetur direkt tek konsumatorët ose tek grumbulluesit informalë (ANRD, 2024).

Në hallkën tjetër, grumbulluesit e qumështit kanë një rol shumë të rëndësishëm në zinxhirin e vlerës. Këta ndërmjetës mbledhin qumësht nga ferma të vogla, shpesh duke përdorur mjete pa kushtet e nevojshme ftohëse dhe e dorëzojnë atë në fabrikat e qumështit. Disa janë ndërmjetës të pavarur, ndërkohë që pjesa tjetër janë të lidhur me kompanitë e përpunimit.

Ekziston gjithashtu një numër i kufizuar grupesh të fermerëve ose shoqatash që grumbullojnë qumështin e anëtarëve të tyre. Për shembull, grupi i fermerëve "Myzeqeja Farm" në Lushnje ka 60 fermerë anëtarë dhe operon si një qendër për grumbullimin e qumështit, duke e shitur ekskluzivisht te një përpunues i madh sipas një kontrate afatgjatë (intervistë në terren, 2018). Grupe të tilla formale janë ende të rralla, por demonstrojnë përfitimet e bashkëpunimit dhe koordinimit të fermerëve. Anëtarët e "Myzeqeja Farm" negociojnë bashkërisht çmimet dhe marrin inpute prodhimi me kosto më të ulët (ANRD, 2024).

Sa i përket përpunimit, ekziston një përzierje e subjekteve të vogla artizanale dhe disa përpunuesve të mëdhenj. Vlerësimet tregojnë se vetëm 10-15 përpunues të mëdhenj merren me pjesën më të madhe të qumështit të tregtuar zyrtarisht, me dy kompanitë më të mëdha që dominojnë një pjesë të konsiderueshme të tregut (MARD, 2021). Përpunues dhe eksportues si p.sh., Lufra, Erzeni, Gjirofarma dhe AGS përpunojnë dhjetëra mijëra litra në ditë dhe operojnë linja moderne pasterizimi dhe paketimi.

Ndërkohë, qindra subjekte të vogla përpunimi janë të shpërndara në zona rurale, shumë prej të cilave operojnë në mënyrë gjysmëformale. Kanalet e shpërndarjes dhe shitjes me pakicë përfshijnë shitjet direkt tek konsumatori (për qumësht të papërpunuar dhe djathë të prodhuar në fermë), dyqane lokale dhe supermarkete në qendrat urbane të cilat shesin produktet e markave kryesore (ANRD, 2024).

c) Kontributi tatimor

Sektori i qumështit në Shqipëri kontribuon relativisht në nivele të ulëta në të ardhurat nga taksat, sepse një pjesë e madhe e tregut është informal: tregtarët formalë mbajnë mbi supe kostot e TVSH dhe zbatimit të rregullave, ndërsa shumë përpunues, grumbullues dhe shitës të vegjël nuk e bëjnë këtë, duke krijuar rregulla loje të pabarabarta dhe duke ulur vlerën e tatueshme (MARD, 2021). Kjo lloj konkurrence në treg e ka zbutur tkurrjen e sektorit duke i lejuar fermerët e vegjël të shesin qumësht pa përmirësime të kushtueshme, megjithatë njëkohësisht ngadalëson formalizimin dhe regjistrimin e shitjeve (MARD, 2021). Fragmentimi rajonal e përkeqëson situatën më tej, qumështi i freskët, i cili prishet shpejt, vazhdon të shitet kryesisht brenda rretheve. Shumë pika të vogla tregtare mbeten jashtë vëmendjes së tatimeve, ndërsa kërkesa në qytete për produkte të ambalazuara e të markuara po rritet gradualisht, duke zgjeruar ngadalë rrjetin formal të TVSH. Nëse prodhimi vendas ulët dhe qumështi UHT nga BE fiton më shumë hapësirë në treg, shteti do të mbledhë TVSH nga importet, por në të njëjtën kohë rrezikon të dobësojë përpunuesit vendas. Për këtë arsye, pa ulur informalitetin dhe pa rritur efikasitetin, kontributi i sektorit në taksa do të mbetet shumë poshtë potencialit të tij.

d) Furnizimi me ushqim

Prodhimi i përgjithshëm i qumështit

Prodhimi total i qumështit u rrit vazhdimisht nga fillimi i viteve 2000 deri në mesin e viteve 2010 (AASF, 2018). Qumështi i lopës, i cili përbën rreth 85% të vëllimit kombëtar të qumështit, u rrit nga afërsisht 807 mijë ton në vitin 2000 në 975 mijë ton në vitin 2016 (AASF, 2018). Qumështi i gjedhëve (dele/dhi) gjithashtu u rrit në mënyrë modeste, nga afërsisht 141 mijë në 170 mijë ton gjatë së njëjtës periudhë (AASF, 2018). Kjo rritje e çoi prodhimin total të qumështit në rreth 1.14-1.16 milion ton deri në vitet 2016-2017, një pikë kulmore për sektorin (AASF, 2018; ANRD, 2024). Megjithatë, pas arritjes së kulmit në vitin 2017, prodhimi total i qumështit filloi të ulët, duke shënuar një rënie prej 22% deri në vitin 2023. Qumështi i lopës, kontribuesi më i madh në prodhimin total, u ul me 22%, ndërsa prodhimi i qumështit të deles dhe dhisë ra përkatësisht me 26% dhe 20%,. Pavarësisht këtyre rënieve, rritja e rendimentit për kafshë tregon se përmirësimet e produktivitetit kanë ndihmuar në zbutjen e ndikimit të rënies së numrit të bagëtive, duke reflektuar përparimet në teknikat bujqësore dhe menaxhimin e blegtorisë (ANRD, 2024)

Numri i bagëtime të mbarështuara

Një faktor kyç në trendin e prodhimit është tkurrja e krerëve të mbarështuara. Sektori i qumështit pësoi një rënie të ndjeshme të numrit të kafshëve pas viteve 1990, dhe kjo rënie ka vazhduar edhe në vitet e fundit. Në vitin 2000, Shqipëria kishte rreth 728,000 bagëti (numri total i bagëtime) sipas të dhënave të INSTAT (AASF, 2018). Deri në vitin 2016, numri i bagëtime ra në $\approx 492,000$ (AASF, 2018). Duke u përqendruar konkretisht te lopët e qumështit, në vitin 1996 kishte rreth 483,000 lopë qumështi, duke rënë në vetëm $\approx 232,000$ deri në vitin 2023 (ANRD, 2024). Numri i deleve dhe dhive është zvogëluar po ashtu (nga ≈ 3.0 milion gjedhë në vitin 2000 në ≈ 2.9 milion në vitin 2016) (AASF, 2018), megjithëse rënia e tyre ka qenë më e ulët se ajo e bagëtime.

Pavarësisht se ka shumë më krerë të mbarështuara, Shqipëria arriti të rrisë prodhimin total të qumështit për shumë vite përmes rritjes së produktivitetit për krerë.

Rendimenteti dhe produktiviteti

Rritja e rendimentit të qumështit

Një nga përmirësimet e dukshme të performancës në zinxhirin e qumështit në Shqipëri ka qenë rritja e rendimentit të qumështit për lopë. Përmes përmirësimit gjenetik, ushqyerjes dhe menaxhimit të mirë të kafshëve, rendimenti mesatar është përmirësuar ndjeshëm në ndryshim nga periudha e tranzicionit.

Në vitin 1990, një lopë në Shqipëri prodhonte vetëm rreth 1,398 litra/vit (ANRD, 2024). Deri në vitin 2023, kjo sasi u rrit në $\approx 3,157$ litra për lopë - një rritje prej $\approx 125\%$ në rendiment (ANRD, 2024). AASF (2018) raportoi se rendimentet u rritën nga $\approx 1,100$ – $1,200$ litra/vit në fillim të viteve 2000 në $\approx 1,900$ – $2,800$ litra/vit deri në vitin 2016, varësisht nga rajoni dhe sistemi bujqësor. Edhe pse rendimenti për krerë në Shqipëri mbetet shumë prapa niveleve të Evropës Perëndimore (p.sh., lopët e BE shpesh prodhojnë 6,000–8,000+ litra/vit), tendenca e qëndrueshme në rritje është një tregues pozitiv i performancës (AASF, 2018). Kjo pasqyron fitimet shtesë të efikasitetit nga fermerët që mbarështojnë raca të përmirësuara (përmes kryqëzimit ose importimit të lopëve me rendiment të lartë), përdorin praktika të mira të ushqyerjes (sanën, silazhin, përdorimin e disa koncentreve) dhe sigurojnë kujdesin veterinar për kafshët.

Rendimentet më të larta raportohen në fermat moderne, disa prej të cilave tejkalojnë 6,000–7,000 litra për lopë në vit duke përdorur racën Holstein-Friesian dhe raca të përziera (ANRD, 2024). Në të kundërt, fermat më të vogla që mbarështojnë raca lokale mund të marrin ende vetëm $\approx 1,000$ – $1,500$ litra për lopë. Rendimentet e qumështit të deleve dhe dhive kanë pasur gjithashtu përmirësime modeste. Delet dhe dhitë kanë prodhuan sasi shumë të ulëta (shpesh < 50 litra/vit dekada më parë); tani edhe fermerët e vegjël mund të marrin rreth 70–80 litra për dele dhe $\approx 120+$ litra për dhi për laktacion (ANRD, 2024). Këto nivele mbeten modeste, çka tregon për një pasqyrim të sezoneve të shkurtra të laktacionit dhe sistemeve të gjera të kullotjes, por po rriten ngadalë pasi disa fermerë përdorin raca dhe praktika më të mira (ANRD, 2024; AASF, 2018).

Faktorët që nxisin produktivitetin

Rritjet graduale të rendimentit janë mbështetur nga disa faktorë siç është mbarështimi dhe gjenetika që përfshin inseminimi artificial tek bagëtia, duke futur raca më produktive (AASF, 2018). Disa ferma kanë importuar bagëti të racës së pastër, për shembull, një fermë e mbështetur nga IPARD është specializuar në dhi alpine që japin rendimente më të larta qumështi (MARD, 2021). Po ashtu, përdorimi i silosit, jonxhës së kultivuar dhe ushqimit të ekuilibruar në ferma më të mëdha është rritur, duke rritur prodhimin për kafshë.

Sipas IPARD II (2014–2020), të paktën pesë ferma të mëdha blegtorale morën bashkëfinancim të konsiderueshëm (≈ 0.5 milion € secila) për të ndërtuar stalla të reja, për të blerë makineri dhe për të blerë krerë me rendiment të lartë (MARD, 2021). Këto ferma kanë arritur rendimente dhe cilësi qumështi në të njëjtin nivel me standardet e BE (MARD, 2021).

Megjithatë, shembuj të tillë mbeten të rrallë dhe shumica e $\approx 300,000$ lopëve në Shqipëri mbarështohen ende në ferma me burime të kufizuara, kushte të papërshtatshme, kështu që prodhimi aktual nuk e

plotëson potencialin e tyre. Megjithatë, përmirësimet mesatare të rendimentit sinjalizojnë përhapje të ngadaltë të praktikave të mira blegtorale.

Po ashtu, duket qartë se rritja e produktivitetit nuk mund të plotësojë nevojat për qumësht nëse numri i krerëve të mbarështuara vazhdon të tkurret. Sikurse u përmend më sipër, rritjet e rendimentit në Shqipëri fillimisht kompensuan nga rënia e krerëve të mbarështuara (prandaj prodhimi u rrit gjatë vitit 2016), por më pas ra, duke nënkuptuar kufizime në rritjen aktuale të produktivitetit pa ndryshime më të gjera strukturore.

Sezonaliteti dhe përpunimi

Produktiviteti në sektorin e qumështit në Shqipëri është gjithashtu shumë sezonal, veçanërisht për gjedhët. Delet dhe dhitë prodhojnë qumësht vetëm për disa muaj pas lindjes (zakonisht nga pranvera deri në fillim të verës) (AASF, 2018). Qumështi i lopës është më i qëndrueshëm, megjithatë arrin kulmin në pranverë dhe bie në dimër në shumicën e fermave për shkak të varësisë nga kullotat.

Ky sezonalitet ndikon në shfrytëzimin e qumështit për përpunim. Shumë njësi të vogla përpunuese operojnë vetëm sezonalisht (gjatë periudhave të prodhimit të qumështit të deleve/dhive). Përveç kësaj, njësitë e mëdha të përpunimit përpiquen të balancojnë situatën përmes përpunimit të qumështit e lopës gjatë gjithë vitit dhe të gjedhëve në disa periudha të caktuara të vitit (AASF, 2018). Përmirësimi i produktivitetit jashtë sezonit (p.sh. përmes ruajtjes së ushqimit për kafshët) mbetet një sfidë e vazhdueshme për fermerët.

Konsumi vendas dhe performanca tregtare

Konsumi i lartë i brendshëm

Shqiptarët janë konsumatorë të mëdhenj të produkteve të qumështit dhe konsumi për vlerësohet si një ndër më të lartët në Evropë dhe shumë mbi mesataren e BE (ANRD, 2024; MARD, 2021). Kjo përfshin qumështin, djathin, kosin dhe produkte të tjera të qumështit. Djathi ka një rëndësi të veçantë kulturore, ndërsa konsumi i lartë për frymë i qumështit (duke përfshirë gjalpin) nënvizon rolin e tij të rëndësishme në dietën shqiptare. Siç ilustron në figurën 1, Shqipëria regjistron vazhdimisht nivele më të larta të konsumit të qumështit krahasuar me mesataren e BE dhe atë globale gjatë gjithë periudhës 2010-2022. Në vitin 2022, konsumi vjetor i qumështit në Shqipëri arriti afërsisht 298 kg për person, duke tejkaluar ndjeshëm mesataren e BE prej 218 kg dhe mesataren globale prej vetëm 83 kg. Këto shifra nxjerrin në pah qumështin si një element kryesor në dietën ushqimore në Shqipëri (FAO, 2025).

Konsumatorët tregojnë një preferencë të fortë për produktet e freskëta vendase të qumështit. Të dhënat tregojnë se shumë familje preferojnë të blejnë qumësht të papërpunuar direkt nga fermerët ose tregjet informale, duke besuar se është më natyral dhe i freskët (ANRD, 2024). Në mënyrë të ngjashme, djathërat artizanale nga rajone të caktuara (p.sh., Gjirokastrë, Korçë) vlerësohen më shumë sesa produktet që mund të blihen në supermarket.

Këto preferenca nxisin rritjen e tregut informal krahas sektorit formal të shitjes me pakicë. Supermarketet në zonat urbane ofrojnë produkte si qumësht UHT dhe të pasterizuar, djathëra të prodhuar në Shqipëri dhe disa marka të importuara, por shumë konsumatorë vazhdojnë të furnizohen me produkte qumështi përmes kanaleve informale ose familjare.

Mbi 99% e qumështit të lëngshëm të konsumuar në Shqipëri furnizohet brenda vendit, me importe minimale të qumështit UHT (AASF, 2018). Konsumatorët në zonat rurale dhe periurbane u besojnë veçanërisht produkteve lokale, duke i ndihmuar prodhuesit vendas të ruajnë pjesën e tyre të tregut.

Performanca tregtare

Shqipëria vazhdimisht ka përjetuar deficit tregtar të produkteve të qumështit, megjithëse importet mbeten të moderuara krahasuar me prodhimin vendas. Importet zakonisht përfshijnë produkte që prodhimi vendas nuk mund t'i arrijë në cilësi ose vëllim, siç janë: qumështi pluhur, qumështi UHT me afat të gjatë, gjalpi apo djathërat e veçantë. Sipas të dhënave të FAOSTAT të paraqitura në shtojcën 9.4. Konsumi dhe tregtia, importet e produkteve të qumështit variuan nga 49 në 98 mijë ton midis viteve 2010

dhe 2021, përpara se të rriteshin ndjeshëm në 110 mijë ton në vitin 2022, niveli më i lartë i regjistruar në këtë periudhë. Në të kundërt, eksportet e produkteve të qumështit mbetën të papërfillshme, me pak luhatje midis 6 dhe 8 mijë ton në vit gjatë gjithë periudhës 2010-2022. Kjo ka rezultuar në një bilanc tregtar negativ të vazhdueshëm, duke filluar nga 84 mijë ton në vitin 2010 deri në një deficit maksimal prej 102 mijë ton në vitin 2022. Të dhënat nxjerrin në pah sfidat strukturore me të cilat përballlet sektori i qumështit në Shqipëri, i cili nuk është në gjendje të përmbushë kërkesën vendase në rritje përmes prodhimit të brendshëm, duke çuar në varësi të konsiderueshme nga importi. Forcimi i zinxhirëve të vlerës së qumështit dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë janë thelbësore për të zvogëluar këtë varësi të jashtme.

Ndërsa vëllimet absolute të importit janë të vogla (p.sh., ≈15,000 ton qumësht të freskët dhe ≈1,500 ton qumësht pluhur në vitin 2020), ato plotësojnë boshllëqet sezonale ose të lidhura me cilësinë (MARD, 2021). Përpunuesit e mëdhenj përdorin gjithnjë e më shumë inpute gjysmë të përpunuara të importuara, të tilla si qumështi me shumicë nga Serbia dhe qumështi pluhur me origjinë nga BE, veçanërisht në dimër ose kur sasia e qumështit vendas nuk është e mjaftueshme (MARD, 2021).

Eksportet mbeten të papërfillshme, të kufizuara në vëllime të vogla në tregjet e diasporës (p.sh., Kosova, komuniteti shqiptar në SHBA). Për shembull, vetëm 34 ton djathë u eksportuan në vitin 2016 (AASF, 2018). Kostot e larta të prodhimit, cilësia e ulët dhe pamundësia për të përmbushur standardet ndërkombëtare e kufizojnë konkurrueshmërinë në tregjet e huaja.

Në këtë kontekst, ndërsa sektori i qumështit në Shqipëri është kryesisht i vetëmjaftueshëm përsa i përket produktit të qumështit, hendeku i nënprodukteve të qumështit pasqyron një mungesë konkurrueshmërie me produktet e importit. Reduktimi i këtij hendeku kërkon rritje të efikasitetit dhe përmirësime në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare për të ulur importet ose për të rritur eksportet.

Përfundime: Sektori i qumështit në Shqipëri mbetet ekonomikisht i dobët, i karakterizuar nga nivele të ulëta dhe të pabarabarta fitimi, strukturë të copëzuar të fermave dhe formalizim të kufizuar. Ndërsa disa ferma dhe përpunues të mëdhenj janë modernizuar dhe kanë rritur efikasitetin, shumica dërrmuese e fermerëve të vegjël vazhdojnë të operojnë nën kufizime të shumta financiare, duke mos pasur qasje në financa, investime dhe tregje të qëndrueshme. Sektori po bëhet gjithnjë e më i polarizuar, me ekonomi shkalle që favorizojnë fermat e mëdha dhe marginalizojnë prodhuesit më të vegjël. Informaliteti, riinvestimi i kufizuar dhe koordinimi i dobët i zinxhirit të vlerës pengojnë më tej konkurrueshmërinë. Pavarësisht rritjes së produktivitetit dhe kërkesës së lartë vendase, tkurrja e numrit të bagëtive dhe rritja e kostove të prodhimit kërcënojnë qëndrueshmërinë. Pa reforma të politikave mbështetëse, Shqipëria rrezikon të humbasë burimet e jetesës së fermerëve të vegjël dhe të thellojë varësinë e saj nga importet e qumështit për të përmbushur nevojat në të ardhmen.

5.2.2. PERFORMANCA SOCIALE

a) Shpërndarja e vlerës së shtuar

Fragmentimi dhe ndarja e pabarabartë e fitimeve

Struktura e zinxhirit të vlerës së qumështit në Shqipëri, me shumë prodhues të vegjël dhe pak blerës, çon në një shpërndarje jo të drejtë të vlerës së shtuar midis tyre. Fermerët e vegjël kanë pak fuqi negociuese dhe zakonisht pranojnë çmime të përcaktuara nga grumbulluesit ose përpunuesit. Sipas raportit të ANRD (2024), mbi gjysma e fermerëve që zotërojnë vetëm 1-3 lopë, nuk negociojnë me tregtarët mbi çmimin e shitjes. Shumica e qumështit shitet nëpërmjet ndërmjetësve, shpesh me kushte të përcaktuara nga blerësi. Kjo krijon një ndjenjë marginalizimi dhe mosbesimi ndaj përpunuesve.

Vonesat në pagesa janë një problem i shpeshtë. Diskutimet në grupe të fokusuara (ANRD 2024) tregojnë se disa përpunues, veçanërisht subjektet e vogla që përballen me vështirësi financiare, vonojnë pagesat

për javë ose muaj, duke rritur paqëndrueshmërinë financiare të fermerëve. Përveç kësaj, shumica e transaksioneve janë të pashkruara, duke patur mungesë transparence në çmime ose vlerësim të cilësisë së qumështit.

Roli i grupeve të fermerëve

Grupet e fermerëve kanë dëshmuar për rezultate pozitive në përmirësimin e pozitës së fermerëve në zinxhirët e vlerës. Ndonëse të paktë në numër, janë disa grupe fermerësh si Myzeqeja Farm (Lushnjë).

Aty ku ekzistojnë, këto grupe ofrojnë përfitime të prekshme sociale dhe ekonomike. Për shembull, anëtarët e Myzeqeja Farm ndajnë pajisje (p.sh., traktor, magazinim qumështi), fitojnë rreth +32,000 lekë për lopë në vit më shumë se joanëtarët, për shkak të çmimeve më të mira dhe kostove më të ulëta të inputeve (intervistë në terren, 2018), kanë një kontratë furnizimi 15 vjeçare me një përpunues të madh, duke siguruar pagesa tri herë në muaj, takohen çdo tre muaj për zgjidhjen e problemeve dhe për transparencë. Në fakt, ata po përballen me vështirësi për shkak të TVSH së diferencuar: 20% kur shesin qumësht tek konsumatorët dhe vetëm 6% kur blejnë qumësht tek fermerët.

Megjithatë, mungesa e besimit mbeten sfida të trashëguara nga sistemi komunist (ANRD, 2024). Shumë prodhues preferojnë marrëdhënie fleksibile, të tregut të shpejtë, në vend të angazhimeve të detyrueshme në grup. Për të forcuar organizatat e fermerëve, këto barrierat sociale duhet të adresohen për të siguruar qeverisje të mirë brenda grupeve të fermerëve dhe shoqatave.

Shpërndarja e vlerës së shtuar

Në një nivel më të gjerë, shpërndarja e vlerës së shtuar në zinxhirin e qumështit është e pabarabartë. Fermerët marrin një pjesë relativisht të vogël të çmimit përfundimtar, ndërsa përpunuesit dhe shitësit me pakicë marrin pjesën më të madhe. Në një aspekt më pozitiv, disa përpunues kanë filluar të zbatojnë skema pagesash të bazuara në cilësi, duke paguar për përmbajtje më të lartë yndyre/proteine dhe numër më të ulët bakteresh (ANRD, 2024). Kjo mund të rrisë të ardhurat për fermerët që investojnë në cilësi, por gjithashtu mund të rrisë pabarazinë, pasi ata që nuk janë në gjendje të përmbushin standardet rrezikojnë të penalizohen ose të përjashtohen nga tregjet formale.

b) Traditat kulturore

Traditat kulturore dhe preferencat e konsumatorëve

Trashëgimia kulturore

Blegtoria, dhe blegtoria e bagëtive të imëta në veçanti, është thellësisht e ngulitur në trashëgiminë kulturore të Shqipërisë. Në zonat malore, praktika e lashtë e zhvendosjes së bagëtive të imëta (lëvizja sezonale e deleve dhe dhive në kullotat verore) është ruajtur për shekuj me radhë dhe mbetet një shtyllë e identitetit të ketyre komuniteteve (AASF, 2018). Ky sistem jo vetëm që prodhon djathëra unikë malorë, por gjithashtu ndihmon në ruajtjen e peizazheve kulturore dhe biodiversitetit. Disa produkte rajonale të qumështit janë bërë simbole të krenarisë dhe kuzhinës lokale, siç është djathi i dhisë i Gjirokastrës dhe djathi i deleve dimërore të Korçës (AASF, 2018). Këto produkte gëzojnë një markë të fortë lokale, shpesh të paraqitura në festivale dhe panaire që festojnë produktet tradicionale të qumështit. Vazhdimësia e këtyre traditave është një tregues pozitiv shoqëror, që mbështet diversitetin kulturor, kohezionin e komunitetit dhe identitetin rural.

Besimi i konsumatorit në traditë

Konsumatorët shqiptarë kanë një preferencë të fortë për produktet tradicionale të qumështit të prodhuara në vend, dhe ekziston një skepticizëm i përgjithshëm ndaj produkteve industriale ose të importuara. Për shembull, përdorimi i qumështit pluhur në prodhimin e djathit nuk shihet me sy të mirë (AASF, 2018), dhe konsumatorët vlerësojnë autenticitetin e djathit "të vërtetë" me bazë qumështi. Ky besim i konsumatorit ka efekte sociale pozitive sepse mbështet prodhuesit e vegjël, jetesën në zonat rurale dhe njohuritë tradicionale.

Megjithatë, kjo preferencë ndonjëherë mund të bjerë ndesh me modernizimin, veçanërisht kur flitet për

sigurinë ushqimore. Konsumatorët që zgjedhin produkte jo të pasterizuara për hir të traditës mund të pranojnë pa vetëdije rreziqe më të larta për shëndetin.

Ndryshimet dhe ruajtja e traditës

Procesi i urbanizimit dhe ekspozimi më i madh ndaj mallrave të importuara, po ndryshojnë ngadalë zakonet e të ushqyerit. Konsumatorët e rinj që jetojnë në zonat urbane po provojnë gjithnjë e më shumë djathëra të importuar, kos të aromatizuar dhe produkte qumështi të markës. Por përsëri preferencat tradicionale mbeten dominuese.

Meqenëse produktet e qumështit kanë një domethënie të thellë kulturore, përpjekjet për zhvillim duhet të bazohen tek tradita dhe jo ta zëvendësojnë atë. Shembuj mund të jenë promovimi i Treguesve Gjeografikë (GI) për djathërat e mirënjohur, mbështetja e ekoturizmit dhe marka artizanale.

Qëndrueshmëria kulturore e sektorit të qumështit në Shqipëri është relativisht e lartë dhe praktikat tradicionale i kanë mbijetuar dekadave të tranzicionit. Megjithatë, IPARD vëren një rënie të zhvendosjes së bagëtive për shkak të shpopullimit të zonave rurale (MARD, 2021). Ky erozion kërcënon produkte unike të qumështit, identitetin kulturor dhe sistemet tradicionale ekologjike.

c) Shëndeti dhe ushqyerja

Qumështi i tregëtuar në mënyrë informale dhe rreziqet që vijnë nga ai

Një nga shqetësimet më kryesore të shoqërisë në lidhje me sektorin e qumështit në Shqipëri është siguria ushqimore. Për shkak se një pjesë e madhe e qumështit trajtohet në mënyrë informale, kontrollet e cilësisë dhe sigurisë shpesh anashkalohen. Matjet tregojnë se rreth gjysma e të gjithë qumështit të papërpunuar shitet direkt nga fermat ose nëpërmjet shitësve në rrugë, pa kaluar në pasterizim ose kontroll zyrtar të cilësisë (ANRD, 2024; AASF, 2018).

Praktikat e zakonshme si shitja e qumështit të ngrohtë dhe të papërpunuar në shishe të ripërdorura i ekspozojnë konsumatorët ndaj infeksioneve që vijnë nga kontaminimi bakterial (p.sh., Bruceloza (*brucella*), *Eschericia coli*) dhe mbetjet e antibiotikëve. Shumë fermerë të vegjël nuk i bëjnë qumështit të tyre analiza në lidhje me parametrat e sigurisë. Testimi i vazhdueshëm për antibiotikë, sasinë bakteriale ose qelizat somatike është dicka e rrallë në fermat e vogla (ANRD, 2024). Kushtet higjienike në nivel ferme nuk zbatohen gjithmonë, praktikat e mjeljes dhe kujdesi për gjinjtë është shpesh nën standardet e rekomanduara.

Në mënyrë të ngjashme, prodhuesit e vegjël artizanalë të produkteve të qumështit jo gjithmonë e pasterizojnë qumështin apo stazhionojnë siç duhet djathërat. Djathërat tradicionale të shitur të freskët mund të mbajnë patogjenë nëse janë prodhuar nga qumështi i kontaminuar. Megjithëse këto rreziqe janë të mirënjohura, të dhënat e shëndetit publik mbi sëmundje që lidhen me konsumin e qumështit janë të kufizuara.

Shqipëria ka një ligj "Për Sigurinë Ushqimore" në përputhje me standardet e BE, dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (NFA) është ngarkuar të kryejë inspektime në lidhje me këtë çështje. Megjithatë, zbatimi i këtij ligji është i pjesshëm, veçanërisht në zonat rurale ku mijëra prodhues të vegjël kryejnë aktivitetin e tyre me pak kontrolle. Rregulloret kërkojnë rezervuarë ftohjeje dhe kontrolle veterinare, por shumë ferma nuk kanë ambiente të tilla dhe nuk i njohin standardet e higjienës (ANRD, 2024; AASF, 2018).

Sot, përpunuesit më të mëdhenj të qumështit në përgjithësi i permbushin kërkesat e BE për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit (MARD, 2021) dhe kanë laboratorë të kontrollit të brendshëm të cilësisë. Ata refuzojnë të grumbullojnë qumësht që nuk përmbush standardet dhe ofrojnë çmime në bazë të cilësisë së tij, duke favorizuar qumështin me numër të ulët bakteresh.

Si rezultat, qumështi dhe produktet e qumështit që kalojnë nëpër keto kanale formale janë më të sigurt se sa ishin një dekadë më parë. Vlerësimet e IPARD konfirmojnë se "qumështi dhe produktet e qumështit janë më të sigurt se sa ishin në fillim të periudhës së mëparshme të programit" (MARD, 2021). Megjithatë, me gjysmën e qumështit ende në kanale informale, ekzistojnë akoma shumë rreziqe.

Rezultatet tek shëndeti publik

Tradicionalisht, shumë konsumatorë shqiptarë e ziejnë qumështin e papërpunuar në shtëpi, gjë që zvogëlon, por nuk e eliminon rrezikun. Herepashere kanë lindur shqetësime të shëndetit publik që vijnë lidhja që ekziston ndërmjet brucelozës dhe sëmundjeve të tjera që vijnë nga kafshët, me konsumin e qumështit. Qeveria ka investuar në kontrollin e shëndetit të kafshëve, si nëpërmjet programit të vaksinimit, kontrollit të brucelozës dhe përmirësimit të sistemit të identifikimit dhe gjurmueshmërisë së kafshëve (MARD, 2021). Këto përpjekje kanë treguar njëfarë suksesi në uljen e sëmundjeve, por përfitimet e plota prej tyre varen nga formalizimi i mëtejshëm i zinxhirit të furnizimit.

d) Të drejtat dhe siguria e punëtorëve

Punësimi dhe burimet e jetesës

Rëndësia e punësimit rural

Zinxhiri i vlerës së produkteve të qumështit është një gur themeli i jetesës rurale në Shqipëri. Rritja e gjedhit, deleve dhe dhive siguron punë dhe të ardhura për mbi 40% të popullsisë rurale (ANRD, 2024). Kjo përfshin fermerët me kohë të plotë, me kohë të pjesshme ose ata fermerë që prodhojnë për nevojat e fermës, shumë prej të cilëve rrisin vetëm pak kafshë. Rëndësia sociale e sektorit është e jashtëzakonshme duke patur parasysh që ai siguron ushqim për familjen fermere (familjet konsumojnë qumështin e tyre) dhe siguron të ardhura nga shitja e qumështit.

Në zonat malore dhe kodrinore, ku mundësitë për zhvillimin e bujqësisë janë të kufizuara, prodhimi i qumështit nga qumështi i gjedhëve të imëta dhe zhvendosja e tyre mbeten aktivitete të jetës së përditshme. Pavarësisht përmasave të vogla të kopesë, popullata e bagëtive në tërësi përbën një punëdhënëse të madh në zonat rurale, megjithëse puna është kryesisht punë familjare informale. Pak ferma punësojnë punëtorë të përhershëm; në vend të kësaj, burrat, gratë dhe ndonjëherë fëmijët ose pleqtë kryejnë pjesën më të madhe të punëve (ANRD, 2024).

Përsa i përket përpunimit, ai krijon disa vende pune formale, por këto janë të përqendruara në ferma të mëdha. Për shembull, një nga fermat më të mëdha të qumështit në Shqipëri (e cila zotëron 350 lopë për qumësht) raportoi se punësonte 37 punëtorë me kohë të plotë dhe 15 punëtorë sezonalë, një rast i rrallë i krijimit të vendeve të punës në nivel ferme që operon për nevojat e saj (intervistë në terren, 2018). AGS SHPK, Durrës, Sukth, punësoi 65 punëtorë me kohë të plotë (intervista 2024). Kjo kompani përpunon një vëllim prej rreth 270 000 litra qumësht në muaj. Shumica e fermave nuk janë ende në këtë nivel. Ndërkohë, dhjetëra baxho/punishte të vogla qumështi punësojnë vetëm një grusht njerëzish, shpesh anëtarë të familjes dhe disa punonjës.

Mungesa e krahut të punës dhe kushtet e punës

Një shqetësim në rritje është mungesa e fuqisë punëtore në bujqësi, veçanërisht tek brezi i ri. Shumë të rinj largohen nga bujqësia në kërkim të mundësive më të mira pune. Fermerët raportojnë vështirësi në rritje për të gjetur barinj. "Ne duhet të caktojmë takim me punëtorët," tha një fermer për një rast ku vetëm 3-4 persona ishin të disponueshëm në të gjithë zonën, dhe disa ferma konkurronin për ta (intervistë në terren, 2024, ANRD).

Mungesa e fuqisë punëtore ka rritur pagat ditore nga rreth 1200 lekë në 2000 lekë në ditë, gjatë një harku të shkurtër kohe (intervistë në terren, 2024). Për fermat e vogla, pagesa e pagave të tilla është shpesh e papërbalueshme, duke i detyruar anëtarët e moshuar të familjes të kryejnë disa punë ose duke mos i kryer ato fare. Si rezultat, disa fermerë largohen krejtësisht nga blegtoria për shkak të mungesës së ndihmës. Nga ana tjetër, fermat më të mëdha krijojnë vende pune më tërheqëse (p.sh. vende për punonjës në fabrikë qumështi ose shofer), por këto mundësi janë të përqendruara pranë qendrave periurbane dhe janë të kufizuara në numër. Sektori i qumështit në Shqipëri dominohet nga puna familjare, duke e bërë formalizimin e punës pothuajse të pamundur. Në fermat e vogla, burra dhe gra punojnë me orë të gjata duke kryer detyra që kërkojnë shumë punë fizike. Mjelja me dorë është ende e përhapur, transporti i qumështit dhe ushqimit për kafshët kryhet me dorë dhe pastrimi dhe kujdesi për kafshët bëhen pa përdorur makineri. Për më tepër, anëtarët e familjes nuk kanë mbrojtje sociale dhe nuk kualifikohen për

sigurim shëndetësor ose sigurime shoqërore përmes punës së tyre në fermë. Nuk ka orare zyrtare pune ose periudha pushimi; lopët duhet të milen çdo ditë, pavarësisht rrethanave. Sipas AASF (2018) dhe ANRD (2024), niveli i ulet i mekanizimit detyron punëtorët të kryejnë me dore detyra që mund të mekanizohen, si p.sh. transporti i ushqimit për kafshët ose heqja e plehut organik. Kjo kontribuon në shtimin e punës së rëndë.

Çështje gjinore dhe përfshirja e të rinjve

Gratë janë thelbësore, por kontributi i tyre është i pavlerësuar në zinxhirin e vlerës së produkteve të qumështit në Shqipëri. Në fermat e vogla, gratë merren me mjeljen, kujdesin për viçat dhe prodhimin e djathit dhe gjalpit (ANRD, 2024). Pavarësisht kontributeve të tyre, pronësia e tokës dhe e bagëtive zakonisht regjistrohen në emër të anëtarëve meshkuj të familjes. Gratë kanë qasje të kufizuara në kredimarrje, pasi shpesh u mungon kolaterali. Në grupet e fokusit, vetëm rreth 20% e pjesëmarrësve ishin gra (ANRD, 2024). Pak gra mbajnë role udhëheqëse në kooperativa. Pjesa më e madhe e bordeve të kooperativave dominohen nga meshkujt, me udhëheqës meshkuj që kanë kohë të gjatë në këto detyra (intervistë në terren, 2018). Kjo situatë nxjerr në pah një hendek gjinor në përfaqësimin formal. Disa programe zhvillimi (p.sh., Heifer International) kanë mbështetur gratë në industrinë e produkteve të qumështit duke siguruar bagëti dhe trajnime. Këto ndërhyrje kanë fuqizuar disa grupe të vogla grash, por në një shkallë të kufizuar.

Pjesëmarrja e të rinjve në prodhimin e produkteve të qumështit përbën shqetësim në rritje. Moshë mesatare e fermerëve është e lartë dhe të rinjtë e shohin prodhimin e qumështit si një aktivitet që kërkon shumë punë, me të ardhura të ulëta dhe prestigj të ulët. Në grupet e fokusit të ANRD, vetëm rreth 21% e pjesëmarrësve ishin nën moshën 40 vjeç (ANRD, 2024). Ata që janë pjesë e këtij sektori kanë tendencë të jenë të hapur ndaj teknologjisë dhe të provojnë raca të përmirësuara ose mjete të reja. Megjithatë, shumë të rinj shprehin synimin për t'u larguar nga jeta në zonat rurale, duke kërcënuar në këtë mënyrë vazhdimësinë e fermave. Pak sipërmarrës të rinj po hyjnë në fushën e prodhimin të qumështit, megjithatë përjashtim të dukshëm përbëjnë disa ferma intensive të dhive në zonat fushore (MARD, 2021). Disa programe ofrojnë trajnime për agrobiznes ose grante për startup-e, por niveli i përgjithshëm i përfshirjes së të rinjve mbetet modest.

e) Mirëqenia e kafshëve

Në pjesën më të madhe të fermave të vogla, bagëtitë që prodhojnë qumësht për bylmet mbahen në kasolle të vogla ose thjesht brenda gardhit për periudha të gjata kohe (AASF, 2018). Strehimi është minimal dhe përfshin stalla të thjeshta, pa dysheme dhe me ventilim të dobët. Lëvizja është e kufizuar, gjë që zvogëlon rehatinë e kafshëve. Delet dhe dhitë zakonisht kullosin gjatë ditës dhe gjatë natës qëndrojnë të mbyllura, nganjëherë në vende të ngushta. Në kontrast me keto, fermat e mëdha tregtare kanë investuar në stalla moderne me ventilim më të mirë, hapësira të mëdha për qëndrim, dhe zona të ndara për qëndrim dhe ushqim. Ambjente të tilla ofrojnë kushte dukshëm më të mira, por mbeten të rralla.

Fermerët e vegjël e kullosin bagëtinë e tyre dhe i japin ushqim të përgatitur në fermë, i cili nuk është optimal, por është i mjaftueshëm. Mungesat e ujit në kullotat verore mund të dëmtojnë mirëqenien. Kujdesi veterinar është i rastit, shumë fermerë i trajtojnë vetë kafshët ose e neglizhojnë praninë e veterinerit deri në momentin që përballen me me ndonjë urgjencë. Fermat tradicionale përdorin çiftëzimin natyror dhe rrallë i çojnë kafshët për therje, përfshirë ato që nuk janë produktive, për shkak të lidhjeve kulturore ose tregjeve të kufizuara. Kjo çon në tufa që janë më pak produktive dhe plaken shpejt. Fermat më të mëdha përdorin inseminimin artificial, i cili përmirëson bazën gjenetike, rrit prodhimtarinë dhe kërkon menazhim të kujdesshëm për të shmangur kryqëzimin brenda familjes ose lindjet e vështira (AASF, 2018).

f) Institucionet

Mbështetje institucionale dhe zbatim i politikave

Shërbimi i ekstensionit dhe trajnimet

Në Shqipëri, shërbimet shtetërore të bujqësisë ekstensive ekzistojnë, por janë të kufizuara dhe me burime të pamjaftueshme (ANRD, 2024). Shumë fermerë, veçanërisht ato në zonat e largëta, nuk marrin ndihmë të rregullt ose trajnim teknik. Sipas ANRD (2024), një numër i madh prodhuesish nuk i njohin

praktikat moderne të higjienës ose mjeljes. Atje ku janë angazhuar OJQ ose projektet e jashtme (p.sh., Heifer International, World Vision), me aktivitete siç janë trajnimi i fermerëve në mbarështimin e kafshëve, plani i biznesit, mbështetje për kooperativat dhe dialogu i përmirësuar me qeverinë, rezultatet kanë qenë pozitive (intervistë në terren, 2018; ANRD, 2024). OJQ dhe shoqatat e fermerëve po luajnë një rol gjithnjë e më të madh në mbushjen e boshllëqeve të njohurive, megjithatë mbulimi është ende i pjesshëm.

Institucionet rregullatore

Institucionet kryesore publike përfshijnë Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), AZHBR (për shpërndarjen e subvencioneve), Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (për inspektime mbi higjienën dhe sigurinë ushqimore). Shqipëria ka përafruar shumë rregullore me direktivat e BE, por zbatimi i tyre nuk është i vazhdueshëm, veçanërisht në tregjet informale. Produkte të qumështit të cilat janë të paetiketuara dhe të patestuara shiten normalisht, duke vënë në dukje një mungesë të mbikëqyrjes rregullatore. Vetë procesi i konsultimit i ANRD përfaqëson një model pozitiv të qeverisjes gjithëpërfshirëse, duke u siguruar fermerëve dhe aktorëve të zinxhirit të vlerës një platformë.

Përfundime: Sektori i qumështit në Shqipëri përballet me sfida të konsiderueshme të performancës sociale, kryesisht për shkak të prodhimit të copëzuar, fuqisë së pakët negociuese të fermerëve, mungesës së fuqisë punëtore dhe mbështetjes së kufizuar institucionale. Ndërsa traditat kulturore dhe besimi i konsumatorit në produktet lokale ofrojnë një bazë të fortë shoqërore, dominojnë tregjet informale, duke dëmtuar sigurinë ushqimore dhe shpërndarjen e drejtë të vlerës. Gratë dhe të rinjtë nuk janë të përfaqësuar aq sa duhet dhe punës familjare i mungon mbrojtja sociale. Mirëqenia e kafshëve dhe qasja në kujdesin veterinar mbeten të dobët midis fermerëve të vegjël. Megjithatë, kooperativat dhe programet specifike të OJQ kanë potencial për përmirësim. Rritja e shkallës së formalizimit, forcimi i kooperativave, investimi në shërbimet e ekstensionit dhe mbështetja e politikave gjithëpërfshirëse, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë, janë thelbësore për të krijuar një zinxhir vlerash më të drejtë, më të sigurt dhe më rezistent të produkteve të qumështit në Shqipëri.

5.2.3. DIMENSIONI MJEDISOR

Industria e qumështit në Shqipëri mbetet shumë e copëzuar, e dominuar nga ferma shumë të vogla që kane mesatarisht me pak se dy lopë ose 30-40 bagëti të imëta secila. Rendimentet e ulëta të prodhimit për lopë, afërsisht 3,000 litra në vit, janë më pak se gjysma e mesatares së BEë, që do të thotë se nevojiten më shumë bagëti për të përmbushur kërkesën, duke rritur presionet mjedisore në të gjithë sektorin.

a. Emetimet e gazrave serrë dhe intensiteti i burimeve

Fermentimi enterik dhe plehu organik i patrajtuar siç duhet janë burimet kryesore të gazrave serrë (metani dhe oksidi i azotit) në prodhimin e qumështit në Shqipëri. Meqenëse regjimet e ushqyerjes në fermë shpesh janë të pabalancuara, me përmbajtje të lartë të lëndëve të forta dhe kashtës, rendimentet e qumështit janë shumë nën potencialin gjenetik. Kjo mungesë efektiviteti jo vetëm që ul produktivitetin, por edhe rrit emetimet e gazrave serre për litër qumësht të prodhuar. Për më tepër, përdorimi i energjisë është i pabarabartë, fermat e vogla bazohen në mjeljen me dorë dhe shumë pak makineri, ndërsa fermat e mëdha investojnë në pompa elektrike, rezervuarë ftohës, dhe gjithnjë e më shumë, ambiente mjelje, dhe shumë pak në energji të rinovueshme (p.sh. panele diellore ose tretës të biogazeve).

b. Menaxhimi i plehut dhe ujërave të ndotura

Pothuajse të gjitha fermat e vogla dhe të mesme nuk kanë asnjë vend të ndërtuar posaçërisht për plehun ose mbeturinat e tjera, në vend të kësaj ato i shpërndajnë ujërat e papërpunuar direkt në fushat aty pranë ose në kanale. Kjo çon në emetime të larta të amoniakut, rrjedhje të lëndëve ushqyese në kanale ujore dhe erëra të këqija në ajër. Edhe fabrikat e vogla të qumështit rrallë i trajtojnë ujërat e ndotura, duke ndikuar kështu në mënyrë negative. Trajtimi i plehut në Shqipëri përballet me disa sfida për shkak të praktikave të vjetëruara të punës, infrastrukturës së kufizuar dhe edukimit të pamjaftueshëm të fermerëve. Këto

çështje kontribuojnë në probleme mjedisore siç janë ndotja e tokës dhe ujit, emetimet e gazrave serrë si dhe pengojnë përafrimin e vendit me standardet e BE në bujqësi.

Sektori i blegtorisë në Shqipëri, përfshirë gjedhët, delet, derrat dhe shpendët, menaxhohet kryesisht nga fermat e vogla. Këto ferma shpesh nuk kanë ambjentet e duhura për magazinimin e plehut, duke çuar në shkarkimin e tyre drejtpërdrejt në mjedis. Kjo praktikë rezulton në nitrifikimin e tokës dhe ujit, veçanërisht në fermat më të mëdha, duke paraqitur rreziqe për biodiversitetin dhe shëndetin publik.

Për më tepër, trajtimi i papërshtatshëm i plehut kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në përhapjen e gazeve serre. Vetëm sektori i gjedhit është përgjegjës për 72% të emetimeve të metanit në Shqipëri, ndërsa praktikat e dobëta të trajtimit të tokës dhe të plehut janë përgjegjëse për 85% të emetimeve të oksidit të azotit. (Charting the Globe – Blegtoria, Shqipëria). Bujqësia është burimi kryesor i emetimeve të metanit në Shqipëri, duke kontribuar rreth 77% të prodhimit kombëtar të CH₄. Kjo vjen kryesisht nga procesi i fermentimit enterik nga bagëtitë e imëta si gjedhët (Banka Botërore 2022 – *Profili i Vendit për Ndryshimet Klimatike, Shqipëria*).

Gjedhet konsiderohen si kontribuesit më të mëdhenj të metanit enterik. Bazuar në vlerësimet e FAO, një lopë qumështi zakonisht lëshon 100–130 kg CH₄/vit, një lopë për mish lëshon midis 50–90 kg CH₄/vit (FAO 2013 - *Përballimi i Ndryshimeve Klimatike përmes Blegtorisë*).

c. Degradimi i kullotave dhe erozioni i tokës

Sistemet tradicionale të zhvendosjes së bagëtive dhe kullotja në toka shtetërore në pjesën më të madhe nuk zbatohen më për shkak të privatizimit të tokës. Si rezultat, kullotat verore në shpatet kodrinore ose kulloten tepër, duke zhveshur mbulesën bimore dhe duke përshpejtuar erozionin, ose braktisen plotësisht, duke lejuar që shkurret të pushtojnë dhe të destabilizojnë më tej tokat. Ky kërcënim i dyfishtë i kullotjes së tepërt dhe të pamjaftueshme kërcënon diversitetin e foragjereve dhe shteron një burim natyror kyç për prodhuesit e bagëtive të imëta.

d. Përdorimi i energjisë

Konsumi i energjisë ndryshon shumë në varësi të madhësisë së fermës. Fermat e vogla vazhdojnë të operojnë me përdorime minimale energjie, sepse mjelja kryhet me dorë dhe përdoren shumë pak makineri të vogla. Nga ana tjetër, fermat dhe përpunuesit e mëdhenj janë të varur nga energjia elektrike për të kryer proceset e ftohjes dhe përpunimit. Pavarësisht kësaj, i gjithë sektori nuk merr parasysh përdorimin e energjisë së rinovueshme, siç janë panelet diellore ose sistemet e biogazit. Kjo përfaqëson një mundësi të humbur të konsiderueshme për të zvogëluar gjurmën e karbonit dhe për të përmirësuar efektivitetin.

e. Humbja e biodiversitetit

Në përpjekje për rendimente më të larta, fermerët kanë favorizuar në mënyrë masive racat e importuara me performancë të lartë (*Holstein, Saanen*, etj.), duke i vënë “në rrezik” ekotipet vendase të bagëtive, deleve dhe dhive. Erozioni gjenetik i bagëtive autoktone shkon paralel me një brez të ngushtë foragjeresh, kryesisht jonxhë dhe misër, të cilat zhvendosin komunitetet tradicionale malore të livadheve me kashtë që dikur kishin një agrobiodiversitet të pasur.

Ruajtja e racave vendase

Biodiversiteti i bagëtive në Shqipëri, duke përfshirë racat vendase të gjedhit, deleve dhe dhive, është si një pasuri mjedisore ashtu edhe një pjesë e trashëgimisë kulturore të vendit. Megjithatë, në përpjekje për të rritur produktivitetin fermerët favorizojnë gjithnjë e më shumë racat e importuara në krahasim me ato vendase. Megjithëse ky ndryshim ka rritur prodhimin e qumështit, ai kërcënon mbijetesën e racave tradicionale që janë përshtatur përgjatë shekujve me kushtet lokale.

Përpjekjet formale të ruajtjes mbeten të kufizuara. Megjithëse ekziston njëfarë njohjeje qeveritare për racat në rrezik, programet gjithëpërfshirëse dhe regjistrat e racave janë të pakta. Megjithatë, racat lokale vazhdojnë të jene prezente në rajone të ndryshme, duke shfaqur qëndrueshmëri ndaj mjediseve të ashpra. Megjithatë, pa ndonjë mbrojtje të veçantë, popullatat e tyre mund të zvogëlohen në nivele të paqëndrueshme dhe bashkë me to, një pasuri e tërë e diversitetit gjenetik mund të humbasë.

Agrobiodiversiteti në ushqimin e kafshëve

Biodiversiteti i ushqimit të kafshëve në fermat e qumështit në Shqipëri është gjithashtu relativisht i ulët. Shumica e fermerëve kultivojnë kultura të zakonshme foragjere si jonxha, misri dhe drithëra të vegjël. Burimet tradicionale të ushqimit të kafshëve, veçanërisht ato të lidhura me livadhet malore të sanës, përdoren rrallë dhe përballen me rrezikun e zhdukjes, pasi këto zona po braktisen gjithnjë e më shumë. Nëse humbet, ky aspekt i agrobiodiversitetit të Shqipërisë mund të jetë i vështirë për t'u rikthyer.

Biodiversiteti i egër

Marrëdhënia midis prodhimit të produkteve të qumështit dhe biodiversitetit të egër është e larmishme. Kullotja, nëse kryhet siç duhet, mund të ndihmojë në ruajtjen e habitateve të hapura që janë jetësore për specie si zogjtë e kullotave dhe pjalmuesit. Nga ana tjetër, kullotja e tepërt degradon mbulesën bimore dhe cilësinë e tokës, ndërsa kullotja e pamjaftueshme ose braktisja e tokës lejon rritjen e shkurreve dhe rrjedhimisht zhvendosjen e specieve që jetojnë aty.

Programi IPARD lidh uljen e përdorimit të kullotave me humbjen e biodiversitetit, dhe megjithëse nuk ka monitorim formal, provat anekdotike tregojnë se praktikat e mirëmenazuara të zhvendosjes së bagëtive ndihmojnë në rritjen e biodiversitetit të kullotave. Fatkeqësisht, keqmenazhimi, qoftë nga kullotja e tepërt apo e pamjaftueshme, vazhdon të dëmtojë ekuilibrin ekologjik dhe larminë e specieve.

f. Paketimi dhe ndotja nga plastika

Me formalizimin e sektorit, paketimi i qumështit është zhvendosur drejt paketimeve plastike një përdorimshe dhe kutive *Tetra Pak*. Pa një infrastrukturë riciklimi në shkallë industriale, mbetjet e paketimit grumbullohen në landfille ose digjen, duke krijuar një barrë mjedisore në rritje.

g. Rreziqet nga lëndët kimike dhe ato antimikrobike

Edhe pse përdorimi i pesticideve në kullota është minimal, zonat e mbjella me bimë ushqimore varen nga plehrat dhe agrokimikatet e importuara që përdoren herë pas here për shkak të burimeve dhe asistencës teknike të kufizuar për fermerët. Akoma më e rëndësishme, mbetjet e antibiotikëve nga mostërheqja në kohë e produkteve dhe testimet e pakta të mbetjeve kërcënojnë rezistencën antimikrobike në toka dhe mikrobe.

Të marra së bashku, këto sfida të ndërlidhura janë pasqyrë e një sektori i cili ndodhet në një udhëkryq mjedisor: praktikat tradicionale, në shkallë të vogël, vazhdojnë pa masa të mjaftueshme mbrojtëse, apo praktika tregtare të cilat shpesh nuk shoqërohen me investime në magazinimin e plehut organik, trajtimin e ujërave të zeza, energjinë e rinovueshme, menaxhimin e kullotave dhe ruajtjen e racave, të cilat janë të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë. Vetëm një paketë e koordinuar e reformës rregullatore, investimeve të përqendruara dhe shërbime praktike këshillimore mund të ndryshojnë drejtimin dhe ta përshtasin sektorin e produkteve të qumështit me standardet moderne mjedisore.

Përfundime: Sektori i qumështit në Shqipëri përballlet me sfida të konsiderueshme mjedisore të rrënjësura në mungesë efektiviteti, joefikasitet, menaxhim të pamjaftueshëm të mbetjeve dhe humbje të biodiversitetit. Blegtoaria me rendiment të ulët dhe plehu i patrajtuar kontribuojnë në emetimin e gazrave serrë, ndërsa kullotat e mbipërdorura ose ato të braktisura përshpejtojnë erozionin dhe kërcënojnë biodiversitetin e egër. Racat indigjene dhe diversiteti tradicional i foragjereve janë në rënie, dhe po zëvendësohen nga ushqime të importuara të përshtatura gjenetikisht dhe me vetëm një përbërës (monokulturë). Mbetjet nga paketimet dhe keqpërdorimi i antibiotikëve rrisin më tej rreziqet ekologjike. Përveç këtyre problemeve, sektori i mungon investimet në energjinë e rinovueshme, trajtimin e plehut organik dhe ruajtjen e racave. Pa reforma të koordinuara që synojnë kuadrin rregullator, infrastrukturën dhe shërbimin këshillimor, sektori rrezikon të thellojë gjurmën e tij mjedisore. Një qasje e bazuar në sistemet e ngritura, e udhëhequr nga qeverisja dhe që i përgjigjet tregut, është thelbësore për të patur një sistem të qëndrueshëm.

6. NDËRHYRJET POLITIKE PËR ZINXHIRIN E VLERËS SË QUMËSHTIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TIJ NË SHQIPËRI, POLITIKA KOMBËTARE

Ky dokument paraqet një sërë masash të integruara politike të hartuara për të adresuar sfidat strukturore në zinxhirin e vlerës së produkteve të qumështit në Shqipëri. Ndërhyrjet janë strukturuar rreth tre parimeve të qëndrueshmërisë: i) një proces dinamik, i bazuar në sisteme; ii) zhvillim me baze në qeverisje; dhe iii) qasje e orientuar drejt tregut fundor. Çdo ndërhyrje është hartuar duke pasur parasysh keto tre parime dhe duke ofruar qëndrueshmëri ekonomike, përfshirje sociale dhe përkujdesje ndaj mjedisit, ndërkohë që ndërhyrja përputhet me objektivat e FAO për sigurinë ushqimore dhe objektivat e projektit të BE "Nga Ferma në Pirun".

6.1. QENDRA TË KONSOLIDUARA TË GRUMBULLIMIT TË QUMËSHTIT

Për të adresuar fragmentimin dhe mungesën e efektivitetit të cilat pengojnë sektorin e prodhimit të qumështit nga fermerët e vegjël në Shqipëri, krijimi i qendrave të përbashkëta të ftohjes ofron një zgjidhje transformuese. Këto qendra lokale të mbledhjes së qumështit, të pajisura me rezervuarë ftohjeje dhe pajisje bazë testimi, u shërbejnë fermerëve brenda një largësie prej 10-15 km. Duke grumbulluar dhe ftohur me shpejtësi qumështin e papërpunuar, këto qendra ruajnë cilësinë, ulin normën e prishjes së qumështit dhe përmirësojnë aksesin në tregjet formale.

Kjo ndërhyrje bazohet në një model investimi të përbashkët, ku prodhuesit e qumështit, kooperativat, bashkitë dhe fondet publike/donatorë (p.sh., IPARD, MARD) ndajnë kostot. Bashkitë kontribuojnë me infrastrukturën dhe shërbimet, ndërsa fermerët përfitojnë nga pikat e përqendruara të shpërndarjes dhe çmime më të ndershme të cilat janë të lidhura me cilësinë e qumështit. Ndikimi ekonomik është i rëndësishëm, këto qendra ulin kostot e transportit dhe humbjet nga mjelja, duke u mundësuar fermerëve të fitojnë më shumë, ndërsa përpunuesit fitojnë furnizim të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë. Sistemet e çmimit në bazë të cilësisë nxisin më tej përmirësimet në fermë. Nga ana sociale, qendrat përmirësojnë sigurinë dhe vlerat ushqimore dhe ushqyerjen duke bërë të mundur që qumështi të mbërrijë i sigurt dhe i pastër tek konsumatori. Ftohja direkt në pikat e grumbullimit frenon rritjen e patogjenëve, rrit besimin e konsumatorit dhe promovon dieta më të shëndetshme. Nga ana mjedisore, qendrat e përbashkëta të ftohjes zvogëlojnë emetimet e gazrave duke optimizuar transportin e qumështit dhe duke ulur sasinë e qumështit të prishur. Ato gjithashtu nxisin një trajtim më të mirë të ujërave të perdorura, duke mbrojtur ekosistemet dhe duke rritur rezistencën ndaj ndryshimeve klimaterike në të gjithë zinxhirin e vlerës së produkteve të qumështit. Për detaje shikoni 9.5. *Ndërhyrjet në Politika për Politikën Kombëtare të Zinxhirit të Vlerave të Prodhimeve të Qumështit në Shqipëri*, një analizë e hollësishme.

Shkurtimisht, qendrat e përbashkëta të ftohjes përfaqësojnë një investim që respekton ambjentin dhe ofrojnë përparësi ekonomike dhe sociale.

6.2. PROGRAMI I MBËSHTETJES SË KOOPERATIVAVE

Organizimi i dobët i fermerëve mbetet sfida kryesore në sektorin e qumështit në Shqipëri. Shumica e fermerëve të vegjël nuk kanë fuqi negociuese, veprojnë të izoluar dhe nuk kanë zë në negociatat e çmimeve, duke i bërë ata të ndjeshëm ndaj luhatjeve të tregut dhe dominimit të përpunuesve. Për të përmirësuar këtë situatë, propozohet zhvillimi i një Programi për Mbështetjen e Kooperativave që do të mbështesë fermerët në formimin dhe forcimin e kooperativave të drejtuara nga vetë fermerët.

Kjo ndërhyrje kombinon ngritjen e kapaciteteve me trajnime në fushat ligjore, financiare dhe menazheriale si dhe një paketë për nxitjen e kooperativave, duke ofruar grante pjesore për infrastrukturën e përbashkët si: rezervuarë ftohjeje, magazina të ushqimit të kafshëve ose paisje pasterizimi. Duke u mbështetur në modele të suksesshme si "Ferma Myzeqeja", programi do të sigurojë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të grave dhe të rinjve, duke u mundësuar në të njëjtën kohë fermerëve të veprojnë në mënyrë kolektive.

Nga pikëpamja ekonomike, kooperativat i ndihmojnë fermerët të sigurojnë çmime dhe kontrata më të mira, të ulin kostot përmes ambjenteve dhe paisjeve të përbashkëta dhe të stabilizojnë zinxhirin e vlerës. Nga pikëpamja sociale, ato përmirësojnë sigurinë ushqimore në zonat rurale, shëndetin publik dhe mirëqenien e përbashkët duke prodhuar produkte qumështi më të sigurta dhe me cilësi më të lartë. Nga ana mjedisore, përpjekjet e përbashkëta për menazhimin e tokës, trajtimin e plehut organik, si dhe përdorimi i paisjeve inteligjente, zvogëlojnë emetimet dhe i bëjnë fermerët më rezistentë ndaj luhatjeve.

Kjo iniciativë jo vetëm që fuqizon fermerët, por e bën sektorin e produkteve të qumështit në Shqipëri më konkurrues, me gjithëpërfshirës dhe me të qëndrueshëm.

6.3. TESTIMI I CILËSISË SË QUMËSHTIT DHE SISTEMI I NXITJES SË PAGESAVE

Sektori i produkteve të qumështit në Shqipëri nuk ka stimul për fermerët cilësorë, të cilët paguhën njësoj pavarësisht higjienës ose përbërjes së qumështit. Kjo nuk nxit përmirësimin e punës, duke ulur si sigurinë ushqimore ashtu edhe konkurrueshmërinë. Për ta ndryshuar këtë, propozohet një *Sistem për Nxitjen e Pagesave sipas Cilësisë së Testuar të Qumështit*.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje, qendrat e grumbullimit të qumështit do të pajisen me njësi testimi të lëvizshme dhe stacionare të cilat do të masin nivelin e yndyrës, baktereve dhe mbetjeve të antibiotikëve. Bazuar në rezultatet e testeve, qumështi do të klasifikohet dhe do ti përcaktohet çmimi, duke shpërblyer ata fermerë që përmbushin standardet më të larta.

Nga pikëpamja ekonomike, ky sistem ofron një shpërblim me të drejtë, duke nxitur përmirësimin e cilësisë, dhe në të njëjtën kohë frenon shitjen informale të qumështit që nuk përmbush standardet. Nga pikëpamja sociale, produktet e qumështit të cilat janë më të sigurta, me vlera më të larta ushqimore përmirësojnë shëndetin e konsumatorit dhe sigurimin e ushqimit. Nga pikëpamja mjedisore, praktika më të mira përkujdesjeje ndaj kafshëve dhe ushqimit të tyre, ulin sasinë e qumështit të prishur, sasinë e mbeturinave dhe keqpërdorimin e antibiotikëve, duke përmirësuar shëndetin e ekosistemit dhe duke ulur gjurmën e karbonit të këtij sektori.

Ky model çmimesh i lidhur me cilësinë forcon besimin, nxit përmirësimet, dhe ndihmon në modernizimin e zinxhirit të vlerës së produkteve të qumështit në Shqipëri.

6.4. INICIATIVA PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË PLEHUT

Mungesa e trajtimit të plehut organik në sektorin e qumështit në Shqipëri ndot ujin, ajrin dhe tokën, ndërsa përbën një shans të humbur për të krijuar vlerë. Masat për menaxhimin e integruar të plehut synojnë ta ndryshojë këtë gjë duke treguar se si mbetjet mund të nxisin qëndrueshmërinë.

Kjo ndërhyrje mbështet fermat e mesme dhe të mëdha në dy qendra të përpunimit të qumështit duke instaluar sisteme moderne si vende të mbuluara për ruajtjen e plehut dhe njësi përpunimi ose tretës të vegjël të biogazit. Me mbështetje nga financimet e gjelbëra dhe grantet IPARD, fermerët mund ta shndërrojnë plehun në plehërues organik dhe energji të pastër.

Nga pikëpamja ekonomike, kjo praktikë ul kostot sepse tashmë inputet prodhohen vetë, dhe krijon të ardhura nga shitja e energjisë dhe nënprodukteve të plehut. Nga pikëpamja sociale, higjiena më e mirë dhe ulja e ndotjes mbron komunitetet dhe siguron ushqim të sigurt. Nga pikëpamja ambientale, kjo iniciativë ul emetimin e gazrave serrë, nxit biodiversitetin dhe rrit rezistencën ndaj ndryshimeve klimaterike.

Duke mbyllur ciklin, ky projekt pilot hedh themelet për një bujqësi qarkulluese në sektorin e prodhimeve të qumështit në Shqipëri.

6.5. GRANTE PËR FUQIZIMIN E GRAVE DHE TË RINJVE

Sektori i qumështit në Shqipëri ende nuk e ka shfrytëzuar plotësisht potencialin e grave dhe të rinjve, të cilët përballen me pengesa të vazhdueshme për të hyrë në këtë sektor, si p.sh. akses i kufizuar në kapital, mentorim dhe mbështetje për biznesin. Këto sfida kanë bërë që një pjesë e madhe e talentit dhe inovacionit në zonat rurale të mos shfrytëzohet. *Fondi Gjithëpërfshirës i Sipërmarrjes në Sektorin e Qumështit* synon të mbyllë këtë boshllëk nëpërmjet mjeteve të fokusuara financiare, si p.sh. grante pjesore, kredi me interes të ulët dhe garanci kredie, së bashku me trajnime të strukturuar për zhvillimin e biznesit.

Fondi mbështet hapjen dhe rritjen e ndërmarrjeve të produkteve të qumështit të drejtuara nga gratë dhe të rinjtë, duke u përqendruar në investime si p.sh. njësi të vogla përpunimi, prodhime qumështi me vlerë të shtuar dhe infrastrukturë të gjelbër. Duke u zbatuar përmes një kuadri publik-privat që përfshin edhe MBZHR, partnerë zhvillimi, banka dhe shoqata lokale, iniciativa synon të nxisë një qasje të barabartë në burime dhe mundësi.

Nga pikëpamja ekonomike, fondi nxit sipërmarrjen në zonat rurale, promovon inovacionin dhe rrit konkurrencën në zinxhirin e vlerës së produkteve të qumështit. Duke bërë të mundur që sipërmarrës të rinj të hyjnë në treg, fondi ndihmon në diversifikimin e ofertave të produkteve të qumështit dhe stabilizimin si të furnizimit ashtu edhe të çmimeve. Këto biznese të reja krijojnë vende pune, rrisin mirëqenien në zonat rurale dhe e bëjnë sektorin më dinamik dhe rezistent ndaj luhatjeve. Nga pikëpamja sociale, ndërhyrja nxit gjithëpërfshirjen dhe barazinë. Mbështetja për gratë dhe të rinjtë çon në një pjesëmarrje më të balancuar në qeverisjen e zinxhirit të vlerës dhe gjenerimin e të ardhurave. Diversifikimi i produkteve të qumështit, siç është qumështi i fortifikuar ose djathërat artizanale, përmirësojnë ushqyerjen e konsumatorit, në një kohë që trajnimet bëjnë të mundur rritjen e sigurisë ushqimore. Përfshirja më e gjerë e grupeve të marginalizuara nxit kohezion më të fortë të komunitetit dhe rigjallërim në zonat rurale. Nga pikëpamja mjedisore, fondi vepron si një katalizator për inovacionin e gjelbër. Duke inkurajuar përdorimin e pajisjeve me efikasiteti më të lartë energjetike, praktika të kursimit të ujit dhe investime rezistente ndaj ndryshimeve klimatike, ai zvogëlon gjurmën e karbonit të këtij sektori. Ai gjithashtu ruan biodiversitetin përmes ruajtjes së racave lokale dhe foragjereve tradicionale. Bizneset e drejtuara nga të rinjtë dhe gratë shpesh ndërtojnë modele fermash të cilat janë më të larmishme dhe qëndrueshme, duke kontribuar në përmirësimin e përkujdesjes ndaj tokës dhe rezistencës afatgjatë përballë ndryshimeve klimatike. Në përfundim, *Fondi Gjithëpërfshirës i Sipërmarrjes në Sektorin e Qumështit* përbën më shumë sesa një mjet financimi, ai është një investim strategjik në të ardhmen e industrisë së qumështit në Shqipëri. Duke fuqizuar brezin e ardhshëm të drejtuesve të sipërmarrjeve në sektorin e produkteve të qumështit, ai krijon një sektor më gjithëpërfshirës, inovativ dhe të qëndrueshëm nga ana mjedisore.

6.6. PROGRAMET E QASJES FINANCIARE PËR INVESTIME NË PRODUKTET E QUMËSHTIT

Sektori i qumështit në Shqipëri mbetet i ndrydhur nga barrierat financiare, veçanërisht për prodhuesit e vegjël dhe të mesëm që kanë vështirësi të investojnë në pajisje moderne dhe të përmbushin standardet në rritje të cilësisë. Për ta kapërcyer këtë, propozohet një ndërhyrje ku ofrohet një *Skemë Garancie Kredie për Produktet e Qumështit* për të ulur riskun e huamarrjes dhe për të përmirësuar qasjen në kredi të përballueshme, dhe *Grante me Fokus Përpunuesit e Vegjël*, për të ndihmuar prodhuesit të kuptojnë programe komplekse financimi si IPARD. Së bashku, këto programe adresojnë si nevojat afatshkurtra për financim, ashtu edhe përmirësimet strukturore afatgjata.

Skema e Garancisë së Kredisë, e mbështetur nga qeveria dhe e mbështetur nga donatorët, u bën të mundur bankave të ofrojnë kredi me kërkesa të ulëta për kolateral dhe norma të ulëta interesi. Këto kredi mund të përdoren për përmirësime thelbësore si sisteme të automatizuara mjeljeje ose rezervuarë ftohjeje

që rrisin produktivitetin dhe cilësinë përgjatë gjithë zinxhirit të vlerës. Me plotësimin e këtyre nevojave, Qendrat e Asistencës Bujqësore dhe Rurale (QABR) do të ofrojnë udhëzime teknike dhe administrative për të ndihmuar fermerët e vegjël dhe përpunuesit të përgatisin aplikime të suksesshme për grante. Këto qendra, të modeluara sipas sukseseve të arritura në Pukë, Kukës dhe Dibër, do të luajnë një rol kyç në thjeshtimin e procedurave dhe mundësimin e qasjes më të barabartë në fonde.

Nga pikëpamja ekonomike, ky program promovon një rritje gjithëpërfshirëse të sektorit duke u mundësuar fermerëve të vegjël dhe të mesëm të konkurrojnë dhe modernizohen, duke ulur kostot e prodhimit dhe duke rritur efektivitetin. Qasja më e gjerë në kredi shpërndan investimet në mënyrë më të barabartë dhe siguron që bizneset në zonat rurale të mund të rriten në mënyrë të qëndrueshme, duke ndihmuar në stabilizimin e çmimeve dhe duke stimuluar ekonominë lokale. *Nga pikëpamja sociale*, përmirësimi i qasjes në financë mbështet sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik duke rritur formalizimin dhe përmirësuar higjienën e përpunimit. Kjo çon në produkte bulmeti më të sigurta dhe vlera ushqyese më të larta për konsumatorët. Me rritjen e nivelit të modernizimit, rriten edhe mundësitë e punësimit dhe të ardhurat, duke përmirësuar mirëqenien në zonat rurale dhe mirëqenien e të gjithë komunitetit. *Nga pikëpamja mjedisore*, qasja në financë inkurajon përdorimin e teknologjive të qëndrueshme. Paisjet me eficientë përdorin më pak ujë dhe çlirojnë më pak gazra, ndërsa menaxhimi i duhur i plehut organik dhe investimet në biogaz ulin ndotjen dhe përmirësojnë riciklimin e burimeve. Përshtatja ndaj klimës forcohet nëpërmjet ngritjes së një infrastrukture miqësore me mjedisin, duke zvogëluar gjurmën mjedisore të sektorit dhe duke rritur qëndrueshmërinë afatgjatë.

Në përmbledhje, ky kuadër financimi nuk është vetëm një mjet për investime, por është një nxitës strategjik i transformimit, duke ndihmuar në përafrimin e sektorit të qumështit në Shqipëri me standardet e BE dhe rritjen e gjelbër dhe gjithëpërfshirëse.

6.7. FONDI I RIINVESTIMIT NË PRODUKTET E QUMËSHTIT, INVESTIMI NË PËRGJEGJËSINË SOCIALE TË KORPORATAVE

Në sektorin e qumështit në Shqipëri, *Përgjegjësia Sociale e Korporatave (CSR)* ofron një mjet të fuqishëm për kompanitë që duan të investojnë në qëndrueshmërinë dhe prosperitetin e komuniteteve nga të cilat varen. Fondi i propozuar i riinvestimit në produktet e qumështit mendohet të mbledhë një pjesë modeste të të ardhurave nga përpunuesit e qumështit dhe do t'i kanalizojë këto burime në infrastrukturë dhe shërbime lokale, duke filluar nga rrugët në zonat rurale dhe qendrat e ftohjes së qumështit deri tek trajnimi i fermerëve dhe projektet e menaxhimit të mbetjeve. I menaxhuar në nivel lokal me kontributin e grupeve të fermerëve dhe mbikëqyrjen e MBZHR, fondi sigurohet që riinvestimet të pasqyrojnë prioritetet e komunitetit, duke forcuar në të njëjtën kohë drejtpërdrejt zinxhirin e vlerës së produkteve të qumështit.

Nga pikëpamja ekonomike, ekonomikisht fondi ndihmon në uljen e sfidave operacionale me të cilat përballen fermerët e vegjël, siç janë rrugët e këqija ose mungesa e infrastrukturës ftohëse, të cilat rrisin kostot dhe ulin cilësinë e qumështit. Duke përmirësuar logistikën dhe ruajtjen e projektit, fermerët mund ta transportojnë qumështin në mënyrë më të sigurt, ndërsa përpunuesit përfitojnë nga një furnizim më i qëndrueshëm dhe produkt me cilësi më të lartë. Kjo rrit efektivitetin dhe aftësinë konkurruese në të gjithë zinxhirin e vlerës, duke ndihmuar ekonominë në zonat rurale të rriten dhe të bëhen më të pavarura. Nga pikëpamja sociale, riinvestimi i fitimeve të industrisë në komunitetet në zonat rurale nxit gjithëpërfshirjen dhe barazinë. Duke financuar shërbime si trajnimi i fermerëve, angazhimi i të rinjve dhe ambientet e përbashkëta, këto iniciativa fuqizojnë ata që shpesh lihen jashtë tregjeve formale, veçanërisht sipërmarrësit gra dhe të rinj. Në të njëjtën kohë, cilësia dhe siguria e përmirësuar e produkteve përkethehet në një ushqyerje dhe shëndet publik më të mirë, duke bërë të mundur që komunitetet jo vetëm të prodhojnë, por edhe të përfitojnë nga produkte të sigurta dhe me vlerë të lartë të qumështit. Nga pikëpamja mjedisore, fondi mbështet projekte që zvogëlojnë gjurmën ekologjike të prodhimeve të qumështit. Investimet në sisteme ftohjeje miqësore me mjedisin, kompostimi i përbashkët, dhe menaxhimi i përmirësuar i mbetjeve ulin ndotjen dhe shpërdorimin e burimeve, ndërsa përmirësimet e rrugëve dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme rrisin rezistencën ndaj ndryshimeve të klimës. Këto masa mbrojnë ekosistemet lokale dhe promovojnë qëndrueshmërinë afatgjatë duke rritur mundësinë e përshtatjes së komuniteteve në zonat rurale me ndryshimet e klimës.

6.8 SHËRBIME PËRMIRËSUARA TË KËSHILLIMIT DHE QASJA NË INFORMACION

Për të modernizuar sektorin e qumështit në Shqipëri dhe për ta bërë atë më konkurrues, një ndërhyrje e re do të përmirësojë shërbimet këshillimore të fermerëve përmes *Qendrave Rajonale Këshillimore për Prodhimin e Qumështit, Aleancave të Zgjeruara Publike-Private* dhe një *Sistemi të Informacionit të Tregut*. Këto tri shtylla punojnë së bashku për të mbështetur fermerët siç duhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktike.

Qendrat Këshillimore për Prodhimin e Qumështit, të ndërtuara mbi qendrat ekzistuese të Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), do të veprojnë si qendra model mësimi ku fermerët mund të mësojnë nga demonstrime konkrete si: parcelat e ushqimit për kafshët, kompostimi i plehut, sistemet e biogazit ose praktikatat moderne të mjeljes. Këto shembuj praktikë i ndihmojnë fermerët të mësojnë nëpërmjet punës, duke e bërë më të lehtë perqafimin e teknikave të përmirësuar që rrisin produktivitetin dhe qëndrueshmërinë.

Përmes *Partneriteteve të Zgjeruara Publike-Private*, këshilltarët e organeve qeveritare dhe ekspertë të sektorit privat (nga shërbimet veterinarë, kompanitë e ushqimit për kafshë ose përpunuesit) do të organizojnë seanca të rregullta trajnime dhe vizita në ferma. Këto aktivitete të personalizuar dhe të bazuara në komunitet do të bëjnë të mundur që fermerët të marrin mbështetjen teknike të duhur dhe në kohë, sipas kërkesave të tregut.

Për të plotësuar këtë përpjekje do të vihet në punë një *Sistem Informacioni i Tregut* i cili do të funksionojë nëpërmjet platformave të lëvizshme ose *WhatsApp* dhe do t'u japë fermerëve përditësime të rregullta mbi çmimet e qumështit, kostot e inputeve dhe tendencat e kërkesës, duke i ndihmuar ata në këtë mënyrë të marrin vendime më të zgjuara për biznesin dhe të negociojnë marrëveshje më të drejta. Nga pikëpamja ekonomike, ekonomikisht kjo qasje ul kostot e prodhimit duke përmirësuar menaxhimin e tufës, praktikatat e ushqyerjes dhe higjienën, duke u lejuar fermerëve të prodhojnë më shumë me më pak. Qasja në të dhëna të besueshme të tregut i vendos të gjithë në të njëjtin nivel dhe ndihmon fermerët e vegjël të kërkojnë çmime më të mira dhe të planifikojnë në mënyrë më strategjike, duke rritur qëndrueshmërinë dhe normat e tyre të fitimit. Nga pikëpamja sociale, kjo iniciativë rrit sigurinë dhe vlerat ushqimore duke rritur cilësinë e qumështit dhe standardet e prodhimit. Duke marrë pjesë në trajnime më të mira, fermerët përdorin praktika më të sigurta dhe më higjienike, duke çuar në produkte qumështi më të shëndetshme. Përfshirja në këto aktivitete e grave dhe të rinjve siguron gjithashtu një zhvillim më gjithëpërfshirës, duke sjellë energji të re dhe barazi në ekonominë në zonat rurale. Nga pikëpamja mjedisore, trajnimet praktike mbi metodat e bujqësisë së qëndrueshme, si kullotja me rotacion, kompostimi i plehut dhe ushqyerja me saktësi, ndihmon në uljen e emetimeve, parandalimin e rrjedhjeve dhe përmirësimin e cilësisë së tokës dhe ujit. Shërbimet e ekstensionit rrisin gjithashtu ndërgjegjësimin mbi ruajtjen e biodiversitetit dhe praktikatat inteligjente të punës, duke i inkurajuar fermerët të përdorin teknika që mbrojnë ekosistemet vendase dhe të përshtaten me ndryshimet e motit.

Kjo iniciativë krijon një sektor më të zgjuar, më të gjelbër dhe më të drejtë të qumështit, i cili bazohet në fuqizimin dhe njohuritë e fermerëve.

6.9. LIDHJA E KONTRATAVE MIDIS FERMERËVE DHE PËRPUNUESVE VENDAS

Për të zvogëluar paqëndrueshmëritë e tregut dhe për të përmirësuar koordinimin në sektorin e qumështit në Shqipëri, kjo ndërhyrje nxit lidhjen e kontratave formale midis fermerëve dhe përpunuesve. Aktualisht sektori dominohet nga shitjet informale, duke i ekspozuar fermerët ndaj paqëndrueshmërisë së çmimeve dhe duke i lënë përpunuesit me furnizim dhe cilësi të paqëndrueshme. Duke lidhur kontrata afatshkurtra dhe transparente, krijohet besim, sigurohet hyrja në treg e fermerëve dhe përpunuesit sigurohen që do të marrin qumësht në sasi të qëndrueshme dhe me cilësi të kontrolluar.

Ndërhyrja do të pilotojë modele kontraktimi në rajonet kryesore të prodhimit të qumështit, duke ofruar kushte të qarta mbi çmimet (fikse ose të bazuara në formulë), sasinë, cilësinë dhe oraret e dorëzimit. Lidhja e këtyre kontratave do të mbështetet me asistencë teknike për të ndihmuar të dyja palët të kuptojnë, negociojnë dhe zbatojnë marrëveshje të drejta. Përveç kësaj, mbështetja me investime, siç është qasja në fondet IPARD, do të lidhet me nënshkrimin e kontratave, duke inkurajuar kryerjen e përmirësimeve në fermë dhe në përpunim. Për të qenë sa më të drejtë dhe për të siguruar llogaridhënie, mekanizmat lehtësues të palëve të treta, si kooperativat ose shërbimet këshillimore, do të monitorojnë pajtueshmërinë dhe do të ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet.

Nga pikëpamja ekonomike, kontraktimi përmirëson planifikimin dhe sigurinë financiare për fermerët, të cilët përfitojnë nga çmimet e qëndrueshme dhe rreziku më i vogël në treg. Ai u mundëson gjithashtu përpunuesve të parashikojnë furnizimin dhe të investojnë me besim në përmirësimet e cilësisë. Kur shoqërohen me akses në grante dhe bashkëfinancim, këto marrëveshje përshpejtojnë modernizimin dhe e bëjnë të gjithë zinxhirin e vlerës më konkurrues dhe efektiv. Nga pikëpamja sociale, kontratat formale mbështesin mirëqenien në zonat rurale duke stabilizuar të ardhurat e fermerëve dhe duke rritur integritetin e tyre në tregjet formale. Kjo ndihmon në uljen e varfërisë dhe përmirëson aksesin në shërbime dhe trajnime, veçanërisht për fermerët e vegjël. Nga ana tjetër, trajtimi më i sigurt i qumështit dhe standardet e përmirësuara të higjienës çojnë në rezultate më të mira të shëndetit publik. Marrëdhëniet e qarta dhe të parashikueshme të tregut gjithashtu e bëjnë blegtorinë më tërheqëse për të rinjtë, duke ndihmuar në uljen e emigrimit nga zonat rurale. Nga pikëpamja mjedisore, kontratat mund të përfshijnë klauzola që promovojnë praktika të qëndrueshme, të tilla si menaxhimi i përgjegjshëm i plehut organik ose përdorimi i ujit. Mbështetja këshillimore që shoqëron këtë proces ndihmon fermerët të përmbushin këto kushte përmes trajnimit në metoda inteligjente në lidhje me klimën. Me kalimin e kohës, kjo nxit një blegtori me emetime më të ulëta dhe me përdorim më efektiv të burimeve, duke mundësuar në të njëjtën kohë investime afatgjata në rritjen e gatishmërisë për situata të parashikuara dhe ruajtjen e biodiversitetit në të gjitha rajonet. Kjo ndërhyrje krijon një situatë të favorshme për të gjitha palët, të ardhura dhe njohuri të qëndrueshme për fermerët, furnizim të qëndrueshëm për përpunuesit dhe një sistem të prodhimit të produkteve të qumështit që është më i pastër dhe më i gatshëm ndaj ndryshimeve.

6.10. STANDARDET DHE ZBATIMI I PËRFORCUAR I TYRE PËR PRODUKTET QUMËSHTIT

Sektori i qumështit në Shqipëri përballet me boshllëqe të konsiderueshme kur flitet për zbatimin e vazhdueshëm të sigurisë ushqimore, mirëqenies së kafshëve dhe standardeve mjedisore. Zbatimi i pabarabartë i rregulloreve në të gjithë zinxhirin e vlerës dëmton besimin e konsumatorit, ul aftësinë konkurruese dhe pengon hyrjen në tregjet vendase dhe të eksportit me vlerë më të lartë. Kjo ndërhyrje synon të krijojë një mjedis rregullator më të fuqishëm, të drejtë dhe efikas duke kombinuar dy qasje strategjike: forcimin e kapaciteteve të autoriteteve shtetërore rregullatore dhe nxitjen e ndjenjës së përgjegjësisë së përbashkët me sektorin privat.

Dimensioni i parë përqendrohet në pajisjen e agjencive të sigurisë dhe inspektimit ushqimor të Shqipërisë me personelin, mjetet dhe aftësitë e nevojshme për të ofruar mbikëqyrje transparente, në kohën e duhur dhe të bazuar në shkencë. Nëpërmjet investimeve me fokus në trajnime, komplete të lëvizshme inspektimi dhe sisteme dixhitale të menaxhimit të të dhënave, inspektorët do të jenë në gjendje të kryejnë teste të shpejta mbi cilësinë e qumështit, higjienën dhe mbetjet e antibiotikëve, dhe t'i ofrojnë informacione të qarta prodhuesve. Për të qenë të drejtë dhe gjithëpërfshirës, do të perdoret zbatimi i standardeve me faza: fermerët e vegjël do të përfitojnë nga mbështetja teknike dhe një periudhë falje për të përmbushur standardet minimale, ndërsa përpunuesit e mëdhenj do t'i nënshtrohen zbatimit të menjëhershëm. Kjo strategji siguron që asnjë fermer të mos mbetet prapa, dhe në të njëjtën kohë ngre nivelin në të gjithë sektorin.

Paralelisht, ndërhyrja vë theksin tek integrimi vertikal i llogaridhënies rregullatore duke vendosur një pjesë të përgjegjësisë për sigurimin e cilësisë tek përpunuesit e qumështit. Si blerës kryesorë të qumështit të papërpunuar, përpunuesve do t'u kërkohet të verifikojnë sigurinë, cilësinë dhe destinacionin e nisjes

së furnizimeve të qumështit. Ata do të nxiten të investojnë në ngritjen e kapaciteteve të furnitoreve të tyre - duke ofruar udhëzime, trajnime, apo edhe duke dhënë hua pajisje sanitare ose shërbime veterinarë. Ky model i zbatimit të përbashkët të rregulloreve jo vetëm që promovon standarde të qëndrueshme, por gjithashtu ndërton besim midis prodhuesve dhe përpunuesve, duke krijuar një zinxhir vlerash më transparent dhe më të parashikueshëm.

Nga pikepamja ekonomike, duke zbatuar të gjitha së bashku rregullat e cilësisë, kjo ndërhyrje bën të mundur konkurrencën në kushte të barabarta. Kjo nxit investimet në përmirësimin e cilësisë dhe higjienës, duke frenuar praktikën informale ose të pasigurta. Me shtimin e prodhuesve të cilët përmbushin standardet, ata gjithnjë e më shumë përmbushin kriteret për t'u certifikuar dhe për të eksportuar, duke rritur në këtë mënyrë stabilitetin në treg, transparencën e çmimeve dhe besimin tek konsumatori. Përveç kësaj, duke përfshirë sigurinë ushqimore në sistemet e prodhimit, sektori i produkteve të qumështit do të jetë në një pozicion më të mirë për të aksesuar mekanizmat publikë të mbështetjes si IPARD ose fondet e integritetit të EU, duke krijuar në këtë mënyrë mundësi për rritje afatgjatë. Nga pikepamja sociale, përmirësimi i rregulloreve të prodhimit të produkteve të qumështit, kontribuon drejtpërdrejt në sigurinë ushqimore, shëndetin publik dhe barazinë sociale. Kur zbatohen standardet minimale të higjienës dhe gjurmueshmërisë së produkteve, bie ndjeshëm rreziku i hyrjes së qumështit të kontaminuar në treg, duke mbrojtur konsumatorët, veçanërisht grupet vulnerabël si fëmijët dhe të moshuarit. Formalizimi i produkteve të fermerëve të vegjël përmes kanaleve rregullatore zvogëlon shkallën e përjashtimit të grupeve të ndryshëm dhe promovon integritetin në tregjet formale. Rregulla më të forta gjithashtu rrisin vlerën e perceptuar të produkteve shqiptare të qumështit, duke inkurajuar konsumin lokal dhe krenarinë kulturore në prodhimin vendas. Nga pikepamja mjedisore, ndërhyrja përfshin dispozita për menaxhimin e mbetjeve, kursimin e ujit dhe përdorimin e kontrolluar të antibiotikëve dhe pesticideve. Këto masa mbrojtëse mjedisore zvogëlojnë gjurmën ekologjike të aktivitetit të prodhimit të produkteve të qumështit, veçanërisht rrezikun e ndotjes së ujërave dhe degradimin e tokës nga ujërat e zeza të patrajtuara. Përveç kësaj, përmirësimi i standardeve të mirëqenies së kafshëve dhe praktikave të kullotjes ruajnë biodiversitetin dhe parandalojnë mbishfrytëzimin e kullotave. Përdorimi i sistemeve digjitale të gjurmueshmërisë së produkteve bën të mundur një monitorim më të mirë të ndikimit në mjedis dhe ndihmon prodhuesit të përdorin teknologji inteligjente ndaj klimës, siç është ftohja më efektive nga pikëpamja energjetike, duke e bërë të gjithë zinxhirin e furnizimit të qumështit më të gatshëm ndaj rreziqeve klimatike.

6.11. PROMOVIMI I NËNPRODUKTEVE TË QUMËSHTIT ME VLERË TË SHITUAR DHE DIVERSIFIKIMI

Në Shqipëri, fermerët e vegjël dhe të mesëm vazhdojnë të mbështeten ndjeshëm në shitjet e qumështit të papërpunuar, gjë që i ekspozon ata ndaj ndryshimeve të çmimit, marzheve të ulëta të fitimit dhe produktit të prishur. Për të ndryshuar këtë dinamikë, kjo ndërhyrje mbështet fermerët dhe kooperativat në ngjitjen me lartë në zinxhirin e vlerës duke prodhuar dhe tregtuar produkte qumështi me vlerë të lartë si djathi, kosi, kefiri, gjalpi dhe produktet tradicionale të fermentuara që pasqyrojnë trashëgiminë e pasur kulinare të Shqipërisë.

Programi ofron grante të pjesshme për pajisje përpunimi në sasi të vogël, të tilla si pasterizues, inkubatorë kosi dhe kazanë djathi, të paketuara në komplete që janë të lehta për t'u instaluar. Këto njësi mikro-përpunimi i mundësojnë fermerëve transformimin e qumështit në produkte me afat me të gjatë përdorimi dhe vlerë më të lartë në tregun e pakicës, duke zvogëluar në të njëjtën kohë varësinë nga ndërmjetësit. Për të siguruar cilësinë dhe autenticitetin e produktit, do të prezantohet një markë kombëtare "Qumështi Shqiptar", e cila certifikon prodhuesit që ndjekin metodat tradicionale, përdorin aditivë minimalë dhe përmbushin standardet e sigurisë ushqimore. Fermerët do të trajnohen mbi praktikën e mira të prodhimit dhe do të mbështeten drejt certifikimit HACCP.

Për të mbështetur hyrjen në treg, programi do të bashkëpunojë me rrjetet rajonale të agroturizmit, duke u bërë të mundur prodhuesve të shesin mallrat e tyre direkt përmes pikave të shitjes së fermave, aktiviteteve të degustimit dhe aktiviteteve turistike. Fushatat e marketingut, panairët dhe platformat digjitale do të rrisin më tej ndërgjegjësimin dhe kërkesën e konsumatorëve. Duke plotësuar anën teknike,

fermerët do të mentorohen në lidhje me çmimin, markën, logjistikën dhe kuadrin rregullator në mënyrë që të sigurohemi që përmirësimet e cilësisë mbeshteten nga strategji të forta biznesi.

Ndikimi është shumëdimensional. Nga pikëpamja ekonomike, shtimi i vlerës së produkteve ndihmon fermerët të rrisin të ardhurat, shpesh 30-50% më shumë për litër qumësht, duke krijuar në të njëjtën kohë burime të reja të ardhurash për komunitetet në zonat rurale, në fusha si paketim, turizëm dhe transport. Nga pikëpamja sociale, kjo iniciativë rikthen krenarinë për prodhimet tradicionale të qumështit, nxit bashkëpunimin dhe krijon hapësira për gratë dhe të rinjtë në drejtimin e sipërmarrjeve të reja. Konsumatorët nga ana tjetër, përfitojnë nga konsumimi i produkteve të qumështit që janë më të sigurta, me vlera ushqyese më të larta dhe që vijnë nga vendi i tyre. Nga pikëpamja mjedisore, ky ndryshim ul humbjet duke shndërruar tepricat e qumështit në produkte me të qëndrueshme dhe nxit përdorimin e energjisë së rinovueshme përmes ujit të ngrohur me panele diellore ose sisteme të vogla të biogazit. Përdorimi i proceseve të prodhimit të paketimeve të qëndrueshme dhe proceset më eficiente nga pikëpamja e përdorimit të burimeve, me kalimin e kohës ndihmojnë fermerët të ndërtojnë sisteme prodhimi që janë më të pastra dhe më të qëndrueshme.

Të gjitha këto përpjekje së bashku përfaqësojnë një zhvendosje nga varësia nga produktet në inovacion në zonat rurale ku dijet tradicionale, praktikat moderne dhe shpirti sipërmarrës vijnë së bashku për të gjallëruar sektorin e qumështit në Shqipëri.

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky dokument politikash përfshin 11 ndërhyrje në politika parësore të sektorit të qumështit, të grupuara sipas fushave tematike. Ai vë theksin në praktika të qëndrueshme bujqësore dhe përputhje me objektivat e politikave të BE për një sistem ushqimor të drejtë, të shëndetshëm dhe miqësor ndaj mjedisit, me qëllim që të arrihet qëndrueshmëria ekonomike, sociale dhe mjedisore. Dokumenti gjithashtu rekomandon një renditje të propozimeve të paraqitura në bazë të plotësisht të disa kriterëve, qartëson rolet e palëve të interesuara dhe sygjeron një afat zbatimi me disa faza për 3-5 vitet e ardhshme.

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË PROPOZUARA SIPAS FUSHËS TEMATIKE

Për të zhvilluar sektorin e produkteve të qumështit në Shqipëri në përputhje me standardet e BE, propozohen një sërë ndërhyrjesh politike në shtatë fusha parësore:

1. Infrastruktura për rritjen e cilësisë dhe siguria ushqimore

Modernizimi i qendrave të grumbullimit të qumështit me përdorimin e sistemeve të ftohjes dhe laboratorëve të testimit në vendin e prodhimit, do të ulë sasinë e produktit të prishur, do të garantojë sigurinë ushqimore dhe do të përmirësojë gjurmueshmërinë e produktit. Standardet më të larta të cilësisë, sistemet e certifikimit dhe trajnimi i fermerëve, do të rrisin shkallën e përafrimit me rregulloret e BE, besimin e konsumatorit dhe do të bëjnë të mundur qasjen në tregje me vlerë më të lartë të produkteve.

2. Zhvillimi i kooperativave dhe qasja në treg

Forcimi i kooperativave të prodhuesve të qumështit do të rrisë fuqinë negociuese të fermerëve, do të zvogëlojë kostot e lëndëve të para dhe do të përmirësojë aksesin në tregje dhe shërbime. Kooperativat e mirëmenazhuara ndihmojnë në grumbullimin e qumështit, nxisin trainimet në grup dhe zbatimin e politikave të BE, dhe mbështesin njëkohësisht bashkëpunimin midis fermerëve dhe korrektesinë në zinxhirin e furnizimit.

3. Qëndrueshmëria dhe gatishmeria ndaj ndryshimeve klimatike

Nxitja e futjes në përdorim të praktikave inteligjente ndaj klimës, siç janë tretësit me biogaz, trajtimi i qëndrueshëm i plehut dhe përdorimi i lëndëve ushqyese me emetime të ulëta, do të ulin emetimet e gazit metan dhe do të mbështesin përafrimin e Shqipërisë me Paktin e Gjelbër të BE. Masat e ruajtjes së mjedisit, si kullotja me rotacion, përdorimi i ushqimit rezistent ndaj thatësisë dhe mbjellja e pemëve në ambjentet e fermës, rrisin biodiversitetin, kursejnë ujin dhe rrisin gatishmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.

4. Mbështetja financiare dhe investimet

Linjat e dedikuara të kreditit për produktet e qumështit dhe skemat e granteve do t'u mundësojnë përpunuesve të investojnë në infrastrukturë, pajisje dhe teknologji. Ulja e riskut, si p.sh. sigurimi i bagëtive dhe stabilizimi i çmimit të qumështit, mund t'i mbrojnë fermerët nga ndryshimet e menjëhershme të klimës dhe të tregut, duke mbështetur investimet dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

5. Përfshirja sociale, mbështetja për gratë dhe të rinjtë

Për të patur një rritje gjithëpërfshirëse, duhen mbështetur në mënyrë thelbësore gratë dhe fermerët e rinj. Trajnimi, kreditimi dhe mundësitë e lidhshme në kooperativa mund t'i fuqizojnë këto grupe, të përmirësojnë jetesën në zonat rurale dhe të nxisin kalimin e punës nga një brez në tjetrin në përputhje me objektivat e BE për përfshirjen në zonat rurale.

6. Diversifikimi i produkteve dhe shtimi i vlerës

Grantet e vogla dhe programet e trajnimit do të nxisin përpunimin në fermë të produkteve të qumështit me vlerë të lartë (p.sh. djathë, kos), duke rritur të ardhurat në zonat rurale dhe duke ulur sasinë e produktit të prishur. Përmirësimi i infrastrukturës, siç janë zinxhirët e ftohjes dhe rrugët nga ferma në treg, do t'i ndihmojnë prodhuesit artizanalë të çojnë produktet e tyre në tregje më të mëdhenj.

7. Shërbimet e ekstensionit dhe sistemet e të dhënave

Zgjerimi dhe dixhitalizimi i shërbimeve të ekstensionit do të bëjë të mundur që fermerët të përdorin praktika të qëndrueshme në mënyrë eficiente. Këshilltarë të trajnuar, klinika të lëvizshme dhe mjete dixhitale (aplikacione dhe sisteme të gjurmueshmërisë) do të bëjnë të mundur informimin në kohë reale, kontrollin e performancës dhe përpunimin me standardet e BE mbi gjurmueshmërinë dhe sigurinë ushqimore.

Të gjitha së bashku, këto ndërhyrje formojnë një udhërrëfyes të qëndrueshëm për transformimin e sektorit të qumështit në Shqipëri, të bazuar në gjithëpërfshirje, produktivitet dhe harmonizim me politikat e BE.

Renditja e propozimeve dhe përcaktimi i përparësive

Përpara fillimit të zbatimit, rekomandohet që vendimmarrësit dhe palët kryesore të interesuara të rendisin dhe përcaktojnë prioritetet për 11 propozimet. Çdo ndërhyrje duhet të vlerësohet kundrejt kriterëve ekonomike, sociale dhe mjedisore të cilat janë në një linjë me parimet e BE për fermat e qëndrueshme dhe objektivat e politikave të BE-së. Kjo analizë, e cila përfshin një sërë kriteresh siguron një qasje të ekuilibruar, duke reflektuar fokusin e PPB-së në qëndrueshmërinë sociale, mjedisore dhe ekonomike. Për shembull, kriteret mund të përfshijnë: fitimet e parashikuara, efikasitetin e kostove (dimensioni ekonomik), përfitimet për komunitetet në zonat rurale dhe përfshirjen e grave/të rinjve (dimensioni social), dhe kontributet në gatishmerinë ndaj klimës ose uljen e emetimeve (dimensioni mjedisor). Duke vlerësuar me pike dhe duke klasifikuar propozimet sipas këtyre dimensioneve, palët e interesuara mund të identifikojnë "fitore të lehta" dhe ndërhyrje me ndikim të lartë. Renditja do të tregojë ndërhyrjet ku duhen përdorur burimet për të mbërritur me shpejt drejt objektivave të Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së dhe objektivave kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë politikat kombëtare me standardet evropiane.

Rolet dhe përgjegjësitë e palëve të interesuara

Zbatimi i suksesshëm i ndërhyrjes do të ketë nevojë për përpjekje të koordinuara nga një sërë aktorësh, me role të qarta udhëheqëse dhe mbështetëse:

- Qeveria (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencitë): *Udhëheqin* të gjithë programin, reformat e politikave dhe financimin. Organet qeverisëse do të hartojnë rregullore për cilësinë, do të ofrojnë mbështetje buxhetore ose subvencione (p.sh. për skema krediti ose sigurimi) dhe do të koordinojnë punën midis sektorëve (bujqësi, financa, arsim).
- Grupet e fermerëve të prodhuesve të qumështit dhe shoqatat e fermerëve: *Udhëheqin/mbështesin* në nivelin bazë. Grupet e fermerëve do të organizojnë trajnime dhe ofrojnë shërbime për fermerët, do të menaxhojnë qendrat e grumbullimit të qumështit dhe do të nxisin një përfshirje sa më të plotë duke angazhuar fermerët e vegjël, dhe duke përfshirë gratë dhe të rinjtë. Ata do të shërbejnë si partnerë kyç për qeverinë për të mbërritur tek çdo fermer dhe për të përshkallëzuar projektet pilot.
- Sektori privat (përpunuesit, furnitorët, shitësit me pakicë): *Mbështesin* investimet dhe inovacionin. Kompanitë e përpunimit të produkteve të qumështit mund të investojnë në zinxhirin e ftohjes, kontrollin e cilësisë dhe zhvillimin e produkteve të reja (mundësisht duke bashkëfinancuar projekte të ndryshme). Furnitorët e inputeve (ushqim për kafshë, pajisje) dhe firmat agroteknologjike kontribuojnë me teknologji dhe njohuri (për shembull, duke ofruar aditivë për ushqimet ose aplikacione për menaxhimin e fermave). Lidhjet e tregjeve të sektorit privat do të jenë jetësore për një qasje të qëndrueshme në treg.

- Institucionet financiare: *Mbështesin* ndërhyrjet financiare. Bankat, institucionet e mikrofinancës dhe kompanitë e sigurimeve do të përgatisin dhe ofrojnë produkte krediti dhe siguri të përshtatura për fermerët e prodhimit të produkteve të qumështit, mundësisht me mbështetje nga qeveria në formën e garancive ose normave të interesit. Roli i tyre siguron qëndrueshmërinë financiare të ndërhyrjeve me anë të lehtësimit të marrjes së kredive.
- Agjencitë e kërkimit dhe ekstensionit: *Mbështesin* transferimin e njohurive, ndërsa institutet dhe universiteti i kërkimit bujqësor mund të zhvillojnë praktika me të mira të prodhimit të qumështit (përfshirë përmirësimin e racave, ushqimet për kafshët, kontrollin e sëmundjeve) dhe të monitorojnë rezultatet. Shërbimet e ekstensionit (shteterore ose OJQ) janë në vijë të parë për trajnimin e fermerëve dhe ngritja e kapaciteteve të tyre është pjesë integrale e shërbimit të ekstensionit. Agjencitë e përpunimit të të dhënave ose ofruesit e teknologjive të informacionit do të ndihmojnë në ndërtimin e sistemeve dixhitale.
- Partnerët e zhvillimit (BE, Donatorët, OJQ): do të ofrojnë *mbështetje* përmes asistencës teknike dhe financimeve për projektet pilot. Agjencitë e zhvillimit mund të ofrojnë ekspertizë mbi praktikën më të mirë të BE, të japin grante për projektet pilot (veçanërisht në projektet që fokusohen tek qëndrueshmëria dhe gjithëpërfshirja) dhe të nxisin dialogun politik. Duke patur parasysh rëndësinë e harmonizimit me kuadrin e BE, partnerët ndërkombëtarë (si p.sh. Delegacioni i BE, FAO, etj.) do të sigurohen që udhërrëfyesi të jetë në përputhje me standardet e BE dhe mund të ofrojnë ndihmën e tyre në proceset e monitorimit dhe vlerësimit.

Duke përcaktuar qartë këto role, planifikimi nxit llogaridhënien. Çdo ndërhyrje do të ketë një agjenci të caktuar që do të udhëheqë procesin (p.sh., Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për standardet e cilësisë) dhe një grup aktorësh mbështetës, në mënyrë që përpjekjet të jenë plotësuese dhe burimet të optimizuara.

Plani i zbatimit me disa faza (Nga faza pilot deri në zbatim në nivel kombëtar)

Udhërrëfyesi do të zbatohet me faza përgjatë një periudhe 5 vjeçare, duke lënë kohë për të mësuar përpara se të zbatohet në të gjithë vendin:

Faza 1: Pilot (viti 1). Ndërhyrje në shkallë të vogël për të kuptuar fizibilitetin. Gjatë vitit të parë, do të fillojnë projekte në disa zona kryesore për një numër të vogël ndërhyrjesh, p.sh. në qarqe të ndryshëm do të ngrihen 2-3 qendra grumbullimi dhe cilësie dhe 1-2 modele kooperativash, dhe do të testohen praktikë inteligjente ndaj klimës në fermat pilot. Në të njëjtën kohë, do të fillojë përgatitja e produkteve financiare dhe platforma e të dhënave. Kjo do të thotë që do të krijohen skema kredie ose paketa kredie për fermerët e vegjël dhe kooperativat, siguri i përshtatur sipas kushteve të motit dhe siguri i bagëtive, marrëveshje qeraje për pajisje dhe infrastrukturë, subvencione ose grante investimi dhe mekanizma të përziera financimi me përdorimin e fondeve publikë dhe privatë. Platformat e të dhënave janë sisteme dixhitale që grumbullojnë dhe analizojnë informacionin, si p.sh. cilësia e qumështit, prodhimi i fermës, çmimet dhe moti, për të ardhur në ndihmë vendimmarrjes, për të përmirësuar gjurmueshmërinë dhe për të monitoruar performancën e ndërhyrjeve në të gjithë zinxhirin e vlerës. Gjatë kësaj faze do të përqendrohemi tek ngritja e kapaciteteve: do të trajnohen ekspertët e shërbimit të ekstensionit, drejtuesit e kooperativave dhe fermerët pjesë e ndërhyrjes. Do të ngrihet një komitet drejtues me pjesëmarrjen e shumë palëve të interesuara për të mbikëqyrur punën dhe për të dokumentuar mësimet. Etapa e parë (**fundi i vitit 1**): Të paktën 3 projekte pilot janë në funksionim (p.sh., një qendër ftohjeje qumështi, një kooperativë, një njësi biogazi), dhe disponohen të dhënat fillestare të performancës gati për vlerësim.

Faza 2: Rritja e numrit të projekteve (vitet 2-3). Vlerësimi dhe përhapja e projekteve të suksesshme pilot. Në fund të vitit të parë (1) duhet kryer një vlerësim i plotë për të kuptuar se çfarë ka funksionuar. Në vitin e dytë (2), duhen përmirësuar ndërhyrjet nisur nga mësimet e projekteve pilot (p.sh., përshtatja e kushteve të kredisë ose përmbajtja e trajnimit) dhe duhet zgjeruar harta e mbulimit. Duhet rritur numri i ndërhyrjeve që kanë rezultuar më premtoese në shumë rajone të tjera: për shembull, rritja e qendrave të grumbullimit të qumështit për të mbuluar të gjitha grupet kryesore të produkteve të qumështit, rritja

e numrit të kooperativave në programin e forcimit të tyre, dhe ofrimi i shërbimit të përmirësuar të ekstensionit në të gjithë rajonin. Në vitin e tretë (3), shumë ndërhyrje do të kalojnë nga projekti pilot në fazën e zbatimit rajonal. Kjo fazë përfshin gjithashtu sigurimin e financimeve më të mëdha ose partneritetin publik-privat për tu zgjeruar më tej. Etapa e dytë (viti 2-3): Deri në fund të vitit të tretë, të paktën 50% e fermerëve të produkteve të qumështit ndodhen pranë qendrave të përmirësuara të grumbullimit ose kooperativave; të dhënat paraprake tregojnë përmirësim (p.sh., ulje e shkallës së refuzimit të qumështit, rritja e të ardhurave të fermerëve, reduktim i dokumentuar i emetimeve në fermat pilot).

Faza 3: Zbatim në shkallë kombëtare (vitet 4-5). Integrimi dhe institucionalizimi i iniciativave të suksesshme për një përmirësim në shkallë kombëtare. Deri në vitin e katërt (4), ndërhyrjet që kanë rezultuar efektive dhe të qëndrueshme po zbatohen në të gjitha zonat e planifikuara të vendit. Kjo do të thotë që këto programe janë përfshirë në institucionet kombëtare (për shembull, financim i përhershëm për sektorin e qumështit, ose një sektor i veçantë në ministrinë përgjegjëse për produktet e qumështit). Vazhdon zgjerimi i programeve të shtimit të vlerës dhe gjithëpërfshirjes në mënyrë që ato të bëhen të vetëqëndrueshme. Viti i pestë (5) përqendrohet në konsolidim: duhet të sigurohemi që kornizat ligjore të përditësohen (nëse është e nevojshme), të formalizohen standardet e cilësisë ose politikat e kooperativave, dhe të përmbushen plotësisht kapacitetet lokale në funksion të menaxhimit afatgjatë. Etapa e tretë (viti 4 - 5): Deri në vitin e pestë, të gjitha ndërhyrjet (11) po zbatohen plotësisht në të gjithë vendin ose janë pjesë integrale e programeve qeveritare. Në këtë periudhë kryhet një vlerësim përfundimtar, i cili tregon përfitime të matshme në cilësinë e qumështit, prodhimtarinë e fermës dhe të të ardhurave në zonat rurale, së bashku me progresin drejt objektivave mjedisore (p.sh., emetime më të ulëta të sektorit të produkteve të qumështit).

Gjatë këtyre fazave, monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm do të bëjnë të mundur përshtatjet e nevojshme. Sukseset e hershme do t'u komunikohen palëve të interesuara për të ruajtur vrullin, dhe sfidat do të adresohen nëpërmjet komitetit drejtues. Kjo qasje me faza balancon urgjencën me maturinë, duke bërë të mundur që sektori të mësojë nga zbatimi në terren dhe të përshkallëzojë ato ndërhyrje që japin rezultate të qëndrueshme.

8. REFERENCAT

- AGT & DSA. (2021a). *Studim i sektorit të qumështit- Raporti final. Përgatitur për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MARD) dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri – Analiza Sektoriale* <https://bujqesia.gov.al/ipard-iii-2021-2027/studimet-sektoriale-sectorial-studies/>
- ANRD. (2024). *Konsultim dhe dialog pjesëmarrës për forcimin e pozicionit të fermerëve në zinxhirin e vlerës (Raport i papublikuar).*
- BECBA. (n.d.). *Raporti Kombëtar Shqiptar: Përpyqjet e Shqipërisë për përputhjen me direktivat e BE për menaxhimin e mbetjeve.*
- Biçoku, Y. (2023). *Tendencat e sektorit të qumështit në Shqipëri. International Journal on Agriculture and Environmental Research.*
- Biçoku, Y., Leonetti, L., Skreli, E., Imami, D., & Zhllima, E. (2021). *Studimi i sektorit të qumështit 2021. Raport i përgatitur si pjesë e Projektit numër 2017.2192.7-001.00.*
- CAP strategic plan. *Plani Strategjik i CAP për Shqipërinë* https://agriculture.ec.europa.eu/cap-my-country/cap-strategic-plans_en
- Engjell, S., & Imami, D. (2018). *Studim për sektorin e qumështit. AASF, Banka Evropiane, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*
- FAO. (2025). *FAOSTAT: Fletët e bilancit ushqimor* <https://www.fao.org/faostat/en/#data/FBS>
- FAO. (2025). *Treguesit e importit, eksportit dhe bilancit tregtar (2010–2022). Në FAOSTAT: Fletët e Bilancit Ushqimor* <https://www.fao.org/faostat/en/#data/FBS>
- FAO. (n.d.). *Platforma e njohurive për zinxhirët e qëndrueshëm ushqimorë* <https://www.fao.org/sustainable-food-value-chains/home/en/>
- FAO. (n.d.). *Vlerësimi i ndikimit të luftës së Rusisë ndaj Ukrainës mbi bujqësinë dhe zonat rurale në Shqipëri (Raport i papublikuar).*
- Food and Agriculture Organization of the United Nations – FAO. (2023). *Tronditjet ekonomike dhe rezistenca: Ndikimi i krizave në ushqim, energji dhe financa mbi bujqësinë dhe sistemin ushqimor në Shqipëri (Raport Teknik i papublikuar).*
- INSTAT. (2021). *Statistikat e bujqësisë* <https://www.instat.gov.al/media/10183/statistikat-e-bujq%C3%ABsis%C3%AB-2021.pdf>
- INSTAT. (2022). *Statistikat e bujqësisë* <https://www.instat.gov.al/media/11771/statistikat-e-bujq%C3%ABsis%C3%AB-2022.pdf>
- INSTAT. (2023). *Statistikat e bujqësisë* <https://www.instat.gov.al/media/13518/statistikat-e-bujq%C3%ABsis%C3%AB-2023.pdf>
- Komisioni Evropian. (2020). *Strategjia EU “Nga Ferma tek Pjata” – Për një sistem ushqimor të drejtë, të shëndetshëm dhe miqësor ndaj mjedisit* https://food.ec.europa.eu/system/files/2020-05/f2f_action-plan_2020_strategy-info_en.pdf
- Komisioni Evropian. (n.d.). *Objektivat specifike të CAP: Pozicioni i fermerëve në zinxhirin e vlerës* https://agriculture.ec.europa.eu/cap-my-country/sustainability/economic-sustainability/cap-measures_en

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural & Ministria e Financave. (2023). Udhëzimi nr. 06, datë 07.03.2023: Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondeve të programit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Qeveria e Shqipërisë. (2022). Vendimi nr. 460, 29.06.2022: Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit.

Qeveria e Shqipërisë. (2024a). Vendimi nr. 130, datë 06.03.2024: Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2024.

Qeveria e Shqipërisë. (2024b). Vendimi nr. 581, datë 07.03.2024: Për disa shtesa në vendimin nr. 130, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave.

UNFCCC. (n.d.). Komunikimi i Katërt Kombëtar i Shqipërisë për UNFCCC https://unfccc.int/sites/default/files/resource/Fourth%20National%20Communication%20of%20Albania%20to%20the%20UNFCCC_EN.pdf

9. ANEKSE

9.1. KORNIZA KRYESORE LIGJORE E LIDHUR ME SEKTORIN E QUMËSHTIT NË SHQIPËRI

INSTRUMENTI LIGJOR	TITULLI	SHËNIME
Ligji nr. 9817/2007	Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural	Përcakton skemat mbështetëse për investimet në qumësht
Ligji nr. 9863/2008	Për Ushqimin	Rregullon sigurinë dhe higjienën e qumështit
Ligji nr. 10465/2011	Shërbimi Veterinar në Republikën e Shqipërisë	Siguron shëndetin e kafshëve dhe gjurmueshmërinë e qumështit
Ligji nr. 10288/2009	Prodhimi Organik	Zbatohet për prodhimin organik të certifikuar të qumështit
Ligji nr. 7501/1991	Për Tokën	I rëndësishëm për konsolidimin e fermave dhe kolateralin e investimeve
Ligji nr. 105/2016	Për Programin Kombëtar të Konsolidimit të Tokës	Mundëson modernizimin e fermave të copëzuara të qumështit
Ligji nr. 72/2012	Për Kooperativat Bujqësore	Lehtëson krijimin e grupeve të prodhuesve për grumbullimin e qumështit
VKM nr. 460, datë 29.06.2022	Miratimi i Strategjisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2021–2027	Miratim i strategjisë

9.2. DOKUMENTE STRATEGJIKË TË LIDHUR ME SEKTORIN E QUMËSHTIT

DOKUMENTI	TITULLI	VITI	SHËNIME
SARD 2021–2027	Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural	2022	Dokument kyç politik me fokus tek sektori i qumështit
IPARD III	Instrumenti për Mbështetje Paraprijëse për Zhvillimin Rural	2021–2027	Mbështet përpunimin e qumështit, investimet në ferma dhe cilësinë e qumështit

DOKUMENTI	TITULLI	VITI	SHËNIME
EU CAP 2027-2027	Politika e Përbashkët Bujqësore	2021-2023	Përputhje strategjike për modernizimin e qumështit dhe përputhshmëri me standardet
Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor	Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor	2020	Promovon sisteme të qëndrueshme ushqimore
NSDI III	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	2022	Kuadër për planifikim kombëtar

9.3.TABELA E VLERËSIMIT TË QËNDRUESHMËRISË

Tabela 3. Treguesit e integruar të qëndrueshmërisë ekonomike

SHKALLA	PËRSHKRIMI
1 - Shumë e ulët	Sistemi ushqimor funksionon me humbje, duke sjellë mbyllje të shpeshta biznesesh. Mundësitë e punësimit janë në rënie, pagat e ulëta dhe kushtet e punës jo të favorshme. Të ardhurat nga taksat janë minimale dhe kontribuojnë pak në shërbimet publike. Furnizimi me ushqim është i paqëndrueshëm, me mungesa të shpeshta dhe varësi të lartë nga importet.
2 - E ulët	Fitimet janë të ulëta dhe shumë biznese përballen me vështirësi për të mbijetuar. Krijimi i vendeve të punës është i kufizuar, shpesh me kontrata të përkohshme ose jo të sigurta. Të ardhurat tatimore janë të ulëta për shkak të përmasës së madhe të sektorit informal. Furnizimi me ushqim mbetet i pasigurt, me varësi të konsiderueshme nga importet dhe rreziqe për ndërprerje në zinxhirin e furnizimit.
3 - Mesatar	Bizneset sigurojnë fitime të qëndrueshme, por të ulëta, që lejojnë një nivel të kufizuar riinvestimi. Punësimi është relativisht i qëndrueshëm, por pagat mbeten modeste. Kontributet tatimore janë mesatare, me një formalizim të pjesshëm të aktiviteteve ekonomike në sektorin ushqimor. Furnizimi me ushqim është përgjithësisht i qëndrueshëm, por ende i varur nga mbështetja e jashtme ose importet.
4 - E lartë	Sektori ushqimor është fitimprurës dhe në rritje të qëndrueshme. Hapësirat për punësim janë të shumta, me vende pune të sigurta dhe mundësi rritje në karrierë. Të ardhurat tatimore janë të konsiderueshme dhe mbështesin ofrimin e shërbimeve publike. Furnizimi me ushqim është i sigurt, duke u mbështetur si te prodhimi vendas ashtu edhe te importet për të siguruar stabilitet.
5 - Shumë e lartë	Fitimet e larta krijojnë mundësi për riinvestim dhe zgjerim të sektorit. Ofron vende pune të shumta, të paguara mirë dhe mbrojtje sociale. Kontributet tatimore janë të larta, duke nxitur zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Siguria ushqimore është e sigurt, me prodhim vendas të vetëmjaftueshëm dhe një zinxhir furnizimi rezistent ndaj krizave.

Tabela 4. Treguesit e integruar të qëndrueshmërisë sociale (shkallë Liker 1-5)


SHKALLA	PËRSHKRIMI
1 - Shumë e ulët	Pabarazi ekstreme në shpërndarjen e vlerës së shtuar; grupet e marginalizuara (gratë, të rinjtë, popullsitë autoktone) nuk kanë qasje në mundësi ekonomike. Traditat kulturore të lidhura me ushqimin po zhduken me shpejtësi. Ushqime të pasigurta dhe probleme të përhapura shëndetësore, përfshirë pasiguri ushqimore dhe kequshqyerje. Kushtet e punës janë të pasigurta, me shfrytëzim dhe mungesë të mbrojtjes së punëtorëve. Nuk respektohet mirëqenia e kafshëve; dominojnë praktikrat e paqëndrueshme. Institucionet janë të dobëta ose të korruptuara dhe nuk zbatojnë rregullat apo mbrojtjet sociale.
2 - E ulët	Pjesëmarrja e grupeve të marginalizuara në aktivitetet ekonomike është e kufizuar, me diferenca të dukshme në paga dhe mundësi. Traditat kulturore janë nën presion, pasi industrializimi po zëvendëson produktet dhe teknikat tradicionale. Ka disa përparime në ushqyerje dhe shëndet, por akses i barabartë në ushqim ende mungon. Të drejtat e punës nuk zbatohen, me punësim informal dhe të pasigurt. Standardet për mirëqenien e kafshëve janë minimale, me praktika joetike të përhapura. Institucionet ekzistojnë, por kanë kapacitete dhe ndikim të kufizuar.
3 - Mesatare	Shpërndarja e vlerës është pjesërisht e barabartë, me qasje në rritje, por ende të pabarabartë në mundësi për grupet vulnerabël. Disa tradita kulturore ruhen, por kërkesa po zhvendoset drejt ushqimeve të përpunuara. Ka përmirësime mesatare në ushqyerje dhe shëndet, por sëmundjet e lidhura me ushqimin mbeten të pranishme. Të drejtat e punëtorëve mbrohen pjesërisht, edhe pse punësimi informal mbetet problem. Ligjet bazë për mirëqenien e kafshëve ekzistojnë, por nuk zbatohen plotësisht. Institucionet funksionojnë, por përballen me vështirësi në zbatimin e rregullave.
4 - E lartë	Shpërndarja e vlerës së shtuar është e barabartë, me politika aktive që mbështesin pjesëmarrjen e grave, të rinjve dhe komuniteteve vendore në sistemet ushqimore. Traditat kulturore respektohen dhe integrohen në sistemet moderne ushqimore. Cilësia e ushqimit dhe situata shëndetësore janë të mira, me akses të gjerë në ushqim të sigurt dhe të shëndetshëm. Pagat janë të drejta dhe kushte e punës të sigurt. Mirëqenia e kafshëve është prioritet, me standarde etike të përcaktuara qartë. Institucionet rregullojnë në mënyrë efektive çështjet e sigursë ushqimore, të drejtat e punëmarrësve dhe praktikrat e qëndrueshme.
5 - Shumë e lartë	Pjesëmarrja e të gjitha grupeve shoqërore në shpërndarjen e vlerës së shtuar është e plotë, pa barriera sistemike. Traditat kulturore ruhen dhe promovohen si pjesë përbërëse e sistemit ushqimor. Treguesit e ushqyerjes dhe shëndetit janë të shkëlqyer, me akses universal në ushqim cilësor. Të drejtat dhe siguria e punëtorëve mbrohen plotësisht, me zbatim të fortë të ligjeve të punës. Standardet e larta për mirëqenien e kafshëve garantojnë trajtim njerëzor dhe praktika të qëndrueshme. Institucionet janë transparente, efektive dhe respektojnë standarde të larta të qeverisjes në të gjitha aktivitetet e sistemit ushqimor.

Tabela 5. Treguesit e integruar të qëndrueshmërisë mjedisore (shkallë Liker 1-5)

SHKALLA	PËRSHKRIMI
1 - Shumë e ulët	Gjurmë shumë të larta karboni, varësi e madhe nga lëndët djegëse fosile dhe përdorim joefiçent i ujit. Degradim i rëndë i tokës, me ndotje të lartë dhe rrezik shkretimi. Dëmtim i shëndetit të bimëve dhe kafshëve për shkak të përdorimit të tepërt të pesticideve dhe plehrave kimike. Humbje dhe shpërdorim i pakontrolluar ushqimi, dhe mungesë masash për reduktim apo riciklim. Humbje e shpejtë e biodiversitetit për shkak të shpyllëzimit, shkatërrimit të habitateve dhe bujqësisë monokulturore. Nivele të larta toksiciteti në ushqim, ujë dhe tokë për shkak të ndotjes industriale dhe mbetjeve kimike.
2 - E ulët	Ndikim i lartë mjedisor me disa përpjekje për të kufizuar dëmet. Gjurmët e karbonit mbeten të mëdha, me përdorim joefikas të burimeve. Cilësia e tokës dhe ujit është e dobët, me shenja degradimi dhe ndotjeje. Rreziqe të moderuara deri të larta për shëndetin e bimëve dhe kafshëve nga ndotësit dhe kimikatat. Ekzistojnë disa politika për reduktimin e humbjes së ushqimit, por zbatimi i tyre është i dobët. Biodiversiteti është nën kërcënim, me humbje të specieve dhe dëmtim të ekosistemeve. Nivelet e toksicitetit janë shqetësuese, me përdorim pesticidesh dhe plehrash kimike që i tejkalon kufijtë e lejuar.
3 - Mesatare	Ka disa përparime në uljen e ndikimit mjedisor. Gjurmët e karbonit janë në nivele mesatare, me adoptim të pjesshëm të praktikave të qëndrueshme. Shëndeti i tokës dhe ujit tregon shenja përmirësimi, edhe pse ndotja ende ekziston. Ekzistojnë masa për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe kafshëve, por zbatimi është joefektiv. Menaxhimi i humbjeve dhe mbetjeve ushqimore po përmirësohet, me ndërgjegjësim në rritje dhe zbatim të pjesshëm të strategjive të reduktimit të mbetjeve. Humbja e biodiversitetit po ngadalësohet, me përpjekje për ruajtje, por ende të kufizuara. Nivelet e toksicitetit monitorohen, por ndotja e mjedisit vazhdon.
4 - E lartë	Gjurmë të ulëta karboni falë përdorimit në shkallë të gjerë të energjisë së rinovueshme dhe menaxhimit efektiv të ujit. Burimet e tokës dhe ujit menaxhohen mirë, me masa të forta për ruajtje dhe kontroll të ndotjes. Shëndeti i bimëve dhe kafshëve është prioritet, me përdorim të kujdesshëm të inputeve dhe strategji parandaluese ndaj sëmundjeve. Masa efektive për reduktimin e humbjeve ushqimore janë në zbatim, duke nxitur një shkallë të lartë riciklimi dhe ripërdorimi. Biodiversiteti mbrohet përmes praktikave bujqësore të qëndrueshme dhe përpjekjeve për ruajtjen e habitateve. Nivele minimale toksiciteti, me rregullore strikte për përdorimin e kimikateve dhe sigurinë ushqimore.
5 - Shumë e lartë	Ndikim jashtëzakonisht i ulët mjedisor, me sistem ushqimor neutral në emetimin e karbonit dhe efikas në përdorimin e ujit. Shëndeti i tokës dhe i ujit i plotë dhe menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme. Shëndeti i bimëve dhe kafshëve garantohet përmes praktikave të qëndrueshme, duke eliminuar përdorimin e inputeve të dëmshme. Humbja e ushqimit është pothuajse zero, me zbatim të plotë të parimeve të ekonomisë qarkulluese. Biodiversiteti ruhet përmes mbrojtjes së ekosistemeve dhe praktikave rigjeneruese në bujqësi. Ushqimi prodhohet në kushte të pastra e të sigurta, duke mbrojtur shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit.

9.4 KONSUMI DHE TREGTIA

Figura 1. Konsumi i qumështit për frymë: Shqipëria krahasuar me BE dhe botën



Burimi: FAO. (2025).

Figura 2: Performanca e tregtisë së qumështit: Importi, eksporti dhe bilanci tregtar (000 ton)



Burimi: FAO, (2025).

9.5. NDËRHYRJET TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E POLITIKAVE KOMBËTARE TË ZINXHIRIT TË VLERËS SË QUMËSHTIT NË SHQIPËRI. ANALIZË E DETAJUAR

1. Qendrat e konsoliduara për grumbullimin e qumështit

Fermerët e vegjël të qumështit në Shqipëri përballen me vështirësi të mëdha për të hyrë në tregjet formale, për shkak të prodhimit të copëzuar, cilësisë së ulët të qumështit dhe kostove të larta logjistike. Këto sfida shpesh çojnë në humbje pas prodhimit, të ardhura më të ulëta për fermerët dhe mungesë stimuluesh për përmirësimin e cilësisë.

Krijimi i qendrave të grumbullimit të pajisura me mjete ftohëse synon t'i adresojë këto probleme duke ofruar infrastrukturë të përbashkët për grumbullimin, ftohjen dhe kontrollin fillestar të cilësisë së qumështit, brenda një distance të menaxhueshme grumbullimi (10–15 km). Ftohja e menjëhershme në pikën e mbledhjes është thelbësore për ruajtjen e cilësisë dhe sigurisë së qumështit, uljen e rrezikut të prishjes dhe përmbushjen e standardeve më të larta që kërkojnë përpunuesit dhe tregjet e eksportit.

Përmes formalizimit të procesit të grumbullimit me anë të këtyre qendrave, fermerët e vegjël mund të integrohen më lehtësisht në zinxhirët e vlerës, të sigurojnë të ardhura më të qëndrueshme e të parashikueshme dhe të përfitojnë çmime më të mira, të lidhura me parametrat e cilësisë.

Pikat kryesore ku mbështetet zbatimi:

- ➔ **Skema e investimeve të përbashkëta:** Përpunuesit e qumështit, grupet e fermerëve dhe programet e financimit (p.sh. MARD, IPARD, donatorët) ndajnë kostot e investimit.
- ➔ **Infrastruktura vendore:** Bashkitë ndihmojnë në përzgjedhjen e vendndodhjes së investimeve dhe sigurimin e shërbimeve bazë (ujë, energji etj.).
- ➔ **Ruajtja e cilësisë:** Ftohja e menjëhershme e qumështit ruan cilësinë, duke u siguruar përpunuesve furnizim të qëndrueshëm dhe cilësi më të lartë.
- ➔ **Ekonomitë e shkallës:** Grumbullimi në një pikë të vetme ul kostot logjistike dhe përmirëson stabilitetin e çmimeve, duke i lidhur fermerët e vegjël me tregjet formale.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është është:

Ekonomik: Ndërhyrja rrit ndjeshëm të ardhurat e fermerëve dhe ul kostot e tyre. Qendrat e përbashkëta të grumbullimit u japin fermerëve të vegjël më shumë fuqi negociuese dhe mundësi për të përfituar çmime më të larta bazuar në cilësinë e produktit. Kjo qasje kolektive ul kostot e transportit dhe humbjet nga prishja e qumështit, duke sjellë ekonomi shkalle dhe stabilitet më të lartë të çmimeve. Si rezultat, konsumatorët përfitojnë nga çmime më konkurruese, ndërsa prodhuesit ndajnë vlerën e shtuar që krijohet në zinxhirin e furnizimit.

Social: Përsa i përket qëndrueshmërisë sociale ndërhyrja rrit sigurinë ushqimore dhe kontribuon në ushqyerje më të shëndetshme për komunitetet lokale. Ftohja e menjëhershme në pikat e grumbullimit ruan cilësinë dhe sigurinë e qumështit, duke ulur rrezikun e sëmundjeve që lidhen me ushqimin. Kjo garanton që më shumë qumësht i sigurt të arrijë te konsumatorët, duke përmirësuar furnizimin e tregut dhe duke forcuar besimin e publikut te produktet vendase të bulmetit. Një sistem i formalizuar dhe i besueshëm shpërndarjeje ndihmon në sigurimin e aksesit të gjerë në produkte të sigurta e ushqyese për të gjithë.

Mjedisor:

Ndërhyrja ka ndikim pozitiv në mjedis duke ulur emetimet nga transporti dhe humbjet e panevojshme, çka redukton gjurmën e karbonit për litër qumësht. Menaxhimi i kontrolluar i ujërave të ndotura në këto qendra mbron ekosistemet dhe burimet ujore lokale. Për më tepër, infrastruktura e optimizuar e ftohjes dhe logjistikës ndihmon zinxhirin e furnizimit të përshtatet më mirë ndaj kushteve të nxehtësisë ekstreme, duke rritur rezistencën klimatike të sektorit të qumështit.

2. Programi për krijimin dhe mbështetjen e kooperativave

Mungesa e kooperativave dhe shoqatave të fermerëve e ul ndjeshëm fuqinë e tyre negociuese. Gjatë takimeve konsultuese u vu re mungesa e bashkëpunimit dhe besimit mes fermerëve: “Ne nuk kemi sindikata, nuk kemi asgjë.” (grupet e fokusuara, fermer, Lushnjë, tetor 2024). Edhe aty ku ekzistojnë, shpeshherë shoqatat e fermerëve janë joaktive ose joefektive: “Shoqatat nuk përcjellin shqetësimet e fermerëve.” (grupet e fokusuara, fermer, ZlekëHerr, nëntor 2024). Mungesa e bashkëpunimit pengon fermerët të ndikojnë në proceset vendimmarrëse dhe në përcaktimin e çmimeve. Ata pothuajse gjithmonë u nënshtrohen çmimeve të vendosura nga përpunuesit, duke pasur pak ose aspak kontroll mbi vlerën përfundimtare të shitjes së qumështit. Kjo situatë vjen si pasojë e dominimit të disa përpunuesve të mëdhenj, mungesës së kontratave afatgjata dhe mungesës së bashkëpunimit midis fermerëve, sikurse u theksua në diskutimet në Lushnjë: “Dy fabrikat kanë fuqinë për të vendosur çmimin” (grupet e fokusuara, fermer, Lushnjë, tetor 2024). Vetëm fermat e mëdha kanë fuqi pak më të lartë negociuese, pasi ofrojnë produkte cilësore që plotësojnë standardet dhe sigurojnë sasi më të mëdha qumështi (ANRD, 2024).

Mbështetja e kooperativave dhe shoqatave të fermerëve duhet të fillojë që nga hapat e parë të operimit të tyre. Kjo sugjerohet të bëhet duke u mbështetur në dy shtylla kryesore. Së pari, përmes komponentit të ndërtimit të kapaciteteve, duke ju dhënë grupeve të fermerëve njohuritë dhe mjetet e nevojshme, duke ofruar trajnim praktik në fushat ligjore, financiare dhe menaxheriale, së bashku me mentorim të vazhdueshëm ndërsa ata bashkohen për të formuar kooperativa. Së dyti, përmes krijimit të një pakete mbështetje për kooperativat dhe shoqatat e fermerëve që do të lehtësojë barrën e tyre financiare. Duke ofruar grante ose financim fillestar, këto grupime fermerësh mund të investojnë në qendra grumbullimi qumështi me depo ftohëse, pasterizues të përbashkët, ose blerje me shumicë të ushqimit për bagëtinë.

Pikat kryesore ku mbështetjet zbatimi:

- ➔ **Mentorim dhe trajnim:** Përdorimi i modeleve të suksesshme si kooperativa “Myzeqeja Farm” si pika reference.
- ➔ **Pjesëmarrje gjithëpërfshirëse:** Gratë dhe të rinjtë nuk duhet vetëm të përfshihen, por të kenë edhe mbështetje të dedikuar.
- ➔ **Investime të përbashkëta:** Nxitja e përmirësimit të infrastrukturës që fermerët e vegjël nuk do të mund ta përballonin në mënyrë individuale.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është:

Ekonomik:

Rritja e fuqisë negociuese përmes veprimit kolektiv i mundëson fermerëve individualë të negociojnë kushte më të drejta dhe të sigurojnë çmime më të larta, element i rëndësishëm për krijimin e një tregu më konkurrues. Modeli i shpërndarjes gjithëpërfshirëse të pasurisë, ku fitimet ndahen mes anëtarëve të kooperativës, rezultojnë në çmime më të qëndrueshme dhe konkurruese për konsumatorët. Këto përfitime ekonomike rriten nga ulja e kostove që arrihen përmes reduktimit të humbjeve dhe logjistikës më eficiente, duke siguruar që zinxhiri i vlerës të jetë njëkohësisht konkurrues dhe fitimprurës, teksa garanton të ardhura të drejta për fermerët e vegjël dhe nxit më shumë investime në sektorin e qumështit.

Social:

Përmes fokusimit në prodhim të qëndrueshëm, kooperativat mundësojnë një furnizim të rregullt me qumësht që rrit sigurinë ushqimore, duke siguruar që sasi të qëndrueshme të qumështit do të jenë gjithmonë të disponueshme në treg. Produkte me cilësi më të lartë, të arritura përmes investimeve të përbashkëta në teknologji dhe trajnime, sjellin produkte qumështi më të sigurt dhe me më shumë vlera ushqimore. Kjo qëndrueshmëri dhe cilësi e përmirësuar kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë ushqimore dhe përmirësimin e shëndetit publik duke reduktuar rreziqet e lidhura me prodhimin e pasigurt të qumështit. Ndërsa komunitetet përfitojnë nga këto përmirësime, rritet edhe mirëqenia e përgjithshme e popullsisë në zonat rurale, duke siguruar që produktet e qumështit jo vetëm të jenë të disponueshme, por edhe të kontribuojnë pozitivisht në standardet e ushqyerjes dhe shëndetit. Duke adresuar varfërinë dhe pabarazinë në zonat rurale përmes ndarjes së përbashkët të fitimeve dhe burimeve, kooperativat forcojnë gjithashtu qëndrueshmërinë dhe veprimin komunitar.

Mjedisor:

Investimet e përbashkëta nga kooperativat, si menaxhimi i përbashkët i plehrave organike dhe praktikave të kullotjes së qëndrueshme, ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së tokës. Për më tepër, transporti më efikas përmes reduktimit të udhëtimeve individuale ul konsumin e karburantit dhe emetimet e gazeve serrë, duke pakësuar më tej ndikimin mjedisor të sektorit të qumështit. Nismat e drejtuara nga kooperativat promovojnë gjithashtu menaxhimin e qëndrueshëm të tokës përmes praktikave si kullotja me rotacion, që ndihmojnë në ruajtjen e livadheve të ndryshme, ndërsa ruajtja e racave vendase siguron vazhdimësinë e diversitetit gjenetik. Për më tepër, investimet e ndjeshme ndaj klimës, si instalimi i sistemeve me energji të rinovueshme, për shembull sistemet me biogaz, dhe përdorimi i kulturave foragjere rezistente ndaj thatësirës, ndihmojnë në uljen e emetimeve dhe rrisin qëndrueshmërinë përmes bashkëpunimit, duke bërë që burimet dhe të ardhurat e përbashkëta të reduktojnë ndjeshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, duke rritur qëndrueshmërinë mjedisore.

3. Sistemi i nxitjes së testimit dhe pagesave të qumështit

Në sektorin aktual të qumështit, pothuajse nuk ka shpërblim për prodhimin e qumështit me cilësi të lartë. Fermerët zakonisht paguhet me një çmim fikse për litër, pa marrë parasysh vlerën ushqyese apo sigurinë e qumështit. Ky sistem nuk merr parasysh investimet e prodhuesve që zbatojnë praktika më të mira dhe nuk nxit përmirësime në higjienë, shëndetin e kafshëve apo teknikat e ushqyerjes. Si pasojë, cilësia e qumështit mbetet e paqëndrueshme dhe sektori ka vështirësi për të përmbushur standardet e sigurisë ushqimore dhe të eksportit.

Zbatimi i një sistemi çmimesh të bazuar në cilësi është i nevojshëm për të ndryshuar këtë situatë. Lidhja e pagesave me nivele të qarta cilësie u jep fermerëve nxitje financiare për të përmirësuar metodat e prodhimit. Ky sistem i mundëson prodhuesve të rrisin të ardhurat dhe njëkohësisht u ofron përpunuesve dhe konsumatorëve qumësht më të sigurt dhe me vlerë më të lartë ushqyese.

Për momentin, mungesa e stimulave për cilësi paraqet një boshllëk të rëndësishëm në zinxhirin e furnizimit. Sistemi i stimulave mund të krijojë një kornizë të qartë dhe të drejtë që lidh motivimin ekonomik me përmirësimin e cilësisë, duke e bërë sektorin më konkurrues, më të qëndrueshëm dhe më të besueshëm.

Për të rritur standardet e cilësisë në nivel kombëtar, duhet të prezantohet një sistem i ri pagesash që e lidh drejtpërdrejt çmimin e tregut të qumështit të papërpunuar me cilësinë e tij. Ky sistem do të ketë dy elemente kryesore. Së pari, njësi testimi lëvizëse dhe të palëvizshme do të vendosen në qendrat e grumbullimit të qumështit për të matur treguesit kryesorë të cilësisë, përfshirë nivelin e yndyrës dhe proteinave, ngarkesën bakteriale, numrin e qelizave somatike dhe praninë e mbetjeve të antibiotikëve. Së dyti, do të krijohet një sistem kategorizimi i qartë, ku qumështi me cilësi më të lartë do të paguhet me çmim më të lartë, ndërsa qumështi me cilësi më të ulët do të paguhet më pak. Ky mekanizëm do të motivojë fermerët të adoptojnë praktika më të mira prodhimi dhe do të përmirësojë funksionimin e gjithë zinxhirit të furnizimit me qumësht.

Pikat kryesore ku mbështetet zbatimi:

- **Mbështetja nga qeveria dhe donatorët:** Subvencionimi i pajisjeve të testimit dhe trajnimi i stafit në zonat e largëta.
- **Bashkëhartimi:** Përfshirja e përpunuesve kryesorë të qumështit dhe grupeve të fermerëve në zhvillimin e standardeve të kategorizimit, për të garantuar drejtësi dhe zbatueshmëri.
- **Mekanizmi i reflektimit:** Dhënia e menjëhershme e komenteve praktike për fermerët së bashku me rezultatet e testimit të cilësisë.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është:

<i>Ekonomik:</i>	Mekanizmi i ri i çmimeve do të shpërblejë qumështin me cilësi më të lartë, duke siguruar që fermerët të kompensohen për përpjekjet e tyre dhe të përfitojnë nga të ardhura më të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, efikasiteti i tregut, i mbështetur në standarde të qarta cilësie, ndihmon në kufizimin e tregtisë informale të qumështit me cilësi të ulët dhe forcon besimin në gjithë zinxhirin e furnizimit, duke kontribuar në një mjedis tregtar më të qëndrueshëm dhe më të drejtë.
<i>Social:</i>	Fokusi tek produktet e qumështit më të sigurta, i bazuar në kontrole të rrepta të cilësisë, ul rrezikun e sëmundjeve të transmetuara nga ushqimi dhe të rezistencës ndaj antibiotikëve. Vlera ushqyese përmirësohet përmes ruajtjes së proteinave, vitaminave dhe mineraleve, si rezultat i tufave më të shëndetshme dhe praktikave të përmirësuara në fermë, gjë që ndikon pozitivisht në shëndetin e komuniteteve lokale.
<i>Mjedisor:</i>	Kjo qasje nxit praktika të qëndrueshme duke lidhur cilësinë e përmirësuar të qumështit me menaxhimin më të mirë të kafshëve, përfshirë optimizimin e ushqimit dhe reduktimin e mbetjeve. Qumështi me cilësi më të lartë ka ngarkesë bakteriale më të ulët, çka çon në më pak humbje për shkak të prishjes dhe më pak shpërdorim burimesh. Përdorimi i kujdesshëm i inputeve, i kontrolluar përmes testimeve të rregullta, ul përdorimin e tepër të antibiotikëve dhe kimikateve të tjera që mund të dëmtojnë tokën dhe ujin. Ky sistem nxit përmirësime në nivel ferme duke ofruar shpërblime të drejtpërdrejta financiare për fermerët që adoptojnë praktika miqësore me mjedisin. Gjithashtu, përmes rritjes së efikasitetit, tufat më të shëndetshme prodhojnë më shumë qumësht duke përdorur më pak burime, duke ulur gjurmët e karbonit në prodhimin blegtoral. Të ardhurat më të sigurta u japin fermerëve mundësinë të investojnë në teknologji që përshtaten me ndryshimet klimatike, si sistemet e ftohjes me efikasitet energjetik, duke forcuar rezistencën e përgjithshme të sektorit të qumështit.

4. Pilotimi i menaxhimit të integruar të plehut organik

Praktikat e dobëta të menaxhimit të plehut organik në sektorin e qumështit kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen e ujërave, emetimet e gazeve serrë dhe erërat e pakëndshme që prekin komunitetet përreth. Megjithëse kërkesat për praktika më të qëndrueshme bujqësore po rriten, shumica e fermave të qumështit nuk kanë infrastrukturën, njohuritë apo mbështetjen financiare të nevojshme për ta menaxhuar plehun në mënyrë të qëndrueshme. Nëse nuk shfrytëzohet, kjo mbetje paraqet një rrezik mjedisor dhe ekonomik. Pilotimi i një programi për menaxhimin e integruar të plehut organik ofron një zgjidhje praktike që mund të përhapet me shpejtësi. Duke mbështetur fermat e mesme dhe të mëdha të qumështit që të instalojnë sisteme si depo të mbuluara për ruajtjen e plehut, njësi kompostimi ose biogazi, kjo masë mund të kthejë mbetjet në burime me vlerë, si pleh organik apo energji të pastër, duke ulur rreziqet mjedisore. Lidhja e fermerëve me mekanizma bashkë-financimi, si grantet IPARD ose financimi i gjelbër, do të lehtësojë barrierën fillestare të investimit, duke e bërë më të realizueshme adoptimin e praktikave të reja. Në një kontekst ku menaxhimi i strukturuar i plehut organik pothuajse mungon, kjo ndërhyrje shërben si një hap

i rëndësishëm drejt bujqësisë së qëndrueshme. Ajo mund të reduktojë ndikimin mjedisor të industrisë së qumështit dhe krijon burime të reja të ardhurash për fermerët, duke e bërë sektorin më të qëndrueshëm dhe më konkurrues.

Pilotimi i një programi të menaxhimit të integruar të plehut organik mund të fillojë në dy rajone kryesore të prodhimit të qumështit, për të demonstruar praktika të bujqësisë së qëndrueshme. Nisma duhet të mbështesë fermat e mesme dhe të mëdha në instalimin e sistemeve të mbuluara për ruajtjen e plehut, njësive të kompostimit ose digestorëve të vegjël për biogaz. Plehu i trajtuar do të konvertohet në pleh organik ose energji biogazi, duke reduktuar ndotjen mjedisore dhe duke krijuar të ardhura shtesë.

Pikat kryesore ku mbështetet zbatimi:

- ➔ **Partneritete lokale:** Përfshirja e bashkive dhe OSHC mjedisore për të siguruar udhëzim teknik dhe përshtatje me specifikat e kontekstit vendor.
- ➔ **Zhvillimi i infrastrukturës:** Investimi në ndërtimin dhe përmirësimin e depozitave dhe objekteve për trajtimin e plehut, për të parandaluar ndotjen mjedisore. Përdorimi i granteve IPARD ose i financimit të gjelbër për të subvencionuar një pjesë të investimit (mekanizëm bashkëfinancimi).
- ➔ **Programet e trajnimit për fermerët:** Zbatimi i nismave edukative për trajnimin e fermerëve mbi praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të plehut dhe përfitimet e adoptimit të teknologjive moderne.
- ➔ **Praktika të qëndrueshme për tu përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike:** Promovimi i teknikave të menaxhimit të plehut që përshtaten me ndryshimet klimatike, duke siguruar qëndrueshmëri afatgjatë.
- ➔ **Zbatimi dhe forcimi i politikave:** Përforsimi i kuadrit rregullator për të detyruar praktika të sakta në menaxhimin e plehut organik dhe për t'u përafëruar me standardet mjedisore të BE-së.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është:

- Ekonomik:** Kursime të konsiderueshme arrihen përmes prodhimit të plehut organik dhe energjisë në fermë, duke reduktuar ndjeshëm kostot e inputeve. Përveç kësaj, të ardhura shtesë mund të sigurohen përmes shitjes së biogazit apo plehut organik të tepërt, duke rritur të ardhurat e fermerëve dhe duke mbështetur zhvillimin ekonomik rural.
- Social:** Produktiviteti i fermave përmirësohet falë menaxhimit më të mirë të plehut, i cili mbështet prodhimin e foragjereve me cilësi më të lartë dhe siguron prodhim të qëndrueshëm qumështi. Shëndeti publik përfiton gjithashtu nga reduktimi i ndotjes mjedisore, duke ulur rrezikun e sëmundjeve që transmetohen përmes ujit dhe ushqimit në komunitetet përreth.
- Mjedisor:** Ndotja reduktohet përmes depozitimit të mbuluar të plehut, që minimizon rrjedhjet e lëndëve ushqyese dhe ndotjen e ujërave, ndërkohë që digestorët për biogaz kapin metanin nga plehu, duke e shndërruar atë në energji të rinovueshme dhe duke zëvendësuar karburantet fosile, çka ul emetimet e gazeve serrë. Riciklimi i burimeve promovohet duke kthyer plehun në kompost, i cili mban lëndët ushqyese brenda ciklit bujqësor dhe redukton nevojën për plehra kimike. Mbrojtja e biodiversitetit arrihet duke kufizuar rrjedhjet e lëndëve ushqyese dhe duke mbrojtur ekosistemet ujore nga eutrofikimi, ndërsa shëndeti i tokës përmirësohet duke pasuruar përmbajtjen organike të saj me kompost, gjë që rrit diversitetin e mikro-organizmave dhe insekteve të dobishme. Për sa i përket ndryshimeve klimatike, reduktimi i emetimeve arrihet përmes kapjes së metanit, ndërsa qëndrueshmëria e fermave forcohet nga përdorimi i energjisë së rinovueshme dhe riciklimi i lëndëve ushqyese, duke përmirësuar aftësinë e tyre për t'iu përshtatur variabilitetit klimatik.

5. Grante për fuqizimin e grave dhe të rinjve në sipërmarrjet blegtorale

Gratë dhe sipërmarrësit e rinj përballen me pengesa të mëdha për të nisur ose zgjeruar aktivitetin e tyre në sektorin e blegtorisë. Mungesa e aksesit në financim, mentorim dhe mbështetje të përshtatur për biznesin bën që potenciali i tyre të mbetet i pashfrytëzuar. Aktualisht, nuk ekzistojnë programe specifike për të mbushur këtë boshllëk, duke e përjashtuar këtë grup të ekonomisë rurale nga mbështetja.

Krijimi i një “Fondi gjithëpërfshirës për mbështetjen e sipërmarrjeve në sektorin e blegtorisë” do ta adresonte drejtpërdrejt këtë pabarazi. Përmes granteve, kredive me interes të ulët dhe garancive për kredi, ky fond do të ndihmojë gratë dhe të rinjtë të kapërcejnë barrierat financiare që shpesh i pengojnë të kenë akses në kapital. I kombinuar me programe trajnimi praktik në zhvillimin e biznesit, ky mekanizëm jo vetëm që do të ndihmojë individët të fillojnë ose të zgjerojnë ndërmarrjet e tyre të qumështit, por edhe do t'i pajisë me aftësi dhe siguri për sukses afatgjatë.

Në një sektor që ka nevojë urgjente për ide të reja, energji dhe zhvillim më gjithëpërfshirës, fuqizimi i grave dhe i të rinjve përfaqëson një investim strategjik. Mbështetja e sipërmarrjes së tyre nuk kontribuon vetëm në barazi, por nxit inovacionin, stimulon ekonominë lokale dhe forcon qëndrueshmërinë e ardhshme të industrisë së qumështit.

Pikat kryesore ku mbështetet zbatimi:

- **Investimet:** Infrastrukturë moderne qumështi, zhvillimi i produkteve me vlerë të shtuar, ose krijimi i njësive të vogla përpunuese.
- **Kushtet preferenciale:** Përqindje më të favorshme të granteve, kërkesa më të ulëta për kolateral dhe programe mentorimi të përshtatura.
- **Bashkëpunimi me palët e interesuara:** Zbatohet nga MBZHR në partneritet me agjencitë donatore, bankat zhvillimore, bankat tregtare lokale dhe shoqatat e grave dhe e të rinjve fermerë.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është:

Ekonomik: Përmes përfshirjes së sipërmarrësve të rinj, modeli nxit konkurrencën dhe inovacionin në treg, gjë që ndihmon në uljen e çmimeve të produkteve dhe stabilizimin e furnizimit. Aksesimi i kapitalit nga sipërmarrësit e rinj inkurajon rritjen e bizneseve në zonat rurale, gjeneron mundësi fitimprurëse për ndërmarrjet e reja të qumështit dhe mbështet një zinxhir vlere më dinamik dhe më të qëndrueshëm.

Social: Gjithëpërfshirja dhe barazia forcohen përmes orientimit të investimeve drejt sipërmarrësve të rinj dhe grave, duke krijuar kushte më të barabarta dhe shpërndarje më të drejtë të pasurisë në komunitetet rurale. Kjo qasje rrit diversitetin në sektor, duke siguruar që një gamë më e gjerë aktorësh të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga zinxhiri i vlerës së qumështit. Diversifikimi i produkteve, përfshirë qumësht të pasuruar me elemente ushqyesh dhe djathëra të specializuar, zgjeron opsionet e ushqyerjes në nivel vendor, ndërsa masat e përmirësuar të sigurisë ushqimore, të mbështetura nga trajnime të formalizuara, ulin rreziqet për shëndetin publik dhe përmirësojnë mirëqenien e komuniteteve.

Mjedisor: Nxitja e përdorimit të teknologjive moderne dhe efikase (si sistemet e ftohjes me energji diellore dhe pajisjet që kursejnë ujë) dhe promovimi i inovacionit të gjelbër nga sipërmarrësit e rinj sjell kursim energjie, reduktim të ndotjes dhe forcim të qëndrueshmërisë së sektorit. Ruajtja e biodiversitetit përfiton gjithashtu kur gratë dhe të rinjtë e fuqizuar aplikojnë praktika të larmishme bujqësore, si ruajtja e racave tradicionale dhe kultivimi i foragjereve të shumëllojshme, dhe adoptojnë forma të përmirësuar të menaxhimit të tokës. Kjo lidhet edhe me përshtatjen dhe zbutjen e

ndryshimeve klimatike, ku përdorimi i teknologjive të zgjuara ndaj klimës, përfshirë sistemet e ftohjes me efikasitet energjetik dhe racat rezistente ndaj thatësirës, ul emetimet dhe rrit qëndrueshmërinë. Përmes mbështetjes financiare për këto nisma, modeli siguron që fermerët të investojnë në strategji të menaxhimit të rrezikut, duke rritur qëndrueshmërinë mjedisore të prodhimit të qumështit.

6. Programet e aksesit financiar për investimet në sektorin e qumështit

Sektori i qumështit në Shqipëri përballlet me sfida të shumta në aspektin e modernizimit, infrastrukturës dhe aksesit në treg, ku fermerët e vegjël dhe të mesëm shpesh hasin vështirësi për të siguruar financimet e nevojshme për të përmirësuar aktivitetin e tyre. Këto sfida lidhen me kostot e larta për infrastrukturë, si depozitat e ftohjes dhe sistemet e automatizuara të mjeljes, si dhe me procedurat komplekse të aplikimit për grante dhe mbështetje financiare. Për këtë arsye, përmirësimi i aksesit në financim është thelbësor për rritjen dhe qëndrueshmërinë e sektorit. Përpunuesit e vegjël dhe të mesëm të qumështit përballen shpesh me barriera të konsiderueshme në sigurimin e granteve për shkak të kriterëve të rrepta dhe procedurave të komplikuar të aplikimit.

Për të përmirësuar aksesin në financim për prodhuesit e qumështit, kombinimi i dy masave plotësuese mund të kontribuojë ndjeshëm në modernizimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit:

Skema e garancisë së kredive. Kjo masë redukton rreziqet e lidhura me dhënien e kredive për fermerët e qumështit përmes një garancie të pjesshme kredie të mbështetur nga qeveria. Skema ndihmon bankat dhe institucionet e mikrofinancës të ofrojnë kredi me norma më të ulëta interesi dhe me kërkesa më të ulëta për kolateral. Këto kredi do të përdoren për të financuar infrastrukturën bazë të qumështit, si instalimin e depozitave të ftohjes ose sistemeve të automatizuara të mjeljes. Duke i bërë kreditë më të arritshme dhe më të përballueshme, kjo skemë ndihmon prodhuesit të modernizojnë aktivitetin, të përmirësojnë efikasitetin dhe të rrisin cilësinë e produktit.

Grante të thjeshtuara për përpunuesit e vegjël. Kjo masë synon të thjeshtojë procesin e aplikimit për grantet bujqësore, veçanërisht ato në kuadër të programeve si IPARD. Përmes krijimit të Qendrave të Asistencës Bujqësore dhe Rurale (QABR), fermerët dhe përpunuesit marrin mbështetje të drejtpërdrejtë në përgatitjen e aplikimeve, formalizimin e aktiviteteve dhe përmbushjen e kriterëve për projekte modernizimi dhe shtim vlere. Modeli i QABR, i zbatuar me sukses në rajone si Puka, Kukësi dhe Dibra, mund të shërbejë si shembull për zgjerim në nivel kombëtar. Këto qendra ofrojnë asistencë administrative dhe teknike, duke lehtësuar procesin e aplikimit dhe duke rritur mundësitë e suksesit në sigurimin e financimit.

Të kombinuara, këto nisma krijojnë një qasje gjithëpërfshirëse për përmirësimin e aksesit në financim për prodhuesit e qumështit. Skema e garancisë së kredive ndihmon për mbulimin e kostove fillestare të modernizimit, ndërsa programi i granteve të thjeshtuara mbështet rritjen afatgjatë dhe formalizimin e përpunuesve të vegjël dhe të mesëm. QABR luajnë një rol kyç në thjeshtimin e procesit dhe ofrimin e asistencës teknike, duke hapur rrugën për zhvillim më të madh të fermave dhe integrimin e tyre me tregjet dhe standardet e BE.

Pikat kryesore ku mbështetet zbatimi:

- ➔ **Koordinimi ndërinstitucional:** MBZHR, AZHBR dhe Ministria e Financave bashkëpunojnë me bankat tregtare.
- ➔ **Mbështetje teknike:** Shërbimet e ekstensionit ndihmojnë prodhuesit të orientojnë procesin e aplikimit për grante.
- ➔ **Përfshirja e donatorëve:** Donatorët ndërkombëtarë mund të kontribuojnë me fonde ose ekspertizë teknike për mbështetjen e fondit të garancisë ose përmirësimin e asistencës në aplikime.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është:

- Ekonomik:** Duke zgjeruar aksesin në kredi për prodhuesit e vegjël dhe të mesëm, ndërhyrja siguron që përfitimet e modernizimit të shpërndahen në gjithë zinxhirin e vlerës së qumështit, jo vetëm te prodhuesit e mëdhenj. Kjo rrit drejtësinë ekonomike dhe u mundëson fermerëve të përmasave të ndryshme të përmirësojnë aktivitetin dhe të mbeten konkurrues. Produktiviteti i rritur dhe ulja e kostove për njësi ndihmojnë në mbajtjen e çmimeve të qëndrueshme për konsumatorët dhe përmirësojnë jetëgjatësinë e tregjeve rurale.
- Social:** Siguria ushqimore dhe mbrojtja e shëndetit publik forcohen përmes rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe modernizimit të proceseve që sigurojnë produkte të sigurta të qumështit. Me zgjerimin e aplikimit të protokolleve të sigurisë, rreziqet e kontaminimit ulen, duke mbështetur shëndetin e komuniteteve. Disponueshmëria më e madhe e produkteve të sigurta dhe ushqyese të qumështit kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin cilësisë së ushqimeve dhe mirëqenies sociale.
- Mjedisore:** Nxitja e përdorimit të pajisjeve moderne dhe efikase (që reduktojnë përdorimin e ujit, kimikateve dhe ndotjes) ul ndjeshëm ndikimin mjedisor. Sistemet e përmirësuara të menaxhimit të mbetjeve, përfshirë ruajtjen e sigurt të plehut dhe zgjidhjet për biogaz, reduktojnë emetimet e dëmshme. Investimet që mbështesin biodiversitetin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ndihmojnë në ruajtjen e tokës dhe ujit. Sa i përket ndryshimeve klimatike, pajisjet moderne ulin emetimet e gazeve serrë, ndërsa mjetet e përshtatjes, si kulturat rezistente ndaj thatësirës dhe energjia e rinovueshme, rrisin qëndrueshmërinë e fermave përballë kushteve klimaterike të paqëndrueshme.

7. Fondi i riinvestimit në qumështit dhe investimet CSR

Përgjegjësia Sociale e Korporatave (CSR) i referohet angazhimit vullnetar të bizneseve për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, duke përmirësuar jetën e punonjësve, familjeve të tyre, komunitetit lokal dhe shoqërisë në përgjithësi. CSR shkon përtej krijimit të fitimit dhe përmbushjes ligjore, duke u fokusuar në veprime që kanë ndikim pozitiv në mjedis, barazi sociale dhe praktika etike. Kjo përfshin një gamë aktivitetesh, përfshirë iniciativat për qëndrueshmëri mjedisore, praktikat etike të punës, zhvillimin e komunitetit dhe qeverisjen e përgjegjshme. Përmes CSR, kompanitë synojnë të përshtatin veprimtarinë e tyre me vlerat shoqërore dhe të demonstrojnë angazhimin për adresimin e sfidave sociale, duke krijuar vlerë afatgjatë jo vetëm për biznesin, por edhe për komunitetin më të gjerë.

Në kontekstin e CSR, kompanitë kanë mundësinë jo vetëm të arrijnë fitim ekonomik, por edhe të kontribuojnë në qëndrueshmërinë afatgjatë dhe mirëqenien e komuniteteve ku veprojnë. Për kompanitë e qumështit, investimi në infrastrukturën lokale që mbështet zinxhirin e furnizimit me qumësht mund të përmirësojë veprimtarinë, efikasitetin dhe cilësinë e prodhimit, si dhe të forcojë marrëdhëniet me aktorët lokalë.

Duke investuar në infrastrukturën e komunitetit, një kompani e qumështit demonstroi angazhimin e saj për zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie të përbashkët. Zinxhiri lokal i furnizimit, duke përfshirë fermerët e vegjël, transportuesit dhe përpunuesit e qumështit, përfiton nga përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve, duke rritur kështu kapacitetin prodhues dhe fitimet e kompanisë. Kjo krijon një ekosistem ku investimi në komunitet përmirëson drejtpërdrejt qëndrueshmërinë sociale dhe ekonomike të zonës përreth.

Për më tepër, këto investime ndihmojnë në reduktimin e disa rreziqeve të sektorit të qumështit, si p.sh. problemet logjistike apo ndikimet mjedisore, duke përforcuar reputacionin e kompanisë dhe duke dëshmuar aftësitë drejtuese në përgjegjësinë korporative. Kjo qasje është në përputhje me tendencat globale të CSR-së, ku kompanitë priten të kontribuojnë në zhvillimin e komuniteteve lokale, qëndrueshmëri dhe rritje ekonomike gjithëpërfshirëse.

Si pjesë e një strategjie proaktive CSR, një kompani qumështi mund të pilotojë një Fond të Riinvestimit të të Ardhurave Lokale të Qumështit në zonat kryesore prodhuese të qumështit. Kjo nismë përfshin mbledhjen e një takse të vogël nga të ardhurat e përpunuesve formalë të qumështit, të cilat riinvestohen në infrastrukturën lokale dhe projekte komunitare që përfitojnë drejtpërdrejt zinxhirin e furnizimit me qumësht. Duke investuar në këto projekte, kompania krijon ndikim pozitiv të qëndrueshëm në komunitet, përmirëson efikasitetin e zinxhirit të furnizimit dhe cilësinë e qumështit që prodhohet.

Projektet që mund të mbështeten nga fondi i riinvestimit përfshijnë:

- ➔ **Përmirësimi i rrugëve dhe infrastrukturës rurale:** Investimet në rrjetet rrugore dhe shërbimet publike (ujë, energji elektrike) rrisin efikasitetin e grumbullimit dhe transportit të qumështit, zvogëlojnë humbjet dhe përmirësojnë cilësinë e produkteve. Shërbimet më të mira sigurojnë që fermerët të kenë qasje në burimet/ e nevojshme për të menaxhuar operacionet e tyre.
- ➔ **Ndërtimi ose përmirësimi i njësive të përbashkëta të grumbullimit dhe ftohjes së qumështit:** Krijimi ose modernizimi i këtyre njësive mbështet drejtpërdrejt fermerët e vegjël, duke siguruar ruajtjen e qumështit në kushte optimale dhe duke ulur humbjet. Njësitë e përbashkëta reduktojnë gjithashtu barrën financiare për fermerët që nuk kanë mundësi të investojnë në infrastrukturë të shtrenjtë.
- ➔ **Mbështetje për trajnime lokale dhe qendra këshillimi teknike:** Një komponent kritik i zinxhirit të furnizimit është aftësia dhe njohuritë e fuqisë punëtore. Kompania mund të investojë në trajnime për fermerët mbi praktikën më të mira të bujqësisë, shëndetin e kafshëve dhe teknikat e prodhimit të qëndrueshëm. Qendrat teknike mund të ofrojnë asistencë të vazhdueshme, duke siguruar qasje në ekspertizë për përmirësimin e produktivitetit dhe cilësisë.
- ➔ **Projektet për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor:** Investimet në menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor, si sistemet komunitare të kompostimit⁴ ose riciklimit, ndihmojnë në reduktimin e ndikimit mjedisor të bujqësisë së qumështit dhe promovojnë praktika bujqësore të qëndrueshme.

Nismat të tilla jo vetëm që forcojnë reputacionin e kompanisë dhe lidhjen me komunitetet lokale, por krijojnë një ekosistem ku kompania dhe komuniteti përfitojnë së bashku. Duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturës dhe krijimin e një zinxhiri furnizimi më efikas dhe të qëndrueshëm, kompania siguron suksesin e vet afatgjatë dhe kontribuon në zhvillimin e një industrie qumështi më të qëndrueshme.

Pikat kryesore ku mbështetet zbatimi

- ➔ **Menaxhimi vendor:** Këshillat bashkiakë menaxhojnë fondin me mbikëqyrje nga MBZHR.
- ➔ **Pjesëmarrja e palëve të interesuara:** Grupet dhe kooperativat e fermerëve japin kontribut mbi mënyrën e alokimit të fondeve sipas prioritetit lokal.
- ➔ **CSR:** Përpunuesit kontribuojnë në fond si pjesë e strategjisë së tyre CSR, duke forcuar partneritetet afatgjata me prodhuesit.

4 Kompostimi është rezultati i dekompozimit natyror të materialeve si mbetjet bujqësore, plehu i bagëtive dhe i shpendëve, mbetjet bimore dhe të tjera. Mikroorganizmat i shpërbëjnë këto materiale nën kushte të kontrolluara temperature, lagështie dhe ekuilibri materialesh. Me kalimin e kohës, komposti shndërrohet në një substancë kafe të errët, me erë toke, të pasur me lëndë ushqyese dhe mikroba të dobishme për bimët.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është:

- Ekonomik:** Infrastruktura më e mirë ul kostot operative për fermerët duke minimizuar ndërprerjet, shkurtuar kohët e transportit dhe përmirësuar logjistikën. Këto kursime mund t'i kalohen konsumatorëve përmes çmimeve më konkurruese, duke ruajtur kthimet e drejta për prodhuesit. Operacionet më efikase promovojnë një treg qumështi të qëndrueshëm, që mbështet investime të vazhdueshme dhe stabilitet ekonomik afatgjatë në zonat rurale.
- Social:** Drejtimi i një pjese të fitimeve të industrisë drejt komuniteteve ku prodhohet qumështi përmirëson shpërndarjen e pasurisë dhe forcon jetesën lokale. Përmirësimi i infrastrukturës rrit sigurinë ushqimore, ushqyerjen dhe shëndetin publik, qumështi mund të transportohet shpejt dhe në kushte të sigurta, duke reduktuar humbjet dhe rreziqet e kontaminimit. Riinvestimi në shërbime publike dhe iniciativa shëndetësore krijon komunitete rurale më të qëndrueshme me mundësi më të mëdha përdorimi të produkteve të sigurta dhe ushqyese.
- Mjedisor:** Investimet në infrastrukturë të qëndrueshme, si ndriçimi me energji diellore dhe qendrat e ftohjes, reduktojnë emetimet dhe ndikimin negativ mjedisor. Projektet e rikuperimit (si mbjellja e pyjeve dhe mbrojtja e burimeve ujore) rikthejnë ekosistemet dhe ruajnë biodiversitetin. Përmirësimi i rrugëve, depozitave të ujit dhe furnizimit me energji rrit qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, duke mundësuar që komunitetet të përballojnë më mirë pasojat si përmbytjet dhe thatësitrat. Iniciativat lokale për energji të rinovueshme reduktojnë përdorimin e karburanteve fosile, duke siguruar një zinxhir furnizimi të qumështit më të qëndrueshëm dhe ekologjikisht të balancuar.

8. Përmirësimi i shërbimeve të bujqësisë ekstensive

Sektori i qumështit në Shqipëri po kalon një periudhë tranzicioni, duke u përballur me mundësi dhe sfida në aspektin e konkurrencës, standardeve të cilësisë dhe qëndrueshmërisë. Një nga pengesat kryesore për rritjen e sektorit është akses i kufizuar i fermerëve në shërbime këshilluese cilësore, trajnime praktike dhe informacion të besueshëm tregu. Shumë fermerë punojnë me njohuri të vjetruara, pak mbështetje teknike dhe pak lidhje me praktikatat moderne të prodhimit dhe biznesit, gjë që kufizon produktivitetin, fitimin dhe aftësinë për të përmbushur standardet e kërkuara për konsum dhe eksport.

Zgjerimi dhe modernizimi i shërbimeve këshilluese përmes një sistemi më të strukturuar dhe dinamik adreson këtë boshllëk. Krijimi i Qendrave Rajonale Këshillimore shfrytëzon infrastrukturën ekzistuese, duke siguruar efikasitet ekonomik dhe qendra të specializuara ku fermerët mësojnë përmes praktikës. Demonstrimet praktike në ushqyerjen e kafshëve, higjienën e qumështit, menaxhimin e qëndrueshëm të plehut dhe prodhimin e foragjerit janë më efektive se trajnimet teorike për ndryshimin e praktikave.

Në të njëjtën kohë, krijimi i Bashkëpunimit Publik-Privat të Këshillimit shfrytëzon potencialin e aktorëve publikë dhe privatë. Punonjësit publikë ofrojnë kapacitet dhe besim, ndërsa ekspertët privatë sjellin njohuri teknike të lidhura me kërkesat e tregut. Kjo bashkëpunim siguron që trajnimi të jetë teknikisht i saktë dhe i përshtatur me pritshmëritë e përpunuesve, shitësve dhe konsumatorëve. Vizitat e rregullta në ferma dhe punëtoritë lokale bëjnë shërbimet më të aksesueshme, të personalizuara dhe të orientuara drejt veprimit.

Integrimi i një Sistemi Informacioni për Tregun fuqizon fermerët duke reduktuar asimetrinë e informacionit dhe duke përmirësuar pozitën e tyre në zinxhirin e vlerës. Akses i rregullt në informacion mbi çmimet, kostot e inputeve dhe mundësitë e tregut, përmes aplikacioneve mobile ose platformave si WhatsApp, u lejon fermerëve të marrin vendime më të informuara dhe të rrisin fitimin.

Strategjia propozon dy hapa: transformimin e qendrave ekzistuese të transferimit të teknologjisë bujqësore (ATTC) në Qendra Rajonale Këshilluese, ku fermerët mund të mësojnë përmes praktikës; dhe krijimin e Bashkëpunimit Publik-Privat. Demonstrime praktike për ushqyerjen e kafshëve, higjienën, menaxhimin e plehut dhe prodhimin e foragjerit ndihmojnë fermerët të adoptojnë praktikatat moderne. Ndërkohë, sistemi

i informacionit për tregun do t'u mundësojë fermerëve qasje të rregullt në trendet e çmimeve, kostot e inputeve dhe mundësitë e tregut, duke përmirësuar vendimmarrjen dhe fitimet. Trajnimet përfshijnë gjithashtu pjesëmarrjen aktive të grave dhe të rinjve, duke siguruar që të gjithë segmentet e komunitetit përfitojnë.

Pikat kryesore ku mbështetet zbatimi:

- **Demonstrime praktike:** Ferma model dhe njësi të vogla biogazi për shembuj të ushqyerjes së balancuar, mjeljes higjienike dhe menaxhimit të integruar të sëmundjeve.
- **Trajnime:** Sesione të përbashkëta nga ekspertë publikë dhe privatë për të lidhur praktikën në fermë me kërkesat e tregut.
- **Informacion për tregun:** Akses në informacionin e përditësuar për çmimet, kostot dhe mundësitë, për vendime të bazuara në informacion të saktë.
- **Pjesëmarrje gjithpërfshirëse:** Angazhimi i grave dhe të rinjve për të siguruar përfitim të gjerë komunitar.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është:

<i>Ekonomik:</i>	Praktikat e menaxhimit të përmirësuar dhe njohuritë teknike ulin kostot e prodhimit, rrisin fuqinë negociuese dhe sigurojnë çmime të drejta për qumështin.
<i>Social:</i>	Rritja e prodhimit dhe përmirësimi i cilësisë së qumështit kontribuon në sigurinë ushqimore, ushqyerjen dhe shëndetin publik, duke reduktuar rreziqet e kontaminimit.
<i>Mjedisor:</i>	Praktikat e qëndrueshme, si kompostimi i plehut, ushqyerja e saktë dhe kursimi i ujit, ulin emetimet dhe rrjedhjet ndotëse. Trajnimet mbi biodiversitetin, kullotjen rrotulluese dhe ruajtjen e racave lokale mbrojnë ekosistemet dhe ndihmojnë në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

9. Nxitja e kontraktive midis fermerëve dhe përpunuesve lokalë të qumështit

Në sektorin e qumështit në Shqipëri, madhësia e tregut, transaksionet joformale dhe koordinimi i dobët midis prodhuesve dhe përpunuesve dobësojnë efikasitetin dhe rritjen afatgjatë. Shumë fermerë shesin qumësht pa marrëveshje paraprake, duke u ekspozuar ndaj luhatjeve të çmimeve dhe kërkesës të pasigurt, ndërsa përpunuesit përballen me furnizim të paqëndrueshëm dhe cilësi që ndryshin shpesh. Kjo pasiguri pengon investimet, dobëson besimin në zinxhirin e vlerës dhe vështirëson përmbushjen e standardeve moderne, sidomos ato për integrim në tregjet e BE.

Lidhja e kontratave formale afatshkurtra midis fermerëve dhe përpunuesve lokalë ofron një mekanizëm praktik dhe me rrezik të ulët për ndërtimin e stabilitetit dhe besimit. Këto marrëveshje ofrojnë përfitime të ndërsjella: fermerët sigurojnë treg të qëndrueshëm dhe parashikueshmëri të çmimeve, ndërsa përpunuesit marrin furnizim të vazhdueshëm qumështi me cilësi të garantuar. Kontratat mund të jenë me çmim fiks ose me formula të qarta të reflektimit të kostove, duke siguruar drejtësi dhe fleksibilitet.

Për të promovuar marrëdhënie të strukturuar dhe të besueshme në zinxhirin e vlerës, ndërhyrja përfshin:

- **Pilotimi i modeleve të kontratave afatshkurtra:** Projekti pilotohet në zona të zgjedhura për të demonstruar kontrata konkrete midis fermerëve dhe përpunuesve, me kushte të qarta për sasinë, cilësinë, çmimin dhe oraret e dorëzimit. Pilotimet shërbejnë si platformë mësimi për zgjerim dhe përshtatje.

- Mbështetje teknike dhe këshilluese: Ofrimi i asistencës praktike për negocimin e kontratave, shpjegimin e kushteve ligjore dhe financiare dhe sigurimin e drejtësisë dhe zbatueshmërisë. Trajnime mbi standardet e cilësisë, mekanizmat e çmimeve dhe mbajtjen e regjistrave.
- Lidhja me mbështetjen për investime (p.sh. IPARD): Kontratat mund të përdoren si bazë për përfitimin e mbështetjes publike, duke përfshirë bashkëfinancimin për infrastrukturë ferma, pajisje grumbullimi qumështi ose përpunim.
- Mekanizma monitorimi dhe ndërtimi i besimit: Krijimi i mjeteve të thjeshta dhe mekanizmave të palëve të treta (p.sh., shërbime këshilluese, kooperativa) për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Pikat kryesore ku mbështetjet zbatimi:

- **Zbatimi hap pas hapi i kontratave:** Fillimi me kontrata pilot vullnetare në disa zona, me mbështetje teknike dhe ligjore, dhe nxitje graduale e adoptimit të gjerë përmes stimuljeve.
- **Forcimi i gjurmueshmërisë dhe transparencës së kontratave:** Regjistrimi ose dokumentimi i kontratave për të rritur transparencën dhe llogaridhënien.
- **Bashkëpunim me palë të interesuara:** Bashkëpunim me asociacionet e qumështit, kooperativat, OSHC dhe qendrat këshilluese për të rritur ndërgjegjësimin, negocimin e kontratave dhe për të ndihmuar fermerët e vegjël.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është:

<i>Ekonomike:</i>	Kontratat formale rrisin efikasitetin dhe drejtësinë ekonomike duke ofruar të ardhura të parashikueshme për fermerët dhe furnizim të besueshëm për përpunuesit. Kjo inkurajon investimet në përmirësimin e cilësisë dhe produktivitetit, duke mbështetur aksesin në fonde investimi si IPARD, dhe krijon një zinxhir vlerash më të qëndrueshëm dhe konkurrues.
<i>Sociale:</i>	Kontratat përmirësojnë jetesën rurale duke stabilizuar të ardhurat e fermerëve të vegjël, duke reduktuar varfërinë dhe duke nxitur përfshirjen e tyre në zinxhirët formalë të vlerës. Marrëdhëniet formale përmirësojnë respektimin e standardeve të higjienës dhe cilësisë së qumështit, duke rritur sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik. Stabiliteti i tregut nxit të rinjtë të qëndrojnë ose të kthehen në zonat rurale, duke adresuar shpopullimin.
<i>Mjedisore:</i>	Kontratat mund të përfshijnë standarde mjedisore dhe praktika të mira bujqësore si menaxhimi i mbetjeve, kursimi i ujit dhe ushqyerja e qëndrueshme. Mbështetja teknike ndihmon fermerët të adoptojnë praktika klimatike inteligjente, si trajtimi i plehut dhe ushqyerja e saktë, duke reduktuar ndikimin mjedisor dhe promovuar ruajtjen e biodiversitetit dhe qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.

10. Rritja e kërkesave dhe zbatimit të standarteve

Sektori i qumështit në Shqipëri përballet aktualisht me sfida në zbatimin e rregulloreve, veçanërisht në fushën e sigurisë ushqimore, kontrollit të cilësisë dhe mirëqenies së kafshëve. Zbatimi i paqëndrueshëm i këtyre standardeve në zinxhirin e vlerës jo vetëm që rrezikon shëndetin e konsumatorit, por gjithashtu kufizon potencialin e rritjes së sektorit, sidomos në përmbushjen e kërkesave rigoroze të tregjeve ndërkombëtare si BE. Pa një sistem efektiv dhe gjithëpërfshirës rregullator, industria e qumështit e ka të vështirë të konkurrojë dhe të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme.

Duke forcuar kapacitetet e institucioneve rregullatore dhe duke përfshirë më drejtpërdrejt përpunuesit e bulmetit në procesin e zbatimit, mund të krijohet një sistem më i integruar dhe më efikas, që u shërben si prodhuesve të vegjël, ashtu edhe atyre të mëdhenj. Kjo do të ndihmojë në garantimin që sektori i bulmetit në Shqipëri të përmbushë standardet moderne të sigurisë ushqimore, cilësisë dhe mirëqenies së kafshëve, duke forcuar besimin e konsumatorëve dhe duke zgjeruar mundësitë e tregut.

Për t'iu përgjigjur sfidave të zbatimit në sektorin e bulmetit, kjo ndërhyrje propozon një qasje me dy komponentë: ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve rregullatore dhe koordinimin vertikal të zbatimit përmes përfshirjes aktive të përpunuesve të bulmetit.

Komponenti i parë fokusohet te forcimi i institucioneve përgjegjëse për sigurimin që prodhimi i bulmetit të përmbushë standardet bazë të sigurisë ushqimore dhe cilësisë. Duke rritur numrin e inspektorëve dhe duke i pajisur ata me trajnime të avancuara dhe mjete moderne, si kite testimi të shpejtë dhe sisteme digjitale për menaxhimin e të dhënave, sistemi rregullator mund të funksionojë më me efikasitet. Inspektorët do të kenë mundësi të kryejnë teste të shpejta dhe të sakta, të monitorojnë respektimin e rregullave dhe t'i zbatojnë ato në mënyrë më të besueshme. Gjithashtu, do të futet një sistem shkallëzues i përputhshmërisë, i cili u jep prodhuesve të vegjël kohë dhe mbështetje për t'u përshtatur, ndërsa prodhuesit e mëdhenj do të detyrohen të respektojnë menjëherë standarde më të rrepta.

Komponenti i dytë synon të përfshijë përpunuesit e bulmetit në procesin e zbatimit, duke i detyruar ata të luajnë një rol aktiv në sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së qumështit që marrin nga furnitorët. Përpunuesit do të kenë përgjegjësi të verifikojnë që furnitorët e tyre respektojnë standardet bazë të sigurisë ushqimore, si shmangia e përdorimit të antibiotikëve të paautorizuar dhe sigurimi i ftohjes së duhur të qumështit gjatë transportit. Përpunuesit mund të mbështesin furnitorët e tyre duke u ofruar trajnime, udhëzues praktikë, ose edhe duke u huazuar pajisje higjienike dhe shërbime veterinare. Ky bashkëpunim do të krijojë një zinxhir furnizimi më transparent dhe të përgjegjshëm, duke forcuar besimin mes fermerëve, përpunuesve dhe institucioneve rregullatore.

Pikat kryesore ku mbështetet zbatimi:

- ➔ **Zbatim me faza:** Prodhuesit e vegjël përfitojnë një periudhë përshtatjeje me mbështetje, ndërsa operatorët e mëdhenj detyrohen të përmbushin menjëherë standardet.
- ➔ **Gjurmueshmëri e përmirësuar:** Zbatimi i gjurmueshmërisë nga ferma deri në fabrikë për të siguruar përgjegjësi dhe monitorim.
- ➔ **Bashkëpunim me aktorët:** Punë me shoqatat e bulmetit dhe OSHC për të komunikuar rregulloret dhe për të ndihmuar prodhuesit e vegjël në përmbushjen e standardeve.

Arsyetimi që përfshin të tre dimensionet e qëndrueshmërisë është:

<i>Ekonomik:</i>	Vendosja e rregullave të njëjta të konkurrimit garanton që të gjithë pjesëmarrësit në treg të plotësojnë të njëjtat standarde, duke shpërblyer ata që investojnë në cilësi dhe siguri. Kjo sjell stabilitet në treg, kontrata të besueshme dhe çmime të qëndrueshme, që u sjellin përfitime si prodhuesve, ashtu edhe konsumatorëve.
<i>Social:</i>	Sigurimi i produkteve më të sigurta përmes kontrolleve cilësore dhe gjurmueshmërisë ul ndjeshëm rrezikun e kontaminimit, rrit besimin e konsumatorëve dhe kontribuon në ushqyerjen e shëndetshme të komuniteteve.
<i>Mjedisor:</i>	Rregulloret përfshijnë masa për trajtimin e ujërave të ndotura, përmirësimin e eficiencës energjetike, kufizimin e përdorimit të pesticideve dhe antibiotikëve, si dhe praktika më të mira të menaxhimit të tokës e kullotjes. Modernizimi i sektorit ul gjurmën e karbonit dhe rrit qëndrueshmërinë përballë ndryshimeve klimatike.

11. Nxitja e prodhimit të produkteve me vlerë të shtuar dhe diversifikimi

Sektori i bulmetit në Shqipëri mbetet i varur kryesisht nga shitja e qumështit të papërpunuar, duke e ekspozuar fermerin ndaj çmimeve të paqëndrueshme në fermë dhe fitimeve të ulëta. Fermerët e vegjël, në veçanti, nuk kanë infrastrukturën, aftësitë dhe kanalet e tregut për ta shndërruar qumështin në produkte me vlerë të shtuar, si djathë, kos, pije me bazë hurre, gjalpë të specializuar, dhe produkte tradicionale të fermentuara, që mund të sjellin fitime më të larta, jetëgjatësi më të madhe dhe hapjen e tregjeve të reja vendase dhe eksportuese. Pa mbështetje, kjo varësi nga shitja e qumështit si lëndë e parë do të vazhdojë të kufizojë gjenerimin e të ardhurave dhe të pengojë aftësinë e Shqipërisë për të promovuar trashëgiminë e saj unike të bulmetit në tregjet agroushqimore në rritje.

Kjo ndërhyrje krijon një paketë të integruar mbështetjeje, duke kombinuar grante, asistencë teknike, zhvillim marke dhe zhvillim tregu, për t'u mundësuar fermave dhe kooperativave të vogla e të mesme të ndërtojnë kapacitete mikropërpunimi dhe të tregtojnë me sukses specialitetet e diferencuara të bulmetit.

Kjo paketë përbëhet nga katër shtylla:

→ Grante për mikropërpunim në fermë:

- Grante me bashkëfinancim (p.sh. 50 % grant, 50 % kontribut i fermerit) për pajisje bazë përpunimi (pasterizues të vegjël, kazanë djathi, pajisje për gjalpë, inkubatorë për kos, tanke për hurre).
- Paketa modulare "start-up" të standardizuara për kapacitet 1–5 ton/ditë, që mundësojnë instalim dhe funksionim të shpejtë.

→ Skema cilësie dhe krijimi i markës:

- Zhvillimi i një marke zyrtare "Bulmeti Lokal Shqiptar", e menaxhuar nga një bord publik-privat, që garanton origjinën, recetat tradicionale dhe prodhimin me pak konservantë.
- Trajnime mbi Praktikat e Mira të Prodhimit (GMP) dhe HACCP për t'u kualifikuar për këtë markë.

→ Lidhje me tregun dhe integrim me agroturizmin:

- Bashkëpunim me shoqata rajonale agroturizmi për të ofruar salla degustimi në fermë, demonstrime të prodhimit të djathit dhe pika shitjeje direkte.
- Fushata promovuese të bashkëfinancuara (në digjital, media të shkruara, panaire) për të prezantuar prodhuesit dhe produktet e certikuara me këtë markë.

→ Mbështetje teknike dhe zhvillim biznesi:

- Ekipet e shërbimit këshillimor që ofrojnë trajnim praktik për prodhimin artizanal të djathit, kulturave të kosit, paketimin, etiketimin dhe testimin bazë të sigurisë ushqimore.
- Mentorim mbi kontabilitetin e kostos, strategjitë e çmimeve, logjistikën e shpërndarjes dhe platformat e tregimit online.

Pikat kryesore ku mbështetet zbatimi:

- **Përshtatshmëria dhe ndërgjegjësimi:** Objektivi janë fermat me të paktën 1 ton/ditë qumësht ose kooperativat me 3-5 fermerë që arrijnë së bashku 5-10 ton/ditë. Thirrjet për propozime do të bëhen sipas rajoneve përmes QABR.
- **Standardizimi i pajisjeve:** Listat e furnitorëve dhe paketat e pajisjeve do të miratohen paraprakisht për të lehtësuar prokurimin dhe instalimin.

- **Truga e shpejtë drejt certifikimit:** Trajnimi dhe mbështetja për auditim do të mundësojnë që përfituesit të marrin markën “Bulmeti Lokal Shqiptar” brenda 6 muajve nga disbursimi i grantit.
- **Fondi i Zhvillimit të Tregut:** 15 % e buxhetit të projektit do të dedikohet për marketing kolektiv - panaire, tregje digjitale, partneritete me bordet e turizmit.
- **Monitorim dhe mentorim:** Çdo përfitues do të ketë një trajner biznesi për takime mujore mbi volumet e prodhimit, treguesit e cilësisë (p.sh. lagështia, përmbajtja e yndyrës) dhe të dhënat e shitjes.

Arsyetimi që merr në konsideratë të treja dimensionet e qëndrueshmërisë:

- Ekonomik:** Duke pajisur fermerët dhe kooperativat e vogla me mjete, njohuri dhe mbështetje për krijimin e markës, kjo ndërhyrje u mundëson atyre ta shndërrojnë qumështin e papërpunuar në produkte artizanale me vlerë më të lartë. Në vend të çmimeve të ulëta në nivel ferme, prodhuesit do të përfitojnë cilësi Prima prej 30-50 % duke shitur produkte të markuara Bulmeti lokal shqiptar direkt tek konsumatorët, tregtarët dhe blerësit e specializuar të eksportit. Granti për mikropërpunim dhe paketat e standardizuara të pajisjeve ulin rrezikun fillestar dhe përshpejtojnë periudhën e kthimit të investimit, ndërsa Fondi i Zhvillimit të Tregut krijon kanale të reja shitjeje, dyqane në fermë, agroturizëm rajonal, tregje digjitale, duke stabilizuar flukset financiare gjatë gjithë vitit. Kjo rritje e të ardhurave përhapet edhe në shërbime, furnitorë pajisjesh, logjistikë dhe turizëm, duke nxitur investime rurale dhe krijim punësimi.
- Social:** Nisma nuk ka vetëm efekt ekonomik, por edhe ruan e ringjlekëtrashëgiminë e pasur të bulmetit shqiptar. Prodhuesit artizanalë ndërthurin receta tradicionale me praktika moderne, duke u ofruar konsumatorëve produkte autentike si djathërat e tipit feta, kosin e trashë dhe pijet me bazë hirre. Krijimi i qendrave të përpunimit të përbashkët dhe partneritetet me agroturizmin forcojnë kohezionin social: familjet, kooperativat dhe njësitë vendore bashkëpunojnë për ture në ferma, degustime dhe festivale sezonale. Të rinjtë dhe gratë, shpesh të nënpërfaqësuar, përfitojnë mundësi drejt udhëheqjes në zhvillimin e produkteve dhe marketingun direkt, duke rritur qëndrueshmërinë e komuniteteve. Për më tepër, produktet vendase të bulmetit, më të sigurta dhe më cilësore, përmirësojnë shëndetin publik dhe ushqyerjen, duke kontribuar në sigurinë ushqimore.
- Mjedisor:** Përpunimi me vlerë të shtuar në fermë shndërron tepricat sezonale, sasi të qumështit që tejkalojnë shitjet e menjëhershme, në produkte me jetëgjatësi të lartë, duke reduktuar ndjeshëm humbjet. Në vend të hedhjes së qumështit ose ushqimit të tepruar për viçat, fermerët përpunojnë gati 100 % të prodhimit në djathë dhe kos, duke ulur emetimet e metanit nga prishja. Paketat e pajisjeve përfshijnë mundësi për integrim me energjinë e rinovueshme si ujë për pasterizim të ngrohur me energji diellore dhe digestorë të vegjël biogazi me bazë hirre, duke reduktuar gjurmën mjedisore edhe kur rritet prodhimi. Duke aplikuar qasje cikli jetese në çdo hap (nga ushqimi i bagëtive te përdorimi i inkubatorëve efikasë), prodhuesit bëhen rojtarë të tokës dhe burimeve ujore, duke treguar se produktet me vlerë të lartë mund të prodhohen duke mbrojtur mjedisin.

